



XHEMAIL I. ÇUPI

DITARI
I NJË
THIRRËSI
ISLAM
NË MËRGIM

Troisdorf, Korrik 2015

Titulli i librit:

“Ditari i një thirrësi islam në mërgim”

Autori i librit:

PhDc. Xhemail Çupi

Lekturimi dhe redaktura gjuhësore:

PhDc. Ziber Lata

Faqosja dhe kopertina:

Besnik Hamiti

Shoqata Islame Shqiptare

“Xhamia Ebu Hanife”


në Troisdorf të Gjermanisë





Xhemail I. Çupi
Ditari i një thirrësi
islam në mërgim





Dedikim!

*Këtë libër ja dedikoj babait tim të ndjerë Isa Çupi.
E lus Zotin e botërave ta shpërblen në Xhenetet e Tij
më të larta për bujarinë dhe zemërgjërësinë
që tregoi mes njerëzve dhe edukatën
që u la fëmijëve dhe familjes së vet!*







PËRMBAJTJA:

Parathënie	10
Hyrje	14
Shoqata Kulturore Islame Shqiptare “Xhamia Ebu Hanife” në Troisdorf të Gjermanisë	16
Vëlla prej feje dhe gjaku.....	18
Roli i xhamive në Perëndim	20
Xhamia dhe shoqëria e vërtetë	20
Xhamia dhe rinia	21
Xhamia - vend relaksimi	23
Shërbyesit e xhamisë.....	24
Xhamia dhe leximi i Kur’anit	25
Kontribuuesit e xhamisë	26
Xhamia dhe motrat muslimane	27
Xhamia dhe hoxha.....	27
Ligjërata të zgjedhura	29
Fuqia e lutjes.....	29
Sprovat e jetës	30

Kujtoni të kaluarën tuaj!	34
Roli i muslimanëve në Botën Perëndimore	38
Si duhet të jetë një familje e shëndoshë në Perëndim?	39
Si të reagojmë kundër atyre që e shajnë fenë?	44
Jo “feja apo kombi?” por “feja dhe kombi”	51
Namazi shqip?!	53
Ndihma reciproke.....	54
Respekti ndaj prindërve	55
Familja është Xheneti i kësaj bote	65
Raporti i burrit me gruan e tij.....	66
Raporti i gruas me burrin e saj	74
Mbulesa islame, mjet apo qëllim?	77
Martesa me jomuslimane	82
Ne jemi pasqyrë për fëmijët tanë	90
Mosha e pubertetit.....	97
Krizat e rinisë në Perëndim.....	100
Cilat janë rrugëdaljet nga këto probleme?	102
Tre sprova nga Zoti.....	106
Festimi i vitit të ri	109

Frytet e Muajit të Agjërimit	113
Agjërimi, adhurim i veçantë.....	117
Ramazani, muaji i faljes	119
Ramazani, muaj trajnues dhe mbushës i besimit tonë.....	120
Ramazani, përkujtues se njeriu është nevojtar për Zotin	121
Çka pas Ramazanit?	122
Mbret i vetes apo rob i Zotit?.....	126
“Pasha Kohën!”	130
Përmende Allahut që edhe Ai të të përmendë ty!	136
Vlera e konsultimit në Islam	139
Frika ndaj Allahut në privatësi dhe në publik	146
Dimensione shpirtërore	149
Ku është lokacioni i shpirtit?.....	154
Bamirësia në adhurim	157
Studiues apo manipulues i fesë, varet prej teje!	161
Dialogu ndërjetar, domosdoshmëri e kohës dhe vendit!	166
Përfundim	171

PARATHËNIE

Falënderimi i takon vetëm Allahut Fuqiplotë, Zotit të botëve, Krijuesit Absolut të çdo gjallese dhe frymori, Kreatorit të njeriut në formën më të bukur dhe të përkryer, duke e dalluar nga të gjitha krijesat, duke i dhënë shpirt prej frymës së Tij, duke i dhuruar zemër që ndjen dhembshuri, mendje që arsyeton dhe ndërgjegje që vazhdimisht ngacmon!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi Profetin e njerëzimit, mbi Vulën e mbarë profetësisë, mbi Muhamedin a.s., pishtarin ndriçues të fesë Islame me të cilin erdhi e vërteta dhe u vulos për të mos u ndryshuar kurrë.

Ky libër përshkruan përjetimet personale tremujore gjatë shërbimit fetar në mërgim. Vetë fjala ditar, nënkupton se bëhet fjalë për përshkrimin e gjendjes nga këndvështrimi im, gjë e cila mund të mos jetë domosdoshmërisht e vërteta kolektive, sidomos kur bëhet fjalë për një individ që nuk jeton në mërgim, por përkohësisht ka ardhur në shërbim fetar në një nga qytetet e bukura të Gjermanisë, i quajtur Troisdorf. Ky nuk është udhëtimi im i parë në Gjermani, sepse gjatë pesë viteve të fundit kam qenë edhe tri herë të tjera: dy herë në Troisdorf dhe një herë në Neuwied, por përvojën e parë si imam jashtë vendlindjes (Dibrës së Madhe) e kam përjetuar në qytetin Feniks të Arizonës të SHBA-ve, që lirshëm mund të konsiderohet pikënisje në rrugëtimin tim profesional si thirrës islam. I falënderohem pakufishëm Zotit të botëve që m'i ka mundësuar këto udhëtime në periudhat më të vështira financiare për shkak të studimeve pas universitare, prandaj them: “nëse pretendoni që në të ardhmen të keni profesione që të japin të mira materiale, profesioni i akademikut apo hulumtuesit shkencor është i fundit në listën e profesioneve fitimprurëse, megjithatë, nëse dëshironi që të keni një jetë mesatare dhe të fitoni respektin, ky profesion është i pari në

listë”. Për ta sqaruar këtë ide, e shoh të udhës të kujtoj një moment nga e kaluara ime. Më kujtohen si sot ditët e studimeve deridiplomike kur një ditë të nxehtë vere, derisa ishim duke pritur taksi bashkë me një profesor të nderuar që ishte afër pensionit, njëri prej studentëve e pyeti:

“Profesor! Si është e mundur që deri sot akoma nuk keni blerë një makinë personale?” Ai iu përgjigj: “Nëse do të kisha objektiv makinën dhe luksin, do kisha përzgjedhur ndonjë profesion tjetër, por unë kam të tjera objektiva në jetë.”

E nëse realiteti i sodit tregon një fotografi tjetër prej kësaj të lartshënuarës, atëherë ose bëhet fjalë për persona që kanë ndonjë profesion alternativ të trashëguar prej familjes siç ishte rasti i Ebu Hanifes, i cili e kishte profesion familjar tregtinë dhe jo që nuk paguhej për punën e dijetarit, por përkundrazi edhe stimulonte me bursa studentët e tij të varfër; ose bëhet fjalë për keqpërdorues dhe përfitues të cilët e shfrytëzojnë afërsinë e tyre për t’i korruptuar apo manipuluar ata që besojnë qorrazi te ta.

Me profesionin e teologut dhe mësuesit nuk pretendojmë që të pasurohemi materialisht mbi kurrizin e popullit, por vetëm të ushqehemi prej rizkut apo furnizimit të Zotit, dhe dashtë Ai që të pasurohemi shpirtërisht sepse kjo është pasuria më e madhe që nuk harxhohet asnjëherë, por vazhdon edhe në Botën Tjetër. Me këto fjalë, nuk dua të them që studjuesit dhe teologët nuk duhet të aspirojnë rroga më të larta, të blejnë shtëpi të mëdha apo makina luksoze, por që këtë të mos e kenë objektiv dhe qëllim jete sepse po ta kenë qëllim final, nëse nuk do e realizojnë atëherë do demoralizohen dhe do ta braktisin misionin e tyre. Allahu xh.sh. i lavdëron tej mase thirrësit në rrugën e islam duke pohuar në Kur’an:

E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve?"¹

E bëra këtë hyrje, jo për t'ju frikësuar që të mos e ndërmerrni këtë hap gjigand në jetë, por për t'ju dhënë kurajë dhe vullnet që të mbështeteni vetëm te Zoti, sepse te Ai janë çelësat e depove dhe furnizimeve të qiejve dhe të tokës. Ju këshilloj që asnjëherë mos t'ju shkojë ndërmend se Allahu xh.sh. nuk do t'ju ndihmojë në rrugëtimin tuaj si student, si profesor dhe pse jo nesër edhe si shkencëtar dhe akademik. Allahu xh.sh. do të bëjë diçka të papritur, do të çojë dikë apo diçka si shkak, por nuk do t'ju lë pa rrugëdalje, mjafton që ju të merrni hapin e parë dhe të guxoni. Më besoni! Këtë e flas nga përvoja personale. Mos më keqkuptoni, s'e kam fjalën për lëmoshë, por për ndihmë reciproke. Një nga ato ndihma reciproke janë edhe këto shërbime fetare në Perëndim, të cilat na vijnë si dhuratë nga Zoti i botëve, sepse kur Ai do, i hap shtigjet e furnizimit prej kah nuk e prisim, prandaj ju këshilloj që asnjëherë të mos ndaloni së studjuari prej frikës së varfërisë, sepse furnizimi juaj nuk varet vetëm prej profesionit tuaj, por edhe prej shumë faktorëve të tjerë qiellorë që ne nuk kemi mundësi t'i kuptojmë asnjëherë. Frika që ju kaplon para se të regjistroheni në shkollë nuk është një frikë që buron vetëm prej përlllogaritjeve financiare që bluhen në logjikën tuaj, por edhe prej vesveseve të djallit të mallkuar. Mos e harroni asnjëherë ajetin Kur'anor:

"Vërtet ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robërit e Tij, janë dijetarët"².

Djalli i mallkuar më shumë i frikësohet një të dituri, pasi atë nuk mund ta manipulojë dhe gënjejë lehtë si njerëzit e thjeshtë, prandaj në momentin kur ju duhet të vendosni të investoni për studimet

¹ Kur'an, Sure Fusilet: 33

² Kur'an, Sure Fatir: 28

tuaja, ai ju frikëson se janë të holla që asnjëherë nuk do t'ju kthehen pas në jetë, pra ju bindën që është një investim i kotë, e në realitet ai frikësohet prej jush sepse me këtë hap shanset për t'ju manipuluar do jenë shumë të vogla.

HYRJE

Sot bota konsiderohet një fshat global ku njerëzit lëvizin të lirë, jetojnë ku të duan dhe punojnë ku të kenë mundësi. Dikur mërgimi në vendet e Botës Perëndimore ishte fatkeqësi për ne shqiptarët, saqë ai konsiderohej një nga problemet më të mëdha të zbrazjes së popullatës shqiptare, por me kalimin e viteve, për shkaqe ekonomike, politike dhe sociale, migrimi i shqiptarëve në Botën Perëndimore është kthyer në një realitet të pa kontestueshëm, po aq sa është e drejtë edhe propaganda që të mos braktiset vendlindja.

Perëndimi nuk duhet të paramendohet si një parajsë që secili që do të shkojë atje domosdo do të pasurohet, pasi edhe mërgimi i ka vështirësitë e veta sepse duhet shumë mund dhe sakrificë që të arrihet diçka. Këtë më mirë e pasqyron ardhja e gjeneratave të reja, të cilët ballafaqohen me probleme edhe më të mëdha se gjeneratat e vjetra, me rroga më të ulëta e me shpenzime më të mëdha për shkak të rritjes së standardit të jetesës si dhe për shkak të krizës që ka kapluar botën vitet e fundit.

Në anën tjetër është fakt i pa kontestueshëm se sot migrimi është realitet që është vështirë të pengohet tërësisht, sidomos për shkak të kushteve të këqija ekonomike, politike dhe sociale në viset tona, prandaj edhe pse e themi me keqardhje, por nëse dikush ka vendosur të shpërngulet për në vendet perëndimore, të paktën të përgatitet me zanate apo profesione të ndryshme sepse kjo do t'ia lehtësonte qasjen, dhe inkadrimin i tij në sistem do ishte më i lehtë. Me këtë, përveç që do fitonte personalisht, ai do ta bënte krenar edhe popullin e vet me suksesin e tij.

Ndoshta për fajin tonë, apo prej preokupimit global ndaj materializmit dhe parasë, duke mos pasur kohë të njohin filozofinë,

studimet dhe argumentet islame të bazuara në Librin e Famshëm, Kur'anin, dhe në praktikën pejgamberike, Bota Perëndimore sot i ka mbyllur sytë para të vërtetës islame dhe kjo ka shkaktuar që të kenë një frikë dhe fobi karshi Islamit, prandaj si pasojë është vendosur një barrikadë mes tyre dhe mes nesh si muslimanë. Pa dashur, rolin e pasqyrit apo imazhit të Islamit e kemi marrë ne muslimanët që jetojnë në Perëndim. Bota sot e sheh Islamin jo në libra, por tek ne: në sjelljen, kulturën, veshjen, reagimin tonë, etj.

Allahu xh.sh. e paralajmëron këtë realitet në Kur'an duke na e mësuar këtë lutje:

“Zoti ynë, mos na bëj sprovë në duar të atyre që nuk besuan...”³.

Prandaj në Perëndim, sa më mirë të sillemi në jetën sociale, në lagjet dhe punët tona, dhe të rezistojmë para asimilimit fetar a kombëtar, aq më shumë do të jemi një pasqyrë reflektuese pozitive për Islamin dhe për kombin tonë para të huajve.

Për ti ikur rrezikut të asimilimi tonë etnik dhe fetar ne duhet të jemi shumë pranë njëri-tjetrit, të ndihmohemi dhe të miqësohemi mes veti, prandaj në Perëndim ka vetëm dy vende për ta arritur këtë qëllim: ose duke u antarësuar dhe duke dhënë kontributin tonë te shoqatat me karakter kombëtar dhe humanitar ose te shoqatat me karakter fetar apo te xhamiat shqiptare.

Duke marrë parasysh faktin se në bibliotekat shqiptare ka shumë libra që flasin për rolin e shoqatave me karakter kombëtar në Perëndim e pash të arsyeshme që të përqëndrohem në rolin e shoqatave me karakter fetar, siç është rasti edhe me Shoqatën Kulturore Shqiptare “Xhamia Ebu Hanife” në Troisdorf të Gjermanisë.

SHOQATA KULTURORE ISLAME SHQIPTARE “XHAMIA
EBU HANIFE” NË TROISDORF TË GJERMANISË

Para se të shkruaj për përjetimet e mia në këtë qendër islame, dëshiroj të jap disa informacione të nevojshme për themelimin e kësaj qendre islame. Qendra Kulturore Islame Shqiptare “Ebu Hanife” me seli në Troisdorf të Gjermanisë është një iniciativë islame e iniciuar nga disa vëllezër shqiptarë muslimanë që jetojnë në mërgim dhe që kanë pasur dëshirë të kamotshme që të kenë qendrën e tyre islame dhe shqiptare për të shpalosur mundin dhe kontributin e tyre për këtë fe, të kenë xhaminë e tyre që t’i nënshtrohen Allahu xh.sh. dhe të dëgjojnë ligjërata islame në gjuhën e tyre amtare. Në të kaluarën ata janë falur në mënyrë jo të organizuar, nëpër xhami të ndryshme të ndërtuara prej komuniteteve turke dhe arabe, por përveç namazit që e kanë kryer, shumë pak prej tyre kanë mësuar nga feje islame sepse nuk e kanë kuptuar gati aspak gjuhën e të huajve. Shkuarja e tyre në xhamitë e komuniteteve tjera, u ka ndihmuar atyre që të njihen mes veti dhe të kuptojnë se janë një komunitet i mjaftueshëm për të hapur edhe ata një xhami në të cilën do ligjërohet në gjuhën shqipe.

Kjo dëshirë u bë realitet para 20 viteve, kur disa banorë shqiptarë të qytetit Troisdorf të Gjermanisë, me prejardhje nga trevat shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë, vendosën që të marrin së bashku me qira një banesë, të cilën do ta shndërrojnë në xhami. Kjo ide u realizua me sukses dhe ky vend u shërbeu atyre për plotë pesëmbëdhjetë vite. Me rritjen e numrin të anëtarëve dhe xhematit, lindi nevoja që të blihet një hapësirë e re dhe e vërtetë, dhe pikërisht në mars të vitit 2010 kjo ide u bë realitet. Kështu që, u ble një hapësirë prej 2500 m², me një sallë prej 200 m², në lagjen Teutonen, numër 27, e cila sot shërben si xhami dhe mund t’i mbulojë nevojat jo

vetëm të shqiptarëve musliman por edhe të muslimanëve të gjitha etnive të këtij qyteti edhe më gjerë, të rrethinës së Rhein-Sieg-Kreisit.

Karakteristikë e kësaj xhamie është se xhemati i saj është i përzier nga të gjitha trevat shqiptare, nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova, dhe të gjithë këtu ndjehen vëllezër, ashtu edhe siç janë në realitet.

VËLLA PREJ FEJE DHE GJAKU

Shpeshherë njerëzit habiten dhe nuk mund ta kuptojnë konceptin e vëllazërisë në Islam, më konkretisht nuk e kuptojnë dot ajetin ku Allahu xh.sh. thotë:

“Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër”⁴,

Si pasojë e kësaj ata polemizojnë shumë ne mes veti për këtë temë, por harrojnë vetëm një detal të vogël të këtij ajeti Kur'anor, faktin se Allahu xh.sh. nuk thotë se të gjithë *muslimanët* janë vëllezër, por të gjithë *besimtarët*. Kjo nënkupton se për të kuptuar konceptin e vëllazërisë në emër të fesë, duhet të jesh në kategorinë e të qenët besimtar, gjë e cila është një kategori e posaçme e njerëzve që kanë punuar dhe janë përpjekur shumë për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. Këta vëllazërohen me të gjithë ata njerëz, kudo qofshin dhe kushdo qofshin, duke mos vërrejtur ngjyrën, gjuhën, etnitetin dhe kulturën e tyre, me qëllim që të shijojnë bashkërisht ëmbëlsinë e besimit.

Kur një vëlla prej të njëjtit komb të bëhet edhe vëlla në besim, atëherë këtu dyfishohet dashuria dhe respekti reciprok. Këtë ndjesi të dashurisë dhe respektit reciprok unë jam duke e përjetuar këtu në zemër të Evropës në një shoqëri që duhet mes veti për të hir të Zotit, por që janë edhe të një kombi dhe gjaku.

Një ditë, u thirra nga një shok që bashkërisht të hamë darkën e iftarit, duke shëtitur buzë lumit Raina, i thashë: “Çudi, sa herë që dal jashtë xhamisë dhe shëtis nëpër qytetet e Gjermanisë, më duket vetja sikur jam realisht në Gjermani, kurse sa herë që kthehem në xhami, largohem prej realitetit gjerman dhe ndjehem sikur jam në vendlindjen time!” Ai ma ktheu: “Po, pikërisht kjo është arsyeja e

⁴ Kur'an, Sure Huxhurat: 10

ndërtimit të xhamisë shqiptare, që të ndjehemi edhe ne si në vendlindjet tona.”

Ka një dallim thelbësor mes xhamive të vendlindjes sonë dhe xhamive në Perëndim. Xhamitë në vendlindje janë vetëm kulte fetare ku në të shumtën e rasteve shkon xhemati lokal që të kryen obligimet fetare ditore dhe pastaj kthehen nëpër shtëpitë e veta, kurse në Perëndim, xhamitë e kanë rolin shumë më të madh se kjo, ato janë kthyer në origjinalitetin e kohës profetike, ku xhamia ishte qendra e vetme për të gjitha aktivitetet shoqërore, ishte vend kulti, bibliotekë, vendstrehim për të varfërit, etj. Sot këtë rol e kanë edhe xhamitë në Perëndim, ato janë qendra kulturore, humanitare dhe sportive, janë vendtakime të të gjithëve, janë pikësynime për të gjithë ata që e ndejnë veten muslimanë.

Xhamia si në të kaluarën ashtu edhe sot ka bashkpunime të ngushta me shoqatat me karakter kombëtar, kontributi i të cilëve nuk mund të mohohet, sidoemos kontributi i tyre humanitar në vitet 1999 me rastin e Luftës në Kosovë dhe vitin 2001 në Luftën në Maqedoni. Xhamia edhe në këtë kohë kanë luajtur një rol të rëndësishëm, sepse namazi i xhumasë ka qenë rasti më i volitshëm për t'i lajmëruar ata dhe për të tubuar ndihma prej tyre.

ROLI I XHAMIVE NË PERËNDIM

Jeta në Perëndim nuk mund të krahasohet aspak me jetën në nënqiellin shqipfolës në Ballkan. Nëse njerëzit në vendlindje kohën e lirë e kalojnë me shokë duke frekuentuar lokale të ndryshme dhe aty qëndrojnë me orë të tëra duke biseduar dhe duke u zbavitur deri në orët e vona të natës, në Perëndim ndryshon krejtësisht programi ditor, sepse njerëzit të rraskapitur prej punës së mundimshme ditore kanë një hapësirë të vogël kohore që të takohen me shokë, por jo për të qëndruar deri në orët e vona të natës, sepse së pari kjo nuk është traditë perëndimore, dhe së dyti duhet të çmallen me fëmijët e tyre, pasi nuk i kanë parë tërë ditën, dhe më e rëndësishmja, duhet të pushojnë mjaftueshëm sepse nesër i pret përsëri puna e lodhshme. Dëshiroj të theksoj se pjesa më e madhe e njerëzve këtë kohë të lirë që takohen me shokët e tyre dëshirojnë ta kalojnë në xhami, sepse xhamia përveç që ka hapësirën e përcaktuar për kultin fetar ku kryhen obligimet fetare, ajo disponon edhe me kafeterinë ku shokët mund të kalojnë kohën e lirë duke biseduar me dashamirët e tyre.

Xhamia dhe shoqëria e vërtetë

Xhamia në Perëndim ka edhe vlera të tjera. Një ndër vlerat e saj është fakti se xhamia është qendër ku njerëzit njoftohen dhe formojnë shoqëri të reja, prandaj i këshilloj ata që për herë të parë vijnë në mërgim, pa marrë parasysh se me çfarë statusi civil janë, kërkojnë azil apo bëjnë bashkim familjar, të drejtohen në xhami dhe të shoqërohen me njerëzit e xhamisë, të kërkojnë ndihmën e tyre dhe të këshillohen me ta, sepse atë që fillestarët e përjetojnë në mërgim, ata të xhamisë e kanë përjetuar para disa viteve apo dekadave.

Xhamia dhe rinia


Rol shumë të rëndësishëm në xhamitë në Perëndim ka edhe rinia, ajo është boshti kryesor i mirëmbajtjes së xhamisë dhe e ardhmja e saj. Forca matëse e kapaciteteve të xhamive shqiptare në mërgim varet prej faktit se sa rini kanë ato. Suksesi varet shumë prej kryesisë së xhamisë dhe prej imamit. Kryesia duhet të ketë “politikë” adekuate që fillimisht të dijë t’i tërheq këta të rinj dhe pastaj me anë të angazhimeve të ndryshme rinore të dijë si t’i mbajë në gjirin e vet. Një rol vendimtar në këtë strategji afatgjate duhet ta luajë edhe imami i xhamisë, ai duhet të di si të bëhet atraktiv për të rinjtë, dhe kjo duhet të nisë prej në moshën e tyre më të re. Ai duhet të jetë njohës i mirë i aktualiteteve që parapëlqen rinia. Duhet të organizon takime, tribuna, seminare etj., por të gjitha këto t’i bën me metoda bashkëkohore, siç janë: kompjuteri, projektori, formimi i grupeve virtuale në internet etj. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me ta, t’i informojë për risitë që ndodhin në xhami etj. Një rol shumë të rëndësishëm këtu ka edhe formimi i Forumit Rinor të Xhamisë, një organ krejtësisht i pavarur i xhamisë i cili bën iniciimin e shumë organizimeve kulturore, zbavitëse dhe sportive, dhe me këtë do të thithë brenda gjirit të vet edhe të rinj të tjerë. Xhamia “Ebu Hanife” tashmë ka forumin e saj rinor dhe ata disponojnë edhe me klubin e tyre të futbollit ku kanë marrë pjesë në shumë turne dhe gara sportive, bile kanë fituar edhe shumë kupa fituese, kanë promovuar xhaminë në manifestime të ndryshme në Troisdorf, siç është Dita e Hapur e Tolerancës Ndërfetare dhe kanë organizuar edhe festa të ndryshme në oborrin e xhamisë. Duke qenë se rinia e kësaj xhamie është shkolluar në Gjermani dhe e njeh sistemin e saj, ajo i ndihmon

pa masë më të moshuarit dhe të sapoardhurit në Gjermani për dokumentacionet e ndryshme, u përkthejnë atyre, u shkruajnë letra, etj.



Ekipi i xhamisë "Ebu Hanife" gjatë pjesmarjes në turnirin tradicional të futbollit organizuar nga Unioni i Qendrave Islame Shqiptare, Siegen 2015.

Nuk lë pa e përmendur edhe ditën e diell, e cila është një ditë e veçantë për fëmijët e mrekullueshëm të xhamisë, sepse ata vijnë në xhami vazhdimisht dhe aty mësojnë *elifin* me kënaqësinë më të madhe. Me thënë të vërtetën, me disa prej tyre kam pasur vështirësi të komunikoj në gjuhën shqipe, pasi ata nuk kuptonin mirë shqip dhe kjo për mua është e pa tolerueshme, prandaj inkurajoj prindërit shqiptarë që sa më parë t'ua mësojnë fëmijëve gjuhën amtare. Gjithashtu, inkurajoj edhe hoxhën që edhe ai sa më parë të mësojë gjuhën gjermane. Dëshiroj të potencoj se derisa isha në shërbim në këtë xhami, me fëmijët organizova një manifestim me lexim Kur'ani, ilahije dhe vjersha, ku vërejta gëzimin në sytë e tyre dhe e ndjeva thellë në zemër se këta janë pishtarët ndriçues të kësaj xhamie në të ardhmen e afërt.



Fëmijët e xhamisë Ebu Hanife në Troisdorf gjatë manifestimit të leximit të Kur'anit, qershor 2015

Xhamia - vend relaksimi

Jeta në Perëndim është shumë dinamike, prandaj njerëzit disa herë janë tepër të ngarkuar dhe me raste edhe të stresuar. Ata duhet diku ta nxjerrin energjinë e tyre negative dhe të qajnë hallet me ndonjë shok që ka probleme të njëjta apo të ngjashme. Këtë vend nuk mund ta zëvendësojë asnjë vend tjetër përveç xhamisë. Në aspektin fetar, kur njeriu merr abdes dhe falën namaz duke vendosur kokën në sexhde, çliron të gjitha energjitë e tij negative në tokë prej ku edhe e ka prejardhjen. Pas faljes së namazit, ai domosdo ndalet për një kafe apo çaj në kafeterinë e xhamisë dhe për një çast harron tërë stresin dhe lodhjen që e kishte kapluar gjatë punës. Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa e përmendur një fakt të pamohueshëm, atë që besimtarët nuk e kanë privilegjin që çdo ditë të vijnë në xhami, kështu që xhamia brenda ditëve të punës nuk frekuentohet shumë

prej punëtorëve, por as nuk ngelet e zbrazët, sepse aty pesë herë në ditë vijnë më të moshuarit dhe njerëzit që nuk punojnë për shkaqe personale. Me këtë dua të nxis besimtarët e këtushëm që të përpiqen të paktën një herë në ditë të vijnë në xhami, sepse aq sa kemi nevojë ne për xhaminë, aq edhe xhamia zbukurohet me praktikuesit e saj.

Shërbyesit e xhamisë

Gjatë qëndrimit tim në këtë xhami jam habitur me përkushtimin dhe angazhimin e pjesës dërmuese të xhematit, madje dëshiroj të spikas disa njerëz që shpirtërisht janë lidhur me xhaminë. Këta janë pikërisht ata njerëz që kujdesen për xhaminë më mirë se shtëpitë e tyre. Këta njerëz dëshiroj t'i titulloj shërbëtorë të Zotit në shtëpinë e Tij. A ka mundësi të mos i përmend fqinjët e mirë që jetojnë në të njëjtën çati me xhaminë dhe se sa ata janë angazhuar dhe angazhohen për këtë xhami?! Ata e lajnë dhe e fshijnë atë, kujdesen për oborrin dhe bahçen e saj. Thjesht, unë nuk mund ta përshkruaj me fjalë përkushtimin e tyre në këtë libër, dhe besoj se nuk ka dikush në botë që mund t'ua shpaguajë këtë përveç Allahut xh.sh..



Xhamia dhe leximi i Kur'anit

Në këtë xhami është një hallkë e fortë e lexuesve të Kur'anit, saqë do ta kishin shtyrë në siklet çdo hoxhë dhe çdo hafiz. Ata aq gjatë qëndrojnë në xhami duke lexuar Kur'an dhe duke debatuar për rregullat e texhvidit, saqë mund të them lirshëm janë të pa krahasuar me çdo xhami tjetër, thjesht thënë, edhe pse vetë jam hoxhë, ua kam zili për përkushtimin që kanë për leximin e Kur'anit dhe për nxjerrjen e talebeve të rinj, të cilët do t'i trashëgojnë ata në të ardhmen.



"Hallku" i lexuesve të rregullt të xhamisë Ebu Hanife", qershor 2015

Kontribuesit e xhamisë

Kjo xhami është ndërtuar me shumë mund dhe sakrificë. Rol vendimtar për ndërtimin e kësaj xhamie kanë dhënë një numër i vogël besimtarësh që për ta blerë këtë tokë për xhami, lanë hipoteka edhe shtëpitë e tyre. Mundi i tyre nuk mund të krahasohet me asgjë në këtë botë sepse ata ishin shkaktarë që të themelohet një shtëpi e Zotit në Tokë, por duke qenë se brezat e ri u rritën dhe fituan eksperiencën e tyre, duke qenë tashmë më ambicioz dhe më aktual, brezi i vjetër e kuptoi se është koha të tërhiqen dhe t’ua lëshojnë vendin më të rinjve, prandaj sot kjo xhami udhëhiqet nga një brez i ri shumë entuziast, saqë arritën të organizojnë me ndihmën e xhematit edhe një iniciativë të fundit për shlyerjen e borxhit që kishte mbetur pa paguar. Në këtë xhami ka edhe shumë të tjerë që japin dhe nuk dëshirojnë t’u përmendet emri. Ata japin pa masë për xhaminë, sepse e dinë se vetëm atë do ta gjejnë në Botën Tjetër.



Foto nga Bajrami i vogël i vitit 2014 në xhaminë Ebu Hanife në Troisdorf

Xhamia dhe motrat muslimane

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e xhamisë është edhe hapësira e motrave muslimane. Ato përveç faljes me imam të përbashkët dhe organizimeve të ndryshme fetare, të cilat kanë mundësi t'i përcjellin drejtpërdrejt përmes kamerave dhe mikrofonave, në organizimet e tyre femërore, siç janë mësimi i elifit dhe leximi i Kur'anit, janë tërësisht të pavarura në punën e tyre, me hapësirë të veçantë, e cila përfshin objektin e kultit fetar, bibliotekën dhe avdeshanën.

Xhamia dhe hoxha

Thirësi Islam apo hoxha në këto vende dallon shumë prej atyre të nënqiellit shqiptar, jo se duhet të jetë intelektualisht më i pregaditur, por sepse është në teren dhe rrethana shumë më të ndryshme prej atje, me diverzitete mes xhematit që secili prej tyre ka traditën dhe shprehitë e veta dhe hoxha për të arritur sukses duhet të mundohet të përshtatet me të gjithë ato; hapi i parë për ta aritur këtë nuk është duke u lavdëruar për nivelin e tij intelektual por duke qenë modest, karakter pozitiv dhe i dashur për të gjithë. Kjo çështje është shumë e lehtë për atë që këtë profesion e bënë me pasion e kënaqësi dhe e konsideron veten misionar i Zotit në tokë, duke marrë shembullin e gjithë pejgamberëve në krye me Muhamedin a.s.; Si rezultat i qëndrimit të tij të paluhatur në misionin e tij, këtij misionari islam me ndihmën e Allahut xh.sh. i garantohen shumë suksese në këtë këtë botë dhe në Botën tjetër; Në të gjitha rastet tjera, nëse ky profesion ushtrohet për shkak të ndonjë interesi të kësaj bote, ushtruesi i tij s'mund të korrë sukses sepse Allahu xh.sh. nuk i don ata që shtiren, kreken dhe shfytëzojnë popullin për përfitime personale.

Hoxha i xhamive në Perëndim duhet të jetë prej mesit të tyre, ashtu siç ishte edhe profeti Muhamed a.s. prej mesit të popullit: flet gjuhën e tyre, të njeh traditat dhe zakonet e tyre, me një fjalë, të jetë i përshtatshëm për ta. Perderisa në xhami frekuentojnë njerëz me dialekte të ndryshme, prej zonave të ndryshme, imami në ligjerata dhe në fjalime publike duhet të përdorë vetëm gjuhën standarte shqipe si gjuhë unifikuese, kurse në rastin e bisedave private, preferohet të përshtatet me gjuhën e bashkëbiseduesit. Gjithashtu, preferohet që imami gjatë faljes së xhumasë të ligjërojë edhe në gjuhën gjermane, pasi aty ka edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera. Imami duhet të jetë aktual dhe të shqyrtojë problematikat që e tangojnë shoqërinë dhe mjedisin ku jetojnë mërgimtarët. Asnjëherë të mos ndryshojë mënyrën e ligjërimit për individë të caktuar. Të mos shoqërohet vetëm me një shoqëri të caktuar të një etniteti, province apo lokaliteti, por të jetë unifikues dhe bashkues i tyre.



Oborri dhe objekti i xhamisë islame shqiptare "Ebu Hanife", Troisdorf 2015

LIGJËRATA TË ZGJEDHURA

Jnderuar lexues, në vijim do t'i paraqes disa ligjërata dhe hutbe që i kam ligjëruar në xhaminë "Ebu Hanife" gjatë qëndrimit tim disamujor në periudhën pesëvjeçare, të cilat kanë të bëjnë kryekëput me problemet, hallet dhe shqetësimet e muslimanëve dhe shqiptarëve këtu në mërgim.

Fuqia e lutjes

Betohem në Allahun që është Bujar! Ai çdoherë i pranon lutjet e sinqerta të besimtarëve të përkushtuar dhe këmbëngulës. Sa më shumë që të trokasim për ndihmë në dyert e krijesave që janë të vdekshme, aq më shumë na mbyllet dera e pranimi të lutjeve nga Zoti. Në anën tjetër, sa më shumë që të trokasim në derën e mëshirës dhe të depove të Allahut me lutje dhe pendime të sinqerta, aq më shumë Allahu xh.sh. na i hapën dyert e mundësive dhe privilegjeve në këtë jetë.

Mrekullitë (muxhizet) çdoherë kanë ardhur si pasojë e lutjeve të profetëve, saqë Allahu xh.sh. asnjëherë nuk ka sjellë një mrekulli nëse paraprakisht nuk është lutur ndonjë profet për të njëjtën, apo të ketë qenë shenjë për të dhe për popullin e tij. Me këtë mund të konstatojmë se lutjet (duatë) në fletët e historisë njerëzore janë dëshira të tyre, njëlloj si lutjet dhe dëshirat e profetëve, kurse pranimi i tyre nga Zoti i botëve është mrekulli në vete.

Qysh në fillim, Ademi a.s. dhe bashkëshortja e tij Hava, jetonin në Xhenet, aty kishte gjithçka që plotësonte nevojat e tyre, por prej momentit kur bënë mëkat dhe zbritën nga Xheneti në Tokë, halli dhe nevoja u bënë pjesë e pandarë e tyre dhe e të gjithë trashëgimtarëve

të tyre derisa të ekzistojë jeta në këtë botë. Allahu xh.sh. në Kur'an thonë:

“O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun, e Allahu nuk ka nevojë për ju. Ai është i Falënderuari”⁵.

E nderuar rini! Kjo botë konsiderohet si provim final i diplomimit tuaj elementar apo sipëror; diplomimi është kurorëzim i sakrificës suaj disavjeçare, prandaj tejkalimi i këtij provimi final rezulton me pajisjen e diplomës, me ç'rast studenti fiton të drejtën e ushtrimit të profesionit, por nëse eventualisht këtë provim final nuk e kaloni, nuk mund të pajiseni me diplomë dhe nuk do të mund ta ushtroni profesionin tuaj. Krahësuar me këtë, mund të themi se kush i kalon sprovat dhe vuajtjet e kësaj bote, Allahu do ta nderojë duke e ngritur në pozita të larta në Xhenetet e Tij, ndërsa ai që mendon se ekziston vetëm kjo botë dhe nuk e kalon provimin e kësaj bote, atij i vulozet zemra për keq dhe stacioni i tij përfundimtar, për fat të keq, është zjarri i Xhehenemit.

Sprovat e jetës

Kur dikë e kaplon ndonjë fatkeqësi e jetës, frika, humbja e pasurisë dhe e jetës, njerëzit menjëherë mendojnë se kjo e keqe është dënim nga Zoti për ndonjë punë të ligë që ai e ka bërë në këtë botë, bile thonë

“e shihni se si e dënon Allahu xh.sh. këtë person për këtë e këtë punë?!” E vërteta është se të gjitha këto janë sprova të Zotit.

Parashtrohet pyetja: Pse Allahu xh.sh. dëshiron të na sprovtojë?

Ai këtë e bën për disa arsye: fillimisht e teston qëndrueshmërinë tonë karshi sprovës, pastaj sheh se si reagojmë ndaj Allahut xh.sh.

⁵ Kur'an, Sure Fatir: 15

gjatë procesit të sprovës, sa mbështetemi tek Ai dhe sa faktorët në tjerë. A i lutemi Atij për ndihmë apo jo?! Sa i lutemi, çfarë përkushtimi kemi në lutje dhe sa jemi të singertë ndaj Tij! Kur Allahu xh.sh. sheh se edhe në kohë sprove, ne nuk heqim dorë prej Tij, por vazhdojmë t'i lutemi, Ai gëzohet me ne dhe na shpërblen për durimin dhe lutjen tonë. Pra, gjithçka përfundon mirë për besimtarin nëse ai sprovohet dhe nëse sprovën e tejkalon duke u lutur. Nga Ebu Jahja, Suhejb ibn Sinan r.a., përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë:

“E çuditshme është çështja e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askënd tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (All-llahun), e kjo i sjell dobi, kurse nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër) andaj edhe kjo i sjell dobi”⁶.

Allahu xh.sh. më shumë i ka sprovuar pejgamberët e Tij, saqë pesë prej tyre janë quajtur “profetët e sprovuar”, ato janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi a.s.. Si mund të mendojmë që sprovat e kësaj bote për besimtarin janë dënim, kur Allahu xh.sh. fillimisht i ka sprovuar më të dashurit e Tij, pejgamberët?! Shokët e Muhamedit a.s. nuk e kishin këtë dilemë, përkundrazi ata sprovën e konsideronin shenjë e dashurisë së Zotit ndaj tyre dhe ngjashmëri e jetës së tyre me jetën e pejgamberëve, bile nëse ndonjëri prej tyre një kohë të gjatë nuk ishte sprovuar, frikësohej se mos vallë Allahu xh.sh. e ka braktisur.

Nëse lutjet tona duket se kanë efekt të vogël apo nuk kanë fare realizim, menjëherë na lindën pyetja:

a po mbështetemi realisht te Zoti për zgjidhjen e problemeve?

Për këtë arsye, para jush dëshiroj të paraqes një histori të veçantë të shkëputur nga Kur’ani Famëlartë, pikërisht një fragment i shkurtër i jetës së profetit Zekerija a.s., që në mënyrë të tërthortë ndërlidhet me jetën e një kategorie çiftesh bashkëshortore që Allahu

⁶ Transmeton Ebu Jahja Suhejb ibn Sinan r.a.

xh.sh. i ka sprovuar duke i privuar përkohësisht apo përgjithmonë nga posedimi i fëmijëve apo trashëgimtarëve. Zekerijës a.s., Allahu xh.sh. ia kishte plotësuar të gjitha dëshirat, përveç njëres, dëshirën e flakët për të pasur një fëmijë. Me kalimin e viteve, pas shumë lutjeve, Zekerija a.s. ishte pajtuar me fatin se Zoti s’paska dashur që ai të ketë trashëgimtar, por kur ai dhe gruaja e tij arritën pleqërinë, Allahu xh.sh u dha një shenjë të qartë se asnjëherë nuk duhet humbur shpresa nga fuqia e Allahut xh.sh., ashtu që, sa herë që hynte Zekerija a.s. në tempullin fetar ku shërbente Merjemja, nëna e Isait a.s., pranë saj gjente ushqime të ndryshme që nuk ishin të asaj stine dhe të atij vendi, dhe kjo e shtynte atë që ta pyesë Mejremen se prej ku i vinin ato ushqime. Ajo përgjigjej:

“Ky është nga Allahu, se Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi”⁷.

Përgjigja e saj ndikoi që të rikthehet shpresa te Zekerija a.s. se po iu lute Allahut xh.sh. me përgjërime dhe përkushtim maksimal, Ai bën të pamundshmen të mundshme, të porealizueshmen të realizueshme, prandaj, një ditë ai iu lut Zotit duke i thënë:

“Zoti im! Dhuro më nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!”⁸

Allahu xh.sh. i përgjigjet, dhe pranimin e kësaj lutjeje të sinqertë e tregon në Kur’anin Famëlartë:

“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, engjëjt e thirrën (Zekerijanë): “Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjain”⁹. Këtë e them nga përvoja personale pasi gjashtë vitet e para të martesës edhe unë me bashkëshorten time ishim të sprovuar dhe të privuar nga Zoti nga dhurata e posedimit të fëmijës por më besoni nuk ka pasur moment që ne i kemi çuar duart

⁷ Kur’an, Sure Ali Imran: 37

⁸ Kur’an, Sure Ali Imran: 38

⁹ Sure Al Imran: 39

për lutje në namaz pesë herë në ditë dhe të mos e bëjmë pikërisht të njëjtën lutje që e bënte profeti Zekerija a.s. dhe sot, i qofshim falë Zotit, kemi një fëmijë si drita dhe lusim Zotin që këto drita të na shumohen.

Unë jam shumë i sigurt se këto këshilla i keni dëgjuar dhe lexuar me qindra herë, bile jeni munduar t'i aprovoni në jetë, por nëse situata nuk është ndryshuar edhe pas lutjeve, atëherë ju garantoj se nuk keni plotësuar një nga tre kushtet kryesore për pranimin e lutjes, e që janë:

a) *këmbëngulja te Zoti për pranim të lutjes,*

ngase transmetohet nga Ajsheja r.a. se Profeti a.s. ka thënë:

“Allahu vërtetë i do ata që janë këmbëngules në lutje.”¹⁰

b) *përkushtim dhe lutje me zemër të thyer,*

njëjtë siç shprehej Imam Hanbeli kur thoshte:

“A e dini se si duhet të lutet myslimani?

Si një njeri që ndodhet në mes të një deti të trazuar, i kapur pas një dërrase dhe teksa e sheh veten se po mbytet, fillon dhe thërret: “O Zot, më shpëto! O Zot, më shpëto!” Vetëm duke u lutur në këtë formë, besimtarit i pranohet lutja”; dhe

c) *mos nxitimi në realizimin e lutjes,*

por duke e lënë realizimin e saj në dorë të Zotit. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Secilit prej jush do ti pranohet lutja përderisa nuk do të nxitohet! E pyetën sahabët: çka domethënë nxitimi ndaj lutjes? Ai tha: “Duke thënë që ju luta Zotit por Ai nuk ma pranoi dhe me këtë rast ndërpret lutjen”¹¹.

¹⁰ Transmeton Evzai përmes Zuhrit r.a.

¹¹ Transmeton Buhariu

KUJTONI TË KALUARËN TUAJ!

Në Kur'an ka disa sure të quajtura *musebbihat*. Ato janë sure Medinase, edhe pse bisedojnë për ripërtëritjen e besimit të tyre. Besimi i muslimanëve shpeshherë ka nevojë për rinovim dhe përforcim. Muslimanët e Mekes u detyruan të shpërngulën në Medine për shkak të torturave që hasën prej mushrikëve politeistëve. Por pas disa viteve qëndrimi në Medine ata filluan që të rehatohen, sidoemos pasi numri i muslimanëve u shtua tej mase dhe atyre nuk u kanosej më rreziku prej pabesimtarëve, të paktën brenda territorit të Medines. Ata filluan t'i harrojnë hallet dhe vështirësitë e kaluara. Filluan të formojnë familje dhe të ripërtërijnë pasurinë e tyre. Allahu xh.sh. me këtë rast ua zbriti ajetin:

“Allahu e madhëron gjithë çka ka në qiell dhe në tokë”.¹²

Me këtë Allahu xh.sh. sikur dëshironte t'u thotë:

“O ju muslimanë, pavarësisht shumë vuajtjeve dhe sakrificave që përjetuat në Meke, tash erdhët në siguri dhe rahat, dhe filluat ta shijoni jetën. Mos harroni se kush ishit në Meke! Mos i harroni asnjëherë vuajtjet dhe mundimet që i përjetuat atje”!

Duke bërë analogji, dëshiroj që këtë ta ndërlidh me gjendjen e muslimanëve tanë në Perëndim. Ju keni mërguar për shkak të skamjes apo torturave që keni përjetuar prej armiqve të juaj, apo ndoshta për shkak të problemeve financiare. Edhe ju është mirë të kujtoni jetën tuaj të mëparshme, vuajtjet, skamjet dhe të gjitha përjetimet e këqija. Sot mbase jeni në rahat dhe luks, por Allahu

¹² Kur'an, Sure Saf: 1

xh.sh. dëshiron që ju mos të harroni se kush keni qenë. Ashtu siç ua rifreskoi memorien mekasve të migruar në Medine me anë të ajeteve musebbihat të cilat janë të ngjashme me ajetet mekase edhe pse zbritën në Medine, në mënyrë që ta lartësojnë Allahu ashtu siç e lartësonin kur ishin në Meke, ashtu edhe juve Islami ju këshillon që të besoni Allahun, ashtu siç e keni besuar në vendlindjen tuaj, dhe mos harroni se ashtu siç ishit dikur me vuajtje dhe sprova, ashtu edhe sot kalojnë shumë prej bashkëkombësve tuaj, prandaj ktheheni ndonjëherë kokën pas dhe pyesni ata se si e kanë hallin, a kanë nevojë për ju, sepse njeriu shpeshherë e harron të mirën, dëshiron vetëm të ndihmohet dhe jo të ndihmojë tjerët. Kur vetë pasurohet dhe dikush kërkon prej tij ndihmë, ai reagon ashpër dhe thotë:

“Pse t’i jap kur ai qenka I shëndoshë?! Le të punojë vetë!”

Ky veprim është në kundërshtim me porosinë Kur’anore ku Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij. Nëse detyrohesh t’ua kthesh shpinën atyre (të afërmve etj.), duke kërkuar mëshirën të cilën e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t’i ndihmuar ata), atëherë thuaju atyre fjalë të mira (të lehta). Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt). S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robtë e vet dhe i vështron”¹³.

Allahu xh.sh. i obligon gjithë ata që u ka dhënë nga furnizimi i Vet që ti ndihmojnë fillimisht të afërmit e vet, por këtë e ka thënë në një formë mahnitëse që tregon Mëshirën e Tij për çdo njeri duke u thënë

“jepi çdo të afërmi veçmas”, kjo nënkupton që duhet analizuar situata financiare e çdo të afërmi dhe farefisi veçmas. Me këtë akt mes tjerash rritet edhe harmonia dhe dashuria familjare dhe farefisnore. E bukura e këtij ajeti Kur’anor është se Allahu xh.sh. pozicionon ndihmën familjare dhe farefisnore para ndihmës që duhet t’ua bëjmë të varfërve sepse në Islam një njeri që nuk është i dobishëm për familjen dhe farefisnin e tij nuk mund të jetë i dobishëm për të huajt. Nuk duhet të aspirojmë respektin e të huajve në kohën kur familja dhe farefisi ynë kanë mendim negativ ndaj nesh. Pika më e veçantë që ndërlidhet posaçërisht me situatën e atyre që jetojnë në mërgim është pika e tretë e ajetit ku Allahu xh.sh. i obligon të pasurit që të ndihmojnë edhe ata që janë në rrugë (vebni sebil) që Sherif Ahmeti¹⁴ e ka përkthyer:

“edhe ata që janë në kurbet”!

Kjo është shumë domethënëse për mërgimtarët sepse Allahu xh.sh. i përmendën ata në mënyrë të tërthortë. Duke marrë parasysh faktin se njerëzit kanë mërguar në vendet më të zhvilluara për ta përmissuar gjendjen e tyre materiale dhe falë Zotit sot gjendja e tyre është ndryshuar për së mbari, për cilën kategori njerëzish e ka fjalën Allahu xh.sh. kur përmendën kurbetin?

Për të kuptuar këtë duhet patjetër të bëjmë një lidhshmëri mes dy kuptimeve të lartpërmendura:

“ata që janë në rrugë dhe ata që janë në kurbet”,

dhe konkludojmë se Allahu xh.sh. e ka qëllimin për ata:

“që marrin rrugën për në kurbet”,

pra ata që janë fillestarë në kurbet (Zoti e din më së miri).

Është obligim fetar dhe moral që ky person të ndihmohet nga muslimanët kudo qofshin ato dhe kjo barrë fillimisht bie mbi të afërmit dhe shokët e tij. Allahu xh.sh. në fillim thotë:

¹⁴ Përkthyes dhe komentues i Kur’anit në Gjuhën shqipe

“Mos shpenzoni tepër në gjëra të panevojshme që janë të ndaluara”

dhe pas kësaj tregon të drejtat e të afërmëve, të drejtat e të varfërve dhe të atyre që janë në kurbet për të na e bërë të qartë se:

“ata të holla që shpenzohen pa nevojë në gjëra të ndaluara, në të vërtetë janë të holla që i meritojnë këta tre kategori njerëzish”,

e nëse nuk meren parasysh këto këshilla të Zotit dhe shpenzojmë në gjëra të ndaluara atëherë shëndrohemi në vëllezër të djallit sepse bëhemi shkaktarë që këta tre kategori nevojtarësh, duke mos pasur asnjë ndihmë prej askujt, rrugëdalje të vetme për të mbijetuar dhe për të ushqyer fëmijët e tyre mund të kenë krimin, vjedhjen, gënjeshtren, etj. dhe faj për këtë kemi edhe ne pse nuk u kemi shtrirë dorën e ndihmesës.

ROLI I MUSLIMANËVE NË BOTËN PERËNDIMORE

Muslimanët në Botën Perëndimore kanë dy role themelore:

❖ Roli pozitiv

Duke qëndruar besnik dhe korrekt në rrugën e Allahut xh.sh., duke reflektuar dashuri, singëritet dhe devotshmëri, si në jetën private, në raport me familjen, ashtu edhe në shoqërinë që i rrethon dhe komunitetin e tyre musliman në veçanti.

❖ Roli negativ

Rol që e bën atë mohues, labil dhe dyshues në rrugën e Zotit, duke u turpëruar para botës për identitetin e tij fetar dhe kombëtar, dhe duke u asimiluar apo duke kopjuar jetën e perëndimorëve. Pasojat e kësaj ngecjeje janë fatale, saqë mërgimtarët muslimanë, për të arritur qëllimet e tyre, nuk marrin parasysh mjetet, por shkelin të gjitha normat, aktet dhe rregullat juridike të shtetit që jetojnë dhe punojnë: gënjejnë, falsifikojnë, vjedhin, përdhunojnë, vrasin, etj. Kështu, fatkeqësisht, jepet një imazh i keq për Islamin dhe popullin e tyre, me ç' rast, të huajt binden në superioritetin e tyre si popull karshi muslimanëve në të gjitha aspektet, madje do kenë neveri për atë që ata muslimanët përfaqësojnë.

Është për të ardhur keq, por sot në Botën Perëndimore muslimanët shquhen për papunësi, burgosje, falsifikim dokumentesh, punë në të zeza, martesë artificiale për dokumente, divorce artificiale për përkrahje sociale, vjedhje, vrasje etj., dhe kjo nuk është një fotografi e mirë për Islamin, prandaj prishja e imazhit të Islamit, konsiderohet një krim edhe më i rëndë se vetë akti i tyre, sepse ajo i ul vlerat islame në sytë e jomuslimanëve. Një dijetar i shquar, pasi u konvertua në Islam, tha:

“Falënderimi i takon Zotit që ma mundësoi ta pranoj Islamin para se t’i takoj muslimanët.”

Kur e pyetën dijetarin e shquar Dr. Kardavin për jetën në Perëndim, ai u përgjigj:

“Mund të jetoni në Perëndim nëse siguroheni se nipërit tuaj do qëndrojnë në Islam”.

Në një vizitë në SHBA, kur citova fjalën e tij, m’u afrua një i moshuar dhe më tha: “Mos the gjë: Nëse siguroheni se nipërit tuaj do të qëndrojnë në Islam?” Kur i pohova, ai nisi të qajë, pastaj kur e pyeta për shkakun e qarjes, ai më tha se djali i tij është martuar me jomuslimane dhe nuk çan kokën fare për fenë e tij.

Si duhet të jetë një familje e shëndoshë në Perëndim?

Dijetari i shquar Dr. Nabulsi, kur e vizitoi për herë të parë SHBA-në, në një tubim fetar, i pyeti të pranishmit:

“Si do të ndjeheshit sikur të kishit pushtet sa presidenti Obama, pasuri sa Bill Gejtsi dhe mençuri sa Ajshtajni, nëse njëkohësisht informoheni se djali i juaj është i varur nga droga?!”

Me siguri asnjëra nga ato s’do kishin vlerë sa lumturia familjare. Rinia është shtylla e shoqërisë, por për të pasur një rini të shëndoshë, të rinjtë duhet të rriten në një ambient të shëndoshë familjar, ku burri dhe gruaja e dinë rolin e vet në familje dhe në shoqëri. Pasi ata nuk janë të njëjtë në natyrshmëri, sepse secili ka obligime të ndryshme nga njëri-tjetrit, (p.sh. burri ka forcën, andaj kujdeset për sigurinë e familjes, kurse gruaja ka ndjeshmërinë, prandaj kujdeset për edukimin e fëmijëve), por në anën tjetër, kanë të drejta të barabarta të garantuara prej Zotit. Nuk duhet të harrojmë se ka situata jetësore ku rolet e tyre shkëmbehen duke bërë kompromise dhe duke qenë tepër të durueshëm me njëri-tjetrin. Në rastet kur nuk

ka kompromis mes tyre, atëherë vjen në shprehje hidhërimi, zënka, xhelozia dhe në fund divorci. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”¹⁵

Nëse mund të analizoni fjalën e Allahut xh.sh., Ai fillimisht përdorën fjalën “dashuri”, si boshti kryesor i martesës, e cila duhet të zgjatën tërë jetën, megjithatë, ka raste dhe situata, kur me kalimin e viteve te dikush, ajo ndjenjë e dashurisë fillon të zbehet, prandaj Allahu xh.sh. menjëherë potencon si alternativë edhe mëshirën. Kjo mëshirë, në të shumtën e rasteve është transparente, por duhet ta pranojmë se duke e marrë parasysh natyrën, gruaja triumfon në raport me burrin. Në traditën tonë kemi dëgjuar për gra të cilat janë kujdesur për burrat e tyre të sëmurë dhe invalidë me vite të tëra, por kemi dëgjuar edhe për raste kur për shkak të komplikimeve gjatë lindjes së fëmijës, kur femra është bërë me pasoja fizike apo mentale, burri menjëherë e ka shkurorëzuar. Islami na mëson që pas lidhjes së kurorës të kemi fëmijë, ashtu që interesi personal të zëvendësohet me interesin familjar dhe dhembshurinë prindërore. Por në rast divorci, çifti shkakton pasoja të mëdha te psikika e fëmijëve, saqë në të ardhmen ata mund të kenë një jetë të ngarkuar emocionale, ku si pasojë vjen rebelimi i tyre dhe mungesa e inkuadrimit të plotë në shoqëri. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Edhe ata që thonë: 'Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit!’”¹⁶

Pra, gëzimi më i madh që mund të paramendohet është lumturia familjare. Çdo i ri është ambicioz dhe kërkues në jetë, ka nevojë për

¹⁵ Kur'an, Sure Rrum: 21

¹⁶ Kur'an, Sure Furkan: 74

shtëpi me harmoni familjare dhe prindër që i japin edukatë të mirë e shkollë adekuate, prindër të cilët do ta përgatisin atë për të ardhmen, ashtu që, të ketë mundësi punësimi, partner për t'u martuar, e kështu me radhë.

Nëse ndonjë të riu i mungon ndonjëra prej këtyre pikave që përmendëm, bëhet pre e dy ekstremitetëve:

- *Fanatizmit në fe*, duke mos pasur njohuri elementare dhe parimore fetare, ai sillet ndryshe, vishet ndryshe, flet ndryshe dhe me shumë lehtësi i shpallën muslimanët pabesimtarë dhe dyfytirësh. Në rast se bëhet edhe i dhunshëm, në fund mund të kryejë akte dhune dhe krime.
- *Rrugëve djallëzore*, duke u shëndruar në "lakuriq nate" dhe duke frekuentuar diskoteka dhe kafeneja, duke përdorur alkoolin, drogën si dhe duke luajtur bixhoz, e më pastaj, duke u shndërruar në person i dhunshëm. Të rinjtë kështu rrezikohen kudo, por rreziku në Perëndim është më i madh. Të dy grupet, nuk e dëmtojnë vetëm veten, por janë edhe një imazh i shëmtuar për Islamin para syve të botës.

Të nderuar mërgimtarë, duhet të vetëdijesoheni, sepse gjëja më e rëndësishme për ju mbetet edukimi i familjes dhe fëmijëve me edukatë islame dhe traditë të mirëfilltë vendase! Për ta arritur këtë, kërkohet të keni parasysh këto katër gjëra:

- ❖ Të bashkëpunoni me komunitetin tuaj dhe të jetoni sa më pranë njëri-tjetrit. Nëse shtëpia juaj është në një lagje ku askush nuk e kupton fenë dhe traditën tuaj, atëherë fqinjët ose do të frikësohen prej jush, ose do t'ju shohin me sy nënçmimi, apo ju do të tentoni të ngjasoni me ta, e kështu me kalimin e kohës fëmijët tuaj do të asimilohen dhe do ta shkrijnë kulturën e tyre. Duke u vendosur në lagje ku ka më shumë familje të komunitetit tuaj, do të vazhdoni komunikimin me ta, do të lidhni miqësi dhe do të ndihmoheni

në mes veti. Nëse mendoni se një gjë e tillë nuk është e mundur, atëherë kujtojeni shembullin e popullit hebre që jeton në SHBA, apo popullin turk që jeton në Gjermani!

- ❖ Organizohuni që të keni shkolla dhe të mësoni në gjuhën tuaj, të ruani kulturën dhe identitetin, dhe ta praktikoni fenë tuaj!
- ❖ Përpiquni të keni mediumet tuaja (TV, Radio) apo të kyçeni në paketat satelitore islame dhe kombëtare të cilat promovojnë vlera të mirëfillta fetare dhe kombëtare, me ç ‘rast shikuesit dhe dëgjuesit do të jenë vazhdimisht në lidhje me fenë dhe me gjuhën e tyre! Nuk dua ta ekzagjeroj, por mendoj se një medium me vlera të mirëfillta fetare është njësoj i rëndësishëm sa ndërtimi i një shkolle, bile edhe një xhamie, sepse televizioni dhe interneti janë futur në shtëpinë e çdo muslimani. Atë mund ta shohin edhe ata që janë të luhatshëm apo dyshojnë në argumentet fetare.
- ❖ Qëndroni sa më afër fëmijëve tuaj! Afroni ata sa më afër vetes duke ua treguar parimet fetare dhe traditat e vendit, mikpritjen, festat fetare dhe kombëtare, duke i këshilluar për të falur namazin! Namazi është çelësi i suksesit për familjen muslimane. Nuk mund të pretendon ndonjë njeri se ka atmosferë islame në shtëpi, nëse aty nuk falet namazi. Allahu xh.sh. thotë:

“Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet”.¹⁷

Dëshiroj ta përmbyll këtë ligjëratë duke treguar dy ngjarje që kanë ndodhur në SHBA me një familje muslimanësh. Një fëmijë, pasi kthehet prej shkolle i drejtohet babait dhe i thotë: “Babi, dua të shkoj në kishë?!” Babai ia kthen: “Jo shpirti i babit, ne jeni muslimanë, ne

¹⁷ Kur’an, Sure Taha: 132

nuk shkojmë në kishë, por në xhami!”, - “Po si ka ndodhur që ti asnjëherë nuk më ke çuar në xhami?”, reagoi djali. Babai, ditën e premte, për hatër të djalit vendosi ta çojë në xhami. Kur përfundoi namazi, djali i drejtohet babait me këto fjalë: “Jo babi, unë dua të shkoj në kishë, atje prifti te dera e kishës na buzëqeshën dhe na jep bonbone!” Nga ky shembull, mësojnë dy çështje të rëndësishme: *e para*, mësojuani fëmijëve tuaj Islamin para se ata t’jua mësojnë juve!; dhe *e dyta*, xhamia, kudo në botë, në veçanti në Perëndim, nuk duhet të jetë vetëm objekt për t’u falur, por institucion edukativ dhe shoqëror me hapësira për të plotësuar aktivitete të ndryshme si: terrene sportive, kënde lojërash, objekte shkollore etj.

Një njeri u kthye vonë në shtëpi nga puna, i lodhur dhe i irrituar, mirëpo posa hyri në shtëpi, e pa se djali i tij pesë vjeçar ishte duke e pritur atë pranë derës. “Baba! A mund ta bëj një pyetje?”, i tha djaloshi. “Sigurisht që po! Çfarë dëshiron të dish biri im?”, ia ktheu babai. “Baba! Sa para i merr për një orë në punë?”, pyeti djaloshi. “Kjo nuk është punë për ty. Pse më pyetën kështu?!” e pyeti babai i zemëruar. “Unë vetëm dua ta di. Të lutem më trego sa fiton për një orë?”, kërkoi përsëri djaloshi. “Nëse duhet patjetër ta dish, unë fitoj 20 euro në orë”, tha babai. “Oh!”, reagoi djaloshi i vogël, me kokë të ulur. Pastaj duke ngritur kokën ngadalë tha: “Baba! A mund të më japësh 10 euro, të lutem?”. Babai u zemërua dhe i tha djaloshit: “Ti dëshiron të të jap dhjetë euro për të blerë ndonjë lodër apo diçka të ngjashme?! Unë punoj çdo ditë me orë të tëra, kam një punë të vështirë, kështu që, nuk kam kohë për lojëra të tilla fëmijërore, prandaj shpejt largohu te dhoma jote!” Djaloshi i vogël u largua i mërzhitur në dhomën e tij dhe e mbylli derën. Babai u ul, por dukej i zemëruar me pyetjen të birit, prandaj përshpëriste: “Si pati guxim të parashtrojë pyetje të tilla vetëm për të marrë disa para?!” Pasi kaloi më shumë se një orë, filloi të mendojë se si ishte treguar i ashpër me djalë të tij të vogël, prandaj tha nën vete: “Ndoshta ai kishte vërtet nevojë për ato 10 euro që të blejë diçka të nevojshme për vete!”, sepse

për çudi kjo kishte qenë hera e parë që kishte kërkuar para. Babai shkoi te dera e djaloshit, e hapi derën: “A je në gjumë bir?”, pyeti ai. “Jo baba, jam ende zgjuar.”, u përgjigj djaloshi. “Isha duke menduar, ndoshta isha tepër i ashpër me ty më herët?”, tha babai, “Ishte një ditë e gjatë dhe e lodhshme, prandaj u solla në atë mënyrë. Ja këtu i ke 10 eurot që i kërkoje.” Djaloshi i vogël u ul në shtrat, duke qenë tepër i gëzuar dhe tha: “Faleminderit baba!”. Pastaj futi dorën nën jastëk dhe tërhoqi edhe disa para të tjera. Babai, duke parë se djaloshi i tij tashmë kishte para, filloi të zemërohej përsëri. Djaloshi i numëroi ngadalë paratë e tij, në ndërkohë babai e pyeti i nevrikosur: “Pse më kërkoje para kur paske pasur?”, “Sepse ato para që i kisha nuk mjaftonin, por tani mjaftojnë”, tha djaloshi i vogël, dhe përsëri vazhdoi: “Baba, tani unë kam 20 euro, prandaj të lutem a mund të blej një orë nga koha jote për të luajtur me ty?”

Të dashur prindër, koha më e shtrenjtë në botë është koha e kaluar me fëmijët tuaj.

Si të reagojmë kundër atyre që e shajnë fenë?

Në vendet ku ka besime dhe kultura të ndryshme si kjo në Gjermani, rritja e numrit të muslimanëve çdo ditë e më shumë ka shtyrë qarqet e ndryshme anti-islame që të mos i kursejnë muslimanët nga kritikrat dhe sulmet e ndryshme dhe të njëpasnjëshme. Muslimanët sot, çdo ditë e më shumë, përballen me shpifje dhe propaganda nga më mizoret, duke i njollosur fjalët e amshuara dhe të përsosura të Allahut Fuqiplotë, duke folur për Kur’anin dhe muslimanët. Gjithashtu përpiqen ta mjegullojnë figurën e pastër dhe më delikate siç është ajo e Muhamedit a.s..

Si duhet reaguari në situata të këtilla?

Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë i nderon dhe i lavdëron të dërguarit e Tij me fjalët më të mëdha dhe me lëvdata më të çmuara, por në anën tjetër, në Kur'an janë edhe dëshmitë ku Allahu xh.sh. na kujton sharjet, ofendimet dhe brutaliteti që u është bërë të peygamberëve nga vetë populli i tyre pabesimtar, mes tyre edhe vetë Muhamedit a.s., peygamberin më të dashur të Allahut xh.sh.. Në Kur'an tregohet dëshmia e Nuhut a.s. kur i drejtohet Allahut xh.sh. me këto fjalë: "Ai tha:

"O Zoti im, unë e thirra popullin tim natën e ditën. Por thirrja ime vetëm ua shtoi atyre ikjen. Dhe sa herë që unë i thërrisja ata për t'u falur Ti atyre mëkatet, ata i venin gishtat e tyre në veshë dhe i mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë"¹⁸.

Allahu xh.sh. gjithashtu në Kur'anin Famëlartë tregon se si pabesimtarët e Mekës e njollosnin figurën e Muhamedit a.s. me fjalë ofenduese nga më të ndryshmet, edhe pse thellë në zemër ata e dinin se ai ishte njeri besnik dhe i drejtë, bile prej përpara e njihnin me emrin *el-Emin* që domethënë *Besniku*. Allahu xh.sh. të gjitha sharjet e tyre i ka regjistruar në Kur'anin Famëlartë; aty përmendet se e kanë quajtur të çmendur, magjistar, poet etj. Parashtrohet një pyetje shumë e rëndësishme: përse Allahu xh.sh. nuk e regjistroi vetëm idenë e përgjithshme se ata janë sharë dhe ofenduar nga njerëzit, por dëshiroi që të gjitha këto ofendime në detaje të regjistrohen në Kur'anin dhe të mbesin si dëshmi deri në ditën e fundit të kësaj bote? Kjo u bë për t'ua bërë të qartë muslimanëve të çdo kohe, se Muhamedi a.s. dhe të gjithë peygamberët e tjerë, sado që janë lavdëruar prej Zotit dhe prej muslimanëve, çdoherë janë sharë prej dikujt dhe do ketë njerëz ziliqarë e armiq të Islamit të cilët do t'i shajnë vazhdimisht! Nëse e kanë sharë Muhamedin a.s. për së gjalli, do ta shajnë edhe sot të vdekur. Kur e kanë sharë në praninë e

sahabëve, Muhamedi a.s. s'i ka lejuar të ndërmarrin hapa radikalë, atëherë përse ne duhet të veprojmë ndryshe?!

Ndodhia e viteve të fundit e atyre¹⁹ që i vizatuan karikaturat e Muhamedit a.s., ngjalli reagime të ashpra prej Botës Islame, u çuan në protesta masive anë e mbanë botës, madje si rezultat i kësaj, vitin e fundit ndodhi edhe 'hakmarrja' e madhe ku në zyrat e kësaj reviste satirike u masakruan shumë punonjës nga të ashtuquajturit 'terroristë muslimanë', në mbrojtje të figurës së Muhamedit a.s., pale! Parashtrohet pyetja: si reagonin shokët e Muhamedit a.s. saherë që dëgjonin pabesimtarët të shanin Muhamedin a.s.? Deri sot nuk na është transmetuar ndonjë hadith se janë çuar sahabët në protesta masive apo janë përleshur me pabesimtarët. Jo! Nuk ka ndodhur asnjëherë një gjë e tillë, sepse ata ishin urdhëruar prej Allahut xh.sh. të bëjnë durim, sepse Zoti xh.sh. Muhamedit a.s. i thoshte:

"Vasbir ala ma jekulun! Duro për atë që ata flasin!"²⁰

Fjala *jekulune - flasin* është folje e kohës së tashme, ku në gjuhën arabe koha e tashme mbulon edhe kohën e ardhshme. Pra, në një mënyrë kuptimi i ajetit të cituar më lartë është ky "Duro për atë që flasin tani dhe për atë që do të flasin në të ardhmen!"; Nëse sot Muhamedi a.s. ka ndërruar jetë, a thua kujt i drejtohet ky ajet?! U drejtohet të gjithë muslimanëve për aq sa të ekzistojë bota. Pra, është një urdhër që na drejtohet neve dhe gjithë muslimanëve të ditëve tona. Ne duhet të bëjmë durim kur tentohet të njolloset figura e Muhamedit a.s., absolutisht nuk duhet të revanshohemi (në formë jo të duhur) ndaj atyre, siç ishte rasti i "hakmarrjes së Parisit", sepse më këtë dëshmojmë se edhe ne jemi të njëjtë, por përkundrazi, duhet t'i bindim se Muhamedi a.s. nuk është ashtu si ata pretendojnë, por këtë ta bëjmë me maturi dhe me metoda pozitive.

¹⁹ Shtëpia botuese satirike Charlie Hebdo

²⁰ Kur'an, Sure Muzemil:10

Pas luftës së Uhudit kur muslimanët tashmë kishin shtetin e tyre me të gjitha parametrat juridike dhe ushtarake, dhe Muhamedi a.s. kishte mundësi ti lufton të gjithë ata që e ofendojnë, Allahu xh.sh. përkundrazi i mësoi muslimanët duke u thënë:

“Do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë libri para jush (krishterëve dhe hebrenjve), por nëse ju duroni dhe ruheni (nuk bëheni pre e provokimeve të tyre) me të vërtetë kjo është gjëja më e mirë, më vendimtare”²¹.

Ne duhet të ndjejmë keqardhje, sepse vetë ata bien në kundërshtim me historianët dhe shkencëtarët e tyre të cilët e kanë lavdëruar Muhamedin a.s. Në mesin e tyre është autori amerikan Majkëll H. Hard²² i cili Muhamedin a.s. e pozicionoi si njeriun më me ndikim në historinë njerëzore, prandaj të mos nervozohemi me fjalët e atyre që nuk mund ta lëndojnë aspak Muhamedin a.s., sepse ai është i lavdëruar prej Zotit të botëve. Nënçmimet nuk mund t’ia marrin meritat dhe vlerat këtij njeriu të madh dhe të pakrahasueshëm, sepse ai vlerat dhe meritat nuk i ka fituar prej njerëzve, por prej Allahut xh.sh. i Cili për Muhamedin a.s. thotë:

“Dhe ti je mbi gradën më të lartë të moralit”²³

ose në ajetin tjetër:

“Dhe ju keni te profeti shembullin më të përkryer”²⁴.

Omeri r.a., njëri nga shokët më të afërt të Muhamedit a.s., para se të bëhet musliman, ka qenë një njeri me karakter të fortë dhe të ashpër, sidomos ndaj Muhamedit a.s. sepse sipas tij, Pejgamberi a.s. ishte fajtori kryesor që mekasit ishin përçarë. Një ditë, Omeri r.a.

²¹ Kur'an, Sure Ali Imran: 186

²² Libri: "The 100: A ranking of the most influential persons in History", New York, 1987

²³ Kur'an, Sure Kalem: 4

²⁴ Kur'an, Sure Ahzab: 21

vendosi që, nëse do ta takonte Muhamedin a.s. do t'i qëronte hesapet njëherë e përgjithmonë me të. Një ditë, e sheh se brenda në Qabe, Muhamedi a.s. ishte duke u falur, prandaj nxitoi pranë tij me qëllim të keq, por duke u afruar e dëgjon çka ishte duke lexuar prej Kur'anit. Ishte dëshira e Zotit që Muhamedi a.s., pa e ditur se Omeri e ndjekë nga pas, të lexonte ajetet e sures el Hakka, në të cilën bëhet fjalë për momentin e Katastrofës (kjametit). Omerit këto fjalë i bënë shumë përshtypje, andaj duke u afruar fshehurazi, pa mos e hetuar praninë e tij, filloi edhe më shumë të bëhet kureshtar për fjalët e tij. Këto fjalë ndikuan në zemrën e tij, sikur filluan t'i pëlqejnë, por duke qenë se Omeri r.a. kishte një karakter të fortë, filloi t'i thotë vetes:

“O Omer, mos u dobëso, kujtoje qëllimin pse ke ardhur këtu sepse këto fjalë padyshim janë fjalë të një poeti!”

Në atë moment, ishte vullnet i Zotit që Muhamedi a.s. t'i lexojë këto ajete:

“Me të vërtetë ai (Kur'ani) është fjalë (e Zotit) që e lexon i dërguari i ndershëm. Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, po ju nuk besoni”²⁵.

Omeri, kur i dëgjoji këto ajete, shtangu në vend dhe tha:

“Prej ku e kuptoi ky njeri se çfarë mendoja unë?! Ky, domosdo qenka fallxhor apo magjistar!”

Në ato momente, Zoti xh.sh. e urdhëroi Muhamedin a.s. t'i lexojë këto ajete:

“Nuk është as fjalë e ndonjë fallxhori, po ju nuk për-kujtoheni”²⁶.

Omeri r.a., pasi i dëgjoji, u frikësua edhe më shumë, dhe tha:

“Nëse nuk është poezi apo magji, atëherë çfarë është?”

²⁵ Kur'an, Sure Hakka: 41

²⁶ Kur'an, Sure Hakka: 42

Qe dëshirë e Allahut xh.sh. që Muhamedi a.s. ta lexojë ajetin në vazhdim:

“Është zbritje prej Zotit të botëve!”²⁷,

dhe me këtë Omeri r.a. dorëzohet dhe largohet prej aty. Kjo ishte edhe shenja e parë e rrugëtimit të Omerit r.a. drejt përqafimit të fesë Islame.

Edhe ne sot, në rast provokimi, duhet të sillemi ashtu siç na ka urdhëruar Allahu në Kur'an, duke bërë durim, duke qenë shembull i një muslimani të mirë dhe duke i këshilluar me fjalë të bukura jomuslimanët, në një mënyrë që t'u tregohet se kush ishte në realitet Muhamedi a.s.. Nëse ne provokohemi, ata do të tentojnë të tallen edhe më shumë, nëse ua kthejmë me të keqe dhe i shajmë ata si hakmarrje dhe urrejtje ndaj nesh do e shajnë edhe më shumë Zotin, sepse Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë thotë:

Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)²⁸,

e nëse ne durojmë dhe i bindim se ky veprim nuk mund ta dëmtojë fenë tonë, atëherë ndoshta do të pendohen dhe do të largohen, e nëse vazhdojnë edhe më tej duhet të distancohemi prej tyre dhe të lutemi për udhëzimin e tyre në rrugën e Islamit sepse Profeti Muhamed a.s. shpeshë herë thoshte:

“O Allah përforcoje Islamin (udhëzoi në Islam) atë që është më i dashur tek Ty prej këtyre dy personave, Ebu Xhehlin apo Umer ibnul Hatabin”²⁹.

Këta ishin dy persona që më së shumti e urenin dhe dëshironin ta vrisnin Muhamedin a.s. por ky i fundit nuk i mallkoi ata por ju lut

²⁷ Kur'an, Sure Hakka: 43

²⁸ Kur'an, Sure En'am: 108

²⁹ Transmeton Abdullah Ibn Omeri r.a.



Zotit që ti udhëzon. Allahu xh.sh. pranoi lutjen e Muhamedit a.s. dhe nga ata dy e udhëzoi Omerin r.a. në rrugën e Islamit.

JO “FEJA APO KOMBI?” POR “FEJA DHE KOMBI”

Cila ka më shumë përparësi, identiteti fetar, të qenët musliman, apo identiteti kombëtar, të qenët shqiptar? Kjo çështje është shumë e përfolur nga pseudo patriotët dhe fetarët fanatikë.

Dëshiroj të bazohem në dy ajete kur'anore, të cilat janë bazament (i zgjidhjes) i kësaj problematike:

“O ju njerëz, vërtet ne ju krijuam prej një mashkulli dhe prej një femre, ju bëmë pastaj popuj dhe fise që ju të njiheni mes veti, më i miri ndër jush është ai që është më i ruajturi!”³⁰

Pra, ishte dëshira e të madhit Zot që ne të jemi popuj dhe fise të ndryshme, që të mos luftojmë mes veti, por të njihemi dhe të shkëmbejmë eksperiencën dhe përvoja të jetës. Allahu xh.sh. në fund të ajetit të cituar deklaroi se prej gjithëve, më i miri është ai që është më i ruajtur dhe më i kujdesshëm në amanetin e Zotit në Tokë. Kurse në një ajet tjetër, thotë:

“Nga ajetet, shenjat apo argumentet e Zotit, është krijimi i qiejve dhe i Tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja, në këtë ka argumente për njerëzit”³¹.

Pra, kuptohet se ndryshimi apo diversiteti i ngjyrave të trupit dhe i gjuhëve tona është një nga shenjat e Zotit, ashtu siç është shenjë dhe argument krijimi i qiejve dhe i Tokës. Nëse ne jemi të pafuqishëm kundrejt këtyre krijesave gjigande, siç janë qiejt dhe Toka, po aq të pafuqishëm jemi që ta ndryshojmë identitetin, ngjyrën apo kombin e dikujt.

³⁰ Kur'an, Sure Huxhurat: 13

³¹ Kur'an, Sure Rrum: 13

Allahu xh.sh., kur u tha krijesave të Tij (engjëjve dhe xhinëve) se Ademi është i denjë për të qenë mlekëmbës (halife) në Tokë, dhe kur meleket thanë:

“Ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë”³²,

Allahu xh.sh. kështu i sfidoi engjëjt duke ia mësuar Ademit a.s. emrat e sendeve. Në qoftë se të gjithë ne, popujt e botës, jemi të gjithë bijtë e Ademit a.s. dhe Havës, atëherë të gjitha gjuhët janë produkt dhe variacione të fjalëve që Allahu xh.sh. ia mësoi Ademit a.s., prandaj askush nuk guxon të tallet me gjuhën, me ngjyrën apo me kulturën e dikujt tjetër, sepse të gjitha janë prej Zotit, siç ia mësoi babait tonë Ademit a.s..

Një pyetje që vazhdimisht ka qarkulluar në mjediset tona është kjo:

Çka je më parë, musliman apo shqiptar?

Njerëzit shpeshherë ngelin në situata të pa lakmueshme dhe nuk dinë se si të përgjigjen! Nëse thonë “fillimisht jam musliman e pastaj shqiptar”, do sulmohen prej pseudo-patriotëve, e nëse përgjigjen “fillimisht jam shqiptar e pastaj musliman”, atëherë do sulmohen prej besimtarëve fanatikë! Kjo pyetje është qesharake dhe nuk ka aspak bazë në fenë Islame. Kjo është njësoj si të pyesësh: çka je më parë, trup apo shpirt? Parashtrahet pyetja: nëse një njeri vritet fizikisht dhe i shkatërrohet trupi, a mund të themi se ai ende është i gjallë dhe nuk ka vdekur? A mund të konsiderohet i gjallë (për këtë botë)?! Sa është qesharake të pyesësh se a është në fillim trupi apo shpirti, po aq qesharake është të pyesësh se a je më parë musliman apo je shqiptar! Sidomos kur e dimë se trupi dhe shpirti janë prej Zotit. Identiteti i njeriut është shumë dimensional, d.m.th. jam shqiptar me komb dhe traditë, jam musliman me fe dhe traditë, dhe, duke qenë se

³² Kur'an, Sure Bekare: 30

tani kemi dy shtete shqiptare, jam shqiptar apo kosovar me shtetësi. Sa i takon pyetjes se cila prej këtyre identiteteve është më primare, përgjigjemi se më shumë prioritet ka ajo për të cilën kemi më shumë nevojë dhe ajo e cila na thërret e para. Në qoftë se Islami na thërret në namaz, zeqat, haxh etj, ose nëse umeti islam na thërret në ndihmë, kur cenohet një pjesë e tij nga armiku, atëherë ndjenja fetare na thërret e para dhe ne duhet fillimisht t'i përgjigjemi asaj. Në anën tjetër, nëse na thërret kombi apo populli ynë, cenohet apo i kanoset rreziku prej armikut, atëherë na thërret ndjenja kombëtare e para , dhe ne duhet asaj t'i përgjigjemi menjëherë.

Namazi shqip?!

Historikisht, nuk ka ndodhë që Islami të ballafaqohet apo të vjen ndesh me kombin, apo e kundërta. Islami lejon që çdo popull ta praktikojë atë në gjuhën dhe me traditat e tij, përderisa nuk vijnë ndesh me parimet e fesë. Kur them lejohet që Islami të praktikohet në gjuhën e tyre, përjashtim nga kjo bëjnë vetëm disa praktika fetare siç janë: shqiptimi i parë i shehadeit, falja e namazit, thirja e ezanit, etj. Këto janë rastet e rralla kur lutja duhet detyrimisht të bëhet në gjuhën e Kur'anit, pra në gjuhën arabe. Arsyet për këtë janë shumë, por prej tyre mund të veçojmë: *e para*, sepse është dëshirë e të madhit Zot, dhe *e dyta* sepse në xhami nuk falet vetëm një etnitet dhe një racë e caktuar por mund të falet kushdo që e ndjej veten musliman. Por gjatë namazit preferohet që fillimisht të lexohen ato sure (kaptina) që ua dimë kuptimin në gjuhën amtare.

Gjatë historisë njerëzore kanë tentuar shumë pseudonacionalistë që këto lutje ti bëjnë në gjuhën e tyre amtare por përpjekjet e tyre kanë dështuar dhe do dështojnë edhe në të ardhmen sepse nuk kanë bazë në fenë Islame. Kurse në rastet tjera të lutjeve ditore, për shembull: kur besimtari i çon duart për lutje në fund të namazit, këto

lutje mund ti bën edhe në gjuhën e kuptueshme të tij (në gjuhën shqipe për ne shqiptarët).

Disa gjëra nuk guxojnë të ndryshohen sepse e humbin originalitetin e tyre, ashtu siç është latinishtja gjuha e medicinës, greqishtja gjuha e filozofisë etj., Zoti deshi që gjuha e Kur'anit të jetë gjuha arabe.

Ndihma reciproke

Në historinë shqiptare, kombi dhe feja shpeshherë janë ndihmuar njëri me tjetrin. Me pranimin e Islamit nga pjesa dërmuese e shqiptarëve dhe nga një numër i madh i besimtarëve nëpër botë, ne si shqiptarë muslimanë, duke qenë në komunikim me muslimanët e tjerë, na ka mundësuar që të shkëmbejmë eksperiencë të ndryshme dhe të ndihmohemi me njëri-tjetrin. Në anën tjetër, Islami ka ruajtur shumë tradita dhe cilësi që na kanë karakterizuar si komb, pastaj me pranimin e Islamit, shqiptarët i kanë kultivuar edhe më shumë këto norma morale.

Dëshiroj ta përmbyll këtë ligjëratë me këto rreshta të arta të kolosëve tanë, Mulla Idriz Gjilani, i cili ka thënë:

“Sa i mirë dhe i kuptueshëm është Islami kur shpjegohet në shqip, në gjuhën e Zotit për shqiptarët!”

Gjithashtu, rilindësi dhe hoxha dibran Sait Najdeni, ka thënë:

“Njeriu, sa dashuri ka për mëmëdheun, aq dashuri ka edhe për fenë”.

Ne sot këtu në mërgim, nuk kanosemi prej armikut tonë shekullor i cili ka dashur të na shfarosë prej dheut, por kanosemi prej asimilimit dhe tjetërsimit!

RESPEKTI NDAJ PRINDËRVE

Ebu Hurejre r.a. tregon se Pejgamberi a.s., duke hipur në minber tha:

"Amin, amin, amin!" Sahabët i thanë: "O i Dërguar i Allahut, duke hipur në minber, të dëgjuam duke thënë: amin, amin, amin!" Tha: "Me erdhi Xhibrili a.s. e më tha: "kush nga umeti yt i ka prindërit e tij gjallë dhe përmes tyre nuk e fiton Xhenetin, e largoftë Allahu nga mëshira e Tij! Thuaj "amin!", e unë thashë: "amin!"; cili prej umetit tënd e mbërrin Ramazanin e nuk i falen mëkatet dhe hyn në xhehenem, e largoftë Allahu nga mëshira e Tij, thuaj "amin!", e unë thash: "amin!"; dhe në fund më tha: kush prej umetit tënd e dëgjon emrin tënd dhe nuk çon salavate për ty, e largoftë Allahu nga mëshira e Tij, thuaj "amin!", e unë thashë: "Amin!"³³.

Në këtë ligjëratë do fokusohemi pikërisht në pikën e parë të këtij hadithi shumë domethënës. Respekti që ne duhet t'ua kushtojmë prindërve tanë është një nga parimet e kësaj feje. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse (ihsana) ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese)"³⁴

Nga ajeti kuptohet, se Zoti respektin ndaj prindërve e ka bashkuar me besimin në Të, kurse mosrespektin ndaj tyre e ka krahasur me shirkun apo përshekrimin Allahut xh.sh. shok në adhurim. Kjo pra

³³ Transmeton Ahmedi

³⁴ Kur'an, Sure Isra: 23

është një detyrë e lartë te i madhi Zot. Fjala “Ihsana” në këtë ajet kur’anor ka disa kuptime, ne do t’i veçojmë vetëm disa: të bësh më të mirën për ta, të tregosh respektin më të madh ndaj tyre, të bësh durim me ta, të kesh mendimin më të mirë për ta, t’i gëzosh ata pa masë, e kështu me radhë. E çuditshme është se Allahu xh.sh. këtu ka përzgjedhur fjalën “Validejni”, e cila është dysia e fjalës “Valid” (babë) dhe “validah” (nënë), që në shqip domethënë *prind*, në kohën kur fjala më e përshtatshme dhe më popullore për t’i thirrur prindërit është sinonimi i tyre “Ebu” (baba) dhe “Ummu” (nënë). E gjithë kjo nuk është rastësisht, sepse arabët me fjalën “ebu” dhe “ummu” i thërrasin prindërit që janë kujdesur për edukimin e tyre, pa pasur rëndësi se i kanë lindur ose jo, kurse kur përmenden prindërit e tyre biologjik, të cilët ndoshta edhe nuk janë kujdesur për ta, por vetëm i kanë lindur dhe i kanë braktisur, përmendet “valid” dhe “validah” që rrjedh nga fjala arabe *velede* që domethënë “të lindësh”. Me këtë, Allahu xh.sh. na mëson që ne duhet të jemi respektues dhe bamirës ndaj prindërve tanë, edhe nëse ata pas lindjes na kanë braktisur dhe nuk kanë jetuar me ne, apo nuk na kanë dashur, sepse edhe nëse ata na kanë braktisur, kjo nuk domethënë se nëna nuk ka përjetuar dhimbje gjatë lindjes tonë dhe babai nuk ka përjetuar strese gjatë shtatzënisë dhe lindjes së bashkëshortes së vet. Në ditët e sodit kemi shembull kur babai, i penduar për braktisjen e fëmijës, e kërkon të birin dhe i përgjërohet që të pajtohen, por djali, pa iu dridhur qerpiku, i thotë “nuk të dua, sepse ti nuk ishe pranë meje kur më së shumti pata nevojë për ty, kur unë bëra hapat e para, kur thashë fjalët e para, kur shkova në shkollë, etj.”. Allahu xh.sh. thotë: “kur të arrijnë pleqërinë në kujdesin tënd”, kjo nënkupton se kërkesat dhe nevojat e tyre rriten me kalimin e kohës dhe ata bëhen tepër emocionale në pleqëri, prandaj ky është momenti kur ti më së shumti duhet të tregohesh i durueshëm me ta. Pikërisht kjo është koha që ndalohet t’u thuash atyre “of”, as mos u bëj i vrazhdë para tyre, mos e

përplas derën në sy të tyre, pra mos u hidhëro me ta në asnjë mënyrë. Allahu xh.sh. vazhdon dhe thotë:

“Dhe në shenjë mëshirë shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues”,

ky është një nga ato ajete që na këshillon ta zhvillojmë imagjinatën tonë. Allahu xh.sh. këtu përmendën krahët mbrojtës, gjë e cila na kujton zogun i cili për të mbrojtur të vegjlit e saj nga rreziku i jashtëm i zgjatën krahët. “Dhe të lutemi për ta duke thënë: Zoti im, mëshiroi ata dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”, Allahu më këtë pjesë të ajetit na mëson se ne nuk jemi në gjendje t’ua shpaguajmë atyre gjithçka që ata kanë bërë për ne, por vetëm Allahu xh.sh. mund ta bëjë këtë. Kur të kujdesemi për ta, nëse gjatë shërbimit kur ata na kërkojnë diçka mrrolemi, themi “uf” dhe tregojmë shenja përtacie apo nervoze, atëherë me këtë veprim fitojmë hidhërimin e Zotit.

Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë gjithashtu thotë:

“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjidhënia e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa ta arrijë pjekurinë e vet, dhe kur t’i mbushë dyzet vjet ai thotë: “Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira të cilat i pëlqen Ti dhe m’i bëj të mirë pasardhësit e mi, unë pendohem te Ti dhe unë jam me muslimanët”³⁵.

Në këtë ajet përmenden në detaje katër vështirësitë që kalon nëna me fëmijët e vet: me mundim e barti gjatë shtatzënisë; me vështirësi e lindi, e barti atë pas lindjes tridhjetë muaj dhe i dha gjë po aq kohë ose më pak. Por Allahu xh.sh. këtu përmendën se kujdesi i nënës për



fëmijën e saj nuk përfundon me tridhjetë muajt, por zgjatën derisa ky fëmijë të bëhet i aftë dhe të arrijë moshën e pjekurisë; dhe pastaj, për çudi, Zoti përmendën kohën e krizës së moshës së mesme që është mosha dyzet vjeçare. Menjëherë na lindën një pyetje:

Pse Zoti fazat e fëmijërisë së njeriut i përmendën në detaje dhe pastaj kapërcen shumë vite të moshës së rinisë dhe pjekurisë dhe përmendën moshën dyzet vjeçare?

Zoti e di më së miri, por ajo që na shkon ndërmend është kjo: Allahu xh.sh. s'ka nevojë t'ia kujtojë njeriut fazën e rinisë dhe pjekurisë, sepse kjo është një fazë kur njeriu e ka memorien e fortë dhe e di çdo gjë shumë mirë dhe në detaj, kurse periudhën e fëmijërisë ia tregon më gjerësisht sepse njeriu këtë fazë të jetës nuk e mban mend. Kjo është periudha kur prindërit janë kujdesur pa masë për fëmijët e tyre, pavarësisht se ata kur rriten nuk i mbajnë mend ato momente gëzimi p.sh. momentin kur për herë të parë prindërit ia kanë lënë emrin, kur e kanë bërë “synet”, etj; apo momentet e sprovës p.sh. kur është sëmure dhe prindërit e tij janë merakosur dhe i kanë qëndruar pranë derisa është shëruar. Prandaj Allahu xh.sh. na tregon këto detaje që ne kur të rritemi të mos tregohemi mosmirënjohës ndaj tyre. Sa herë që i harrojnë mundimet e tyre, t'i kthehemi Librit të Zotit dhe t'i kujtojmë këto ajete, e nëse nuk i kuptojmë sot, do t'i kujtojmë nesër kur Zoti do na gëzojë me fëmijët tanë.

Nuk më hiqet prej memories dita kur nëna ime më pyeti: “A e do fëmijën tënd?” Iu përgjigja: “E si mund të mos e duash fëmijën tënd!”, ma ktheu: “E do shumë?”, - “Më shumë se kaq s'ka ku shkon.” Ia ktheva unë. Pastaj nëna më tha: “Tani do të fillosh ta kuptosh se sa të dua edhe unë.”

Allahu xh.sh. më tej e përmendën moshën e të dyzetave sepse është mosha e krizës së mesme, kur njeriut fillojnë gradualisht t'i vdesin anëtarët më të vjetër të familjes: gjyshi, gjyshja, nëna, babai etj., dhe ai fillon të frikësohet edhe për jetën e tij, prandaj Zoti thotë

se në këtë moshë njeriu duke formuar tashmë edhe familjen e tij të re fillon të kuptojë sakrificat e prindërve të tij dhe thotë: “Ma mundëso të jem falënderues ndaj Teje që më dhe të mira të panumërta në familjen dhe ma mundëso që të jem falënderues edhe ndaj prindërve që më edukuan në Islam! Ashtu siç më mundësove të rritem në familje të shëndoshë, ma mundëso që të kem edhe pasardhës të mirë dhe të shëndoshë, të cilët do të më kujtojnë nesër se sa sakrifikoj unë sot për ta, ashtu siç prindërit e mi sakrifikuan dje për mua!”

Muhamedi a.s. jetoi jetim, por kjo nuk e pengoi atë që të na këshillojë neve për respektin që duhet të shprehim karshi prindërve tanë. Një person, erdhi tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe kërkoi leje nga Pejgamberi a.s. që të merr pjesë në Xhihad. Pejgamberi a.s. e pyeti:

“A i ke të gjallë prindërit?” Ai iu përgjigj: “Po.” Pejgamberi a.s. i tha: “Xhihadi yt është tek ta (tek kujdesi ndaj tyre).”³⁶.

“E kam pyetur Pejgamberin a.s. se cila vepër është më e mira? Pejgamberi a.s. u përgjigj:

“Falja e Namazit në kohën e vet.” I thashë: “Pastaj cila?” Tha: “Respektimi i prindërve.” I thashë: “Pastaj cila?” Tha: “Xhihadi në rrugën e Allahut”³⁷.

Transmeton Ebu Darda r.a. se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *“Prindërit janë dera e mesme e Xhenetit, pra nëse dëshiron, humbe ose fitoje atë.”³⁸*

Do ta përmbyll këtë ligjëratë me dy shembuj nga jeta e Muhamedit a.s. që tregojnë për vlerën e respektimit të prindërve në Islam. Një ditë Muhamedi a.s. thotë:

Njeriu më i mirë prej Tabi’inëve³⁹ është personi me emrin Uvejs Ibnu Amir, ai do të vijë prej Jemeni prej fisit Karan. Ai kishte lebrozë por

³⁶ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

³⁷ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

³⁸ Transmeton Tirmidhiu

është shëruar krejtësisht (përveçse që i ka ngelur një shenjë prej saj në shpatull) dhe ai ka nënë dhe kujdeset për të me respekt, nëse ai i lutet Allahut xh.sh. Allahu xh.sh. ja pranon lutjet, prandaj nëse e takoni, kërkon që të lutet për ju!”⁴⁰

Ai që e informoi Muhamedin a.s. për këtë njeri, përmes Xhibrilit a.s., ishte Allahu xh.sh., kurse arsyeja pse këtij njeriu i pranohej lutja ishte kujdesi dhe përkushtimi për nënën e tij të verbër, saqë nuk e linte atë për asnjë moment vetëm. Allahu xh.sh., për këtë kujdes që Uvejsi tregonte për të ëmën, i kishte dhënë shumë shenja të mira të cilat tregonin se Zoti e do atë, pavarësisht se ai akoma s’ishte bërë musliman. Një natë, para se muslimanët ta çlirojnë Jemenin, në shtëpi të Uvejsit ishte harxhuar vajguri për llambën e natës, por duke qenë se nëna e tij ishte e verbër, Uvejsi tha në vete: “Le ta provoj edhe unë një herë ndjesinë e të qenët i verbër, njësoj si ime ëmë!”, prandaj nuk shkoi të blejë vajgur, por qëndroi me nënën e tij në errësirë. Ditën e nesërme kur muslimanët u futën si çlirimtarë, në rrugët e qytetit, një thirrës prej sahabëve e lexoi me zë të lartë këtë ajet, jehona e të cilit arriti deri në brendësi të shtëpisë së Uvejsit:

“Atij të cilit All-llahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.”⁴¹

Kjo ishte e mjaftueshme që Uvejsi qysh atë ditë të bëhet musliman dhe tërë jetën t’ia kushtojë Islamit. Shenja e dytë që tregonte se Allahu xh.sh. e do Uvejsin, ishte vetë fakti se ai kujdesej për nënën e tij, por sëmundja që ai e kishte në lëkurë (lebrozë) e pengonte shumë në kujdesin ndaj saj dhe në përhapjen e Islamit te bashkëqytetarët. Ata kishin frikë prej sëmundjes së tij se mos është ngjitëse. Kjo sëmundje dita-ditës filloi t’ia vështirësojë jetën dhe filloi ta rraskapitë, kështu që, një ditë iu lut Zotit që ta shërojë nga kjo

³⁹ Gjenerata e dytë; ata që nuk janë takuar fizikisht Muhamedin a.s. por kanë takuar shokët e tij apo sahabët

⁴⁰ Transmeton Muslimi

⁴¹ Kur’an, Sure Nur: 40

sëmundje, por t'i le vetëm një shenjë në trup, ashtu që, sa herë që ta sheh shenjën, t'i kujtohet mirësia dhe ndihma që ia kishte dhënë Zoti xh.sh.. Nuk zgjati shumë kohë, Zoti ia pranoi edhe këtë lutje, prandaj njeriu, me përkushtim maksimal vazhdoi në përhapjen e fesë islame. Uvejsi kishte edhe një dëshirë të madhe, të cilën nuk guxonte t'ia tregojë nënës, dëshironte të shkojë në Medinë dhe të takohet me Muhamedin a.s.. Një ditë, nëna e vëren se djali ishte i mërzhitur, andaj e pyeti për shkakun, dhe kur Uvejsi ia tregoi arsien dhe dëshirën e madhe për ta takuar Muhamedin a.s., ajo e lejoi që të shkojë me një kusht, të mos qëndrojë gjatë atje, por të kthehet shpejt. Uvejsi me gëzim të madh mori një udhëtim të gjatë, afërsisht një mijë kilometra, vetëm për ta takuar Muhamedin a.s.. Kur trokiti në derë, e kuptoi se Muhamedi a.s. nuk ishte në shtëpi, kishte dalur për t'i kryer disa punë. Uvejsi u mërzhit shumë, por nuk e shkeli premtimin e nënës, vendosi të kthehet, prandaj i përлотur e mori rrugën e kthimit dhe u kthye pa e parë Muhamedin a.s.. Kur Muhamedi a.s. u kthye në shtëpi, familja menjëherë i tregoi se dikush e kishte kërkuar. Në ato çaste vjen Xhebraili dhe i tregon se kush është Uvejsi ibnu Amir el Karani.

Kaluan shumë vite, por Uvejsit asnjëherë nuk iu dha rasti të takohet me Muhamedin a.s.. Kjo e privoi atë që të jetë sahabi (shok i Muhamedit a.s.), por respekti që ai tregoi për nënën, e bëri tabi'inin më të dalluar, saqë edhe vetë sahabët ia kishin zilinë. Transmetohet, se kur halifi Omer r.a. drejtonte pushtetin, sa herë që kryente haxhin, shkonte pranë grupeve të hanxhinjve nga Jemeni dhe pyeste se mos vallë në mesin e tyre ishte edhe Uvejsi, por çudi, ai edhe haxhin s'kishte pasur mundësi ta kryejë për shkak të kujdesit të vazhdueshëm ndaj nënës së tij të verbër. Pasi ndërroi jetë e ëma e Uvejsit, puna e parë që bëri ai ishte shkuarja në haxhillëk; deshi i madhi Zot që atë vit Omeri r.a. përsëri të vijë në haxh, dhe pasi pyeti për Uvejsin, i treguan se te hanxhinjtë e Jemenit qenka një farë Uvejsi. Gëzimi që e kaploi Omerin r.a. ishte i papërshkrueshëm, sepse

do ta vërtetonte një informacion profetik të Muhamedit a.s.. Pasi Omeri r.a. e përshëndeti dhe u prezantua se kush ishte, e pyeti:

“A jeni ju Uvejs ibnu Amir?” Uvejsi tha: Po, unë jam! A jeni ju nga fisi Karan i Jemenit? Pyeti përsëri Omeri r.a.. Uvejsi, i habitur ia kthen të njëjtën përgjigje. “A ka mundësi ta hapni shpatullën të shikojmë shenjë në lebrozës (sëmundjes)?”, e pyeti Omeri r.a.. Uvejsi i tha: “Po kush të ka treguar se kam shenjë të lebrozës, o prijës i besimtarëve?” Omeri r.a. i tha: “Më ka lajmëruar i Dërguari i Allahut!” Kështu, të dy i kaploi vaji dhe u përqaftuan bashkërisht. Omeri pastaj i tha: “O Uvejs, lute Zotin për mua! Muhamedi a.s. ka thënë se Zoti t’i pranon lutjet, sepse je kujdesur për nënën tënde të verbër, prandaj thoshte: “Kërkoni prej tij që të lutet për ju, sepse lutja e tij pranohet te Zoti.” Uvejsi r.a. me lot në sy i tha: “A vërtet Muhamedi a.s. ka thënë kështu për mua?! I lartësuar qoftë Allahu xh.sh. që më dha një nënë si ajo, nga e cila kam përfituar shumë të mira: pranova Islamin, u shërova prej lebroze dhe tani përmendem prej Pejgamberit a.s. dhe prej Omeri r.a.! O prijës i besimtarëve! Po kush jam unë që të lutem për ty? Ti je Omeri r.a., prijësi i besimtarëve, shoku më i ngushtë i Muhamedit a.s., ti që Zoti ta ka garantuar Xhenetin për së gjalli!” Omeri tha: “Unë s’jam askush në krahasim me ty, sepse mua nuk më ka përmendur Muhamedi a.s. për këto gjëra, për të cilat të ka përmend ti. Ti je kujdesur për nënën tënde të verbër, prandaj të kërkoj që ta lusësh Zotin për mua!” Uvejsi ia ktheu: “Pasi insiston kaq shumë dhe beson kaq bindshëm në këtë gjë, do t’i lutem Zoti për ty, por kam një kusht, të mos u tregosh të tjerëve se Uvejsi gjinden në mesin tuaj, sepse pastaj do të vijnë të gjithë dhe do të kërkojnë të lutem për ta. Kam frikë se do të bëhem kryelartë me këtë privilegj që më ka dhënë Zoti, kurse unë jam thjesht një rob i Zotit që kam ardhur në haxh për t’iu lutur Allahut të m’i falë gabimet, njësoj si ju.” Omeri r.a. kuptoi modestin e tij dhe e pranoi kushtin⁴².

⁴² Transmeton Asir ibn Xhabiri

Rasti i dytë është hadithi kur një njeri ankohet te Muhamedi a.s. se babai i tij ia vjedhë të hollat. Muhamedi a.s. u habit prej këtij rasti të rrallë dhe urdhëroi që edhe babai të merr pjesë në seancën gjyqësore që do ta udhëhiqte vet Muhamedi a.s. Derisa babai ishte duke ardhur rrugës për te Muhamedi a.s. zbriti Xhibrili a.s. dhe i tha Muhamedit a.s.:

“Më tha Zoti ta pyesësh se çka ishte duke menduar derisa ishte duke ardhur tek ti.” Kur u paraqitën para Muhamedit a.s., djali dhe babai, Muhamedi a.s. i tha babait: “Yt bir të akuzon se ia vjedhësh të hollat, çfarë mendim ke për këtë?” Plaku ia ktheu: “O i Dërguar i Allahut, unë këto të holla ia marr djalit sepse me to kujdesem për fëmijët e tij!” Muhamedi a.s. e pyet: “Më trego çka ishe duke menduar rrugës kur vije tek unë?” Plaku tha: “O i Dërguar, të lutem mos më fut ngushtë sepse nuk dëshiroj të bisedoj në prezencë të djalit!” Por pasi Muhamedi a.s. insistoi shumë, ai u përgjigj se ishte duke e menduar të kaluarën, dhe kjo e shtyri që të thurën disa vargje! “Na e trego!”, tha Muhamedi a.s.. Plaku vazhdoi me pikëllim dhe tha:

“O djali im, ti ishe gëzimi më i madh në familjen tonë, ti u bërë drita e syve tonë, nuk kishte gëzim më të madh për ne kur t'i qeshje, dhe as moment më të vështirë për ne kur t'i qaje. Kur sëmureshe natën ne rinim zgjuar derisa të qetësohesh, e ne pastaj qetësoheshim vetë, derisa ishe i vogël, të ushqenim me ushqimin që e fitoja me shumë mund dhe sakrificë. Nuk mund të përshkruhet dita kur bërë hapat e para në jetë dhe kur the fjalët e para, ky gëzim dita-ditës shtoheshte kur ti u bërë i aftë vetë të hash, vetë të pish dhe vetë të nisish të shkosh në shkollë. U kujdesëm për ti derisa u rrite, dhe pastaj ne filluam të rehatohemi, sepse ti e more veten kurse ne edhe pse filluam të plakemi e dinim se ashtu siç u kujdesëm ne për ti ashtu edhe ti do kujdesesh për ne, por fatkeqësisht nuk ndodhi ashtu, ti prej ditës që u martove dhe formove familjen tënde, nise në rrugët djallëzore: harrove Zotin prindërit dhe harrove edhe fëmijët e tu. Nise të punosh, por parat i harxhoje në rrugë të këqija dhe unë prej kësaj dite nisa tët

marr disa të holla që të kujdesem për rritjet e fëmijëve të tu! Mos o bir! Mos bën kështu se është keq, mos se me iu lut Zotit kundër teje, mallkimi im do bie menjëherë mbi kokën tënde, por të kam fëmijë dhe nuk e bëj këtë sepse ti do mbetesh përsëri drita e syve të mi tashmë të verbër.”

Kur i përfundoi vargjet, Muhamedi a.s. si asnjëherë më parë u çua në këmbë dhe pamë se mjekra e tij ishte lagur me lot, i pikëlluar dhe njëkohësisht i nervozuar, e kapi për teshash në gjoks djalin dhe i tha:

Ti dhe gjithçka posedon i takoni babait tënd!”⁴³

O ju të rinjë, ju jeni gëzimi familjar, ju jeni drita e syve të prindërve tuaj. Mos ua thyeni zemrën atyre, kur ata t’ju kërkojnë diçka, përgjigjuni menjëherë. Nuk guxoni t’u thuani as “of”, sepse ofkëllima ndaj tyre ngjitet lart në qiell dhe një ditë do t’ju kthehet si rrufe dhe do t’ju shkatërrojë, prandaj keni kujdes se “Xheneti është nën këmbët e tyre”.

⁴³ Transmeton Ibn Maxhe dhe Ebu Davudi

FAMILJA ËSHTË XHENETI I KËSAJ BOTE

Mrekullia më e madhe e Allahut Fuqiplotë është vetë njeriu. Allahu njeriun e dalloi nga të gjitha krijesat e tjera duke e krijuar në formën më të bukur, duke i dhënë mendje dhe arsye që të logjikojë drejt, zemër që të dashurojë dhe intuitë të jashtëzakonshme që të përballet me natyrën e egër që e rrethon. Por brenda shoqërisë njerëzore ekziston edhe një mrekulli e dyfishuar që e ka emrin “familje”. Nëse njeriu në këtë jetë përballet me shumë prova, mundime, vështirësi, sëmundje, varfëri, humbje nga të dashurit etj., ai fillon të mendojë se jeta në këtë botë i është kthyer në ferr (xhehenem). E vetmja gjë që njeriut i jep shpresë, e motivon që të vazhdojë më tutje, e nxit që të bën vepra të mira, është familja e tij. Familja për njeriun është gjëja më e shtrenjtë, ai bën gjithçka për të, ai madje nëse e kërkon nevoja jep edhe jetën për të. Familja me pak fjalë, është xheneti i kësaj bote. A doni të imagjinoni se si mund të jetë ndjesia e të jetuarit në parajsë? E keni shumë të lehtë, vetëm gjeni prehje në familje, qëndroni sa më gjatë afër tyre.

Dua të jap disa këshilla për anëtarët e familjes dhe në fillim do i drejtohem shtyllës së shtëpisë, pikërisht burrit:

“Ti o njeri, ke përgjegjësi që të kujdesesh për mirëmbajtjen e familjes, si në aspektin financiar ashtu edhe në sigurinë fizike dhe psikologjike të tyre. Puno, se puna është ibadet. Mos u dorëzo para familjes! A e kupton se djali dhe vajza jote kur pyeten në shkollë se çfarë punon babai yt, ai/ajo turpërohet të tregojë se ti je një dembel i papunë. Kur të troket dera e shtëpisë, mos u frikëso ta hapish derën sepse je burrë dhe është turp, e nëse je në natyrë i dobët, mos u trego para tyre frikacak, por përtype frikën dhe mos i thuaj gruas “dil shiko kush troket në derë, dhe po më kërkuan thuaju që s’jam këtu!”. Mos qëndro jashtë shtëpisë me orë të tëra pa asnjë arsye, sidomos gjatë orëve të vona të natës, por kthehu në shtëpi se familja ka nevojë për

ty! Mos u trego baba i mirë në klub para shokëve, por tregohu baba i mirë duke i përkëdhelur fëmijët e tu! Mos u trego bashkëshort i mirë në rrugë, por dëshmo dashurinë ndaj gruas në shtëpinë tënde! Mos respekto të huajt para se të respektosh nënën dhe babanë të moshuar të cilët po të presin me padurim sikur të jesh akoma fëmijë, sepse për ata është ndalur koha dhe derisa të vdesin, ti do të ngelësh fëmija i tyre i vogël.

Bashkëshort dhe prind i mirë është ai i cili kur hyn në shtëpi, sjell gëzim në familje, kurse fatkeqësi është atëherë kur gëzimi në familje kthehet kur burri del prej shtëpisë.

Raporti i burrit me gruan e tij

Nëse do ta kishim konsideruar këtë botë kalimtare burim i pasurive të mëdha, guri më i çmuar i saj është të kesh një grua të mirë. Bashkëshortja është dimension i më i lartë i lumturisë së amshuar dhe dëshira e parë njerëzore. E gjitha bazohet në ndodhinë e babait tonë Ademit a.s., i cili pavarësisht se jetonte me të gjitha të mirat e parajsës, ai ndjente vetmi dhe zbrazëti në zemrën e vet dhe Zoti e plotësoi këtë zbrazëti kur prej brinjës së tij krijoi gruan e parë në Tokë, Havën. Gruaja e plotëson fenë e burrit, kurse mungesa e saj e izolon burrin dhe ka gjasa të mëdha ta shtyjë atë në mëkate të mëdha, jo rastësisht Muhamedi a.s. i ka urdhëruar të rinjtë që s'kanë mundësi të martohen, të agjërojnë dhe të shpëtojnë prej mëkateve. Muhamedi a.s. ka thënë:

“O ju të rinj, kushdo që ka mundësi të martohet prej jush, le të martohet, sepse kjo është mënyra më e mirë për uljen e shikimit dhe mënyra më e mirë për mbajtjen e dëlirësisë. Ndërsa kush nuk ka

mundësi të martohet, atëherë le të agjërojë, sepse agjërimi është pengues i epshit".⁴⁴

Respektimi dhe nderimi i gruas është traditë profetike dhe këshillë e Muhamedit a.s.. Ai shpeshherë thoshte:

*"Keni kujdes në gratë, sepe ju i keni marrë ato me amanetin e Allahut"*⁴⁵,

në një rast tjetër ka thënë:

*"Kjo dynja është kënaqësi dhe kënaqësia me e mirë e saj, është një grua e mirë."*⁴⁶

Ai për dashurinë dhe simpatinë që kishte ndaj grave të veta e falemderonte vetëm Allahut xh.sh., sepse këtë dhuratë ia kishte dhënë Vetë Zoti. Muhamedi a.s. në një rast tha kështu:

"Unë kam qenë I pajisur fortë me dashurinë ndaj Hatixhes"

dhe e bukura e këtij hadithi është se transmetohet prej gruas tjetër të Muhamedit a.s., Ajshes r.a..

Ne gëzohemi që jemi popull i një profeti kaq të njerëzishëm, prandaj duhet që të mos na vjen turp t'i bashkëngjitemi këtij falënderimi drejtuar Allahut për bashkëshortet tona.

Disa njerëz të prishur thonë se me kalimin e kohës, burri mërzitët me gruan e vet, por kjo fjali djallëzore s'mund të konsiderohet e mirëqenë. Më habiti tregimi i një plaku simpatik gjatë një spektakli të quajtur "kutia e fundit". Ai gjatë bisedës së lirë, kur moderatori e pyeti se çka ka mësuar nga jeta, u përgjigj:

"Jeta ka lumturi, gëzim, sprova dhe hidhërime, por ndjej privilegj të them se gjatë gjithë këtyre viteve dashuria që ndaj për gruan time ka ngelur si në fillimet e saj".

⁴⁴ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

⁴⁵ Transmeton Ibn Hishami

⁴⁶ Transmeton Muslimi

Për të dëshmuar atë që sapo tha, plaku ndërroi kutinë e vet të fatit me një kuti që përputhej me ditëlindjen e gruas, duke qenë i bindur se aty qëndron milioni, si përfundim, në etapat e lojës, atij iu ofrua një ofertë e mirë vetëm nëse ai do ta dorëzonte kutinë. Pas shumë insistimeve edhe nga publiku, plaku u shpreh kështu:

“Kutinë që spikatën ditëlindjen e gruas sime do ta jap për ofertën tuaj, por asesi dashurinë që ndjej për të.”

Për ironi të fatit, në kutinë e dorëzuar ishte fshehur milionëshi.

Shpesh habitemi me dashurinë dhe respektin që tregojnë burrat në Perëndim për gratë e tyre: ato i sodisin me ëndje, kujdesen për to, ua hapin derën e makinës, shkojnë bashkërisht në restorante luksoze, bile edhe i ushqejnë me duart e tyre në raste të posaçme, por çfarë do kishit menduar nëse ju them se këtë e ka këshilluar vetë profeti Muhamed a.s. shumë shekuj më parë:

“Lëmosha më e madhe është kafshata që e vendos në gojën e gruas tënde”⁴⁷.

Kemi kënaqësinë që ti referohemi një pjese kur’anore, ku Allahu xh.sh. thotë:

“dhe prej shenjave të Tij është ajo se Ai ju krijoi juve dhe bashkëshortet tuaja prej vetes tuaj”⁴⁸.

Shprehja “prej vetes tuaj” domethënë se ato janë të barabarta me ju burrat, mendojnë ashtu siç mendoni, dashurojnë siç dashuron, kanë dinjitet njëjtë si ju, pikëllohen siç pikëlloheni, ofendohen njëjtë si ju, poshtërohen njësoj si ju etj... Në momentin kur burri mendon se është në një kategori apo klasë më të lartë dhe më të veçantë nga gruaja e vet, atëherë konsiderohet diskriminues ndaj saj. Burri që i jep të drejta vetes më shumë sesa gruas, llogaritet dhunues i të

⁴⁷ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

⁴⁸ Kur’an, Sure Rrum: 21

drejtave të saj. Allahu xh.sh. në kaptinën Nisa, na urdhëron dhe na thotë:

“çoni jetë të mirë (me respekt) me to”⁴⁹.

Si rezultat i kësaj urdhërese, dijetarët thonë se ky urdhër nuk domethënë vetëm që burri të mos e lëndojë gruan, por edhe kur ajo ta lëndojë burrin, ai duhet të jetë mjaftueshëm tolerant që t’ia falë gabimin asaj!

Në bazë të sunetit të Profetit, femrën e martojnë katër gjëra: bukuria, pasuria, origjina (familja) dhe morali i saj⁵⁰, por Muhamedi a.s. na sugjeron që të zgjedhim moralin e saj, pasi morali është i bukur, është pasuria më e madhe që prodhon origjinë të mirë, prandaj lirisht mund të themi se martesë më e lumtur në botë është atëherë kur pika e përbashkët mes mashkullit dhe femrës është Islami dhe dashuria që ndjejnë ato për Allahun xh.sh.. Dashuria që ato kanë ndaj njëri-tjetrit duhet të kultivohet vazhdimisht, ashtu siç ka nevojë lulja të ujitet ditë për ditë që të lulëzojë. Ato duhet të kenë objektiva të përbashkëta në jetë dhe të mos debatojnë apo kacafyten për imtësi, prej të cilave nuk ka dobi asnjëri prej tyre. Burri pjesën më të madhe të kohës së lirë duhet ta kalojë në shtëpi, aty ku është burimi i lumturisë së tij. Nëse puna e detyron të punojë tërë ditën dhe natën për të arritur të mira më të mëdha materiale, ajo një ditë do jetë shkatërrimtare për të. Një punë e tillë shkatërron misionin e jetës dhe qëllimin e ekzistencës së tij. Ka shumë prej tyre që shkojnë në punë para se të zgjohen fëmijët prej gjumi dhe kthehen kur ata përsëri kanë ra të flenë. Ka të tjerë që nguliten para ekraneve televizive tërë natën dhe harrojnë se bashkëshortet e tyre, pa varësisht se janë në dhomën e gjumit, ndjehen të vetmuara sikur me mijëra kilometra të jenë larg tyre.

⁴⁹ Sure Nisa: 19

⁵⁰ Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejreja

Burri duhet të tregohet mirënjohës ndaj punës së palodhshme të gruas në punët e shtëpisë dhe në edukimin e fëmijëve, kurse në raste të ndryshme, kur ajo është e stresuar apo e nervozuar, duhet të jetë tolerant dhe durimtar ndaj saj. Një banor i Medinës deshi të ankohej te prijësi i besimtarëve, Omeri r.a., për gjuhën e gjatë të gruas së tij. Kur u afrua afër shtëpisë së Omerit r.a., dëgjoi mosmarrëveshje mes tyre (Omerit dhe bashkëshortes) dhe u befasua, sepse dëgjoi se zëri i gruas ishte më i lartë se i Omerit r.a., si rrjedhojë ai kthehet pas, por largimin e tij e hetoi Omeri r.a., e pyeti për shkakun e ardhjes dhe se çfarë e shtyri që të ndërrojë mendje për t'u kthyer. Ai iu përgjigj:

“Unë erdha të ankojem për gruan time, por kur të pashë se edhe ti të bërtiste gruaja, thashë nën vete “nëse nga diçka e tillë vuan Omeri, s’ka kush që mund të shpëtojë.” Omeri r.a. buzëqeshi dhe u përgjigj: “O vëlla, ajo mban shtëpinë, më lan rrobat, më rregullon shtratin dhe m’i edukon fëmijët. Të gjitha këto i bën me durim të madh. Kush jam unë që të mos e duroj kur ajo disa herë e çon zërin lartë prej stresit të punës?!”

Ta zëmë se ti je tolerant, durimtar, i urtë etj., por pas shumë tentimesh përsëri ka zënka mes jush, ku qëndron faji? Muhamedi a.s. ka thënë:

“Betojem në Atë në duart e të Cilit është shpirti im, çdo grindje në mes të çifteve (burrit dhe gruas) do të jetë për shkak të një mëkati që është kryer nga njëri prej tyre”⁵¹.

Prandaj afroju Zotit me punë të mira dhe lute atë që të t’i falën mëkatet dhe të të jep harmoni familjare.

Në vendet e zhvilluara ku përqindja e divorceve është në masë të lartë janë hapur shkolla të ndryshme edukimi që të dy gjinitë të mësojnë të drejtat dhe detyrimet e veta dhe të palës së kundërt, me shpresë se kjo do të jetë indikator që sadopak të ulët shkalla e

⁵¹ Transmeton Ahmedi nga Ibn Omeri

divorcit. Ne nuk na duhet diçka e tillë, por na mjafton t'i dëgjojmë me kujdes fjalët e hoxhës në momentin kur na e lidhën niqahun⁵², kur ai thotë: “Bazuar në Librin e Shenjtë, Kur'anin, dhe në sunetin e Pejgamberit a.s. ju bëheni burrë dhe grua!” Duke lexuar dhe praktikuar Kur'anin dhe sunetin e Pejgamberit a.s., do t'i mësojmë të drejtat dhe obligimet e vetes dhe të partnerit tonë, kurse për ta arritur këtë mjafton të kemi vullnet të madh, dëshirë të flakët dhe besim te Zoti që ta pastrojmë rrugën e cila do të na shpjerë në lumturinë e amshueshme, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër.

Tash do t'i referohemi një ajeti kur'anor ku Allahu xh.sh. në mënyrë të pakontestueshme qëndron në mbrojtje të çdo femre të diskriminuar prej burrit të saj. Allahu xh.sh. thotë:

“Vërtet, All-llahu dëgjo i fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu; prandaj All-llahu e dëgjon bisedën tuaj, All-llahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë”⁵³.

Një ditë, derisa Muhamedi a.s. qëndronte në xhami me shokët e tij, i afrohet një grua e quajtur Haulete bint Thelebe dhe me lot në sy nisën që t'i qahet dhe t'i ankohet Pejgamberit a.s. për burrin e saj, se e ka shkurorëzuar përmes një forme që e praktikonin arabët asokohe e që quhej “dhihar”, duke i thënë: “Ti për mua tashmë je si nëna ime” domethënë ashtu siç nuk kam të drejtë t'i afrohem sime ëme, ashtu nuk dua të të afrohem edhe ti. Për këtë formë të shkurorëzimit ende s'kishte ndonjë normë islame për ta ndaluar, prandaj duke u bazuar në rregullin se “gjithçka është e lejuar prej kohës së vjetër (para islame), përveç asaj që bëhet haram në kohën Islame” Muhamedi a.s. i tha:

⁵² Kurorëzim Islam

⁵³ Kur'an, Sure Muxhadele: 1

“Më vjen shumë keq për këtë që të ka ndodhur, por ti tashmë je haram për të!”

Kjo grua nisi që t’i arsyetohet Muhamedit a.s. sepse ajo është tepër e moshuar dhe e dobësuar dhe nuk ka mundësi të jetojë pa përkrahjen e burrit, sidomos sepse ishte e varfër, por Muhamedi a.s. i ngriti krahët duke mos ditur se çfarë t’i thoshte, por për çudi ajo filloi të nervozohet se pse Muhamedi a.s. nuk i dha asaj ndonjë përgjigje më të mirë, sepse e ndjente se kjo traditë e vjetër arabe ishte diskriminuese ndaj grave; dhe tha:

“Unë ankohem tek Allahu xh.sh. për hallin tim!”⁵⁴

Të gjithë të pranishmit u shtangën dhe thanë në vete: “Si mundet kjo grua t’ia kthejë fjalën Muhamedit a.s., t’i ankohet atij dhe ta çojë zërin lartë në prezencë të tij, kur kjo është e ndaluar në Islam? Kur të gjithë mendonin se Allahu xh.sh. do ta kritikojë gruan për këto veprime, Ai xh.sh. zbriti ajetin e lartpërmendur:

“Vërtet All-llahu dëgjoi fjalët e asaj e cila bisedoi me Muhamedin a.s. lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu”⁵⁵.

Parashtrohet pyetja: Nëse Allahu xh.sh. planifikonte ta mbrojë këtë grua me ajet Kur’anor i cili ndalon “dhiharin”, pse duhej të ndodhën ky “skandal” dhe ky “debat” publik para syve të Muhamedit a.s. dhe sahabëve? Pse Allahu xh.sh. nuk ia zbriti Muhamedit a.s. ajetet e ndalesës së “dhiharit” akoma pa mos ardhur të ankohet kjo grua?

Sepse Allahu xh.sh. dëshironte që të drejtën e gruas që abuzohet dhe diskriminohet prej burrit, ta mbrojë me debat publik dhe në fund duke zbritur ajete kur’anore përsëri të fitojë e drejta e gruas.

⁵⁴ Transmeton Buhariu dhe Hakim Abu Abdullah nga Ajsheja r.a.

⁵⁵ Kur’an, Sure Muxhadele: 1

Gruas në Perëndim i duheshin të kalojnë mijëra vite me shumë demonstrata dhe greva për t'i fituar të drejtat e veta, në kohën kur këto të drejta në Islam i ka gëzuar prej në kohën e Muhamedit a.s.. Në anën tjetër, sot edhe në Botën Lindore diskutohen të drejtat elementare të gruas, saqë mohohet që gruaja të vozisë edhe makinën e saj, kurse në kohën e Muhamedit a.s. ajo ka pasur të drejtë të ankohet para Pejgamberit a.s.. Allahu vazhdon më tej dhe thotë:

“Ai dëgjon bisedën tuaj”

O ju njerëz, Allahu xh.sh. vërtet dëgjon të gjitha bisedat sekrete të të gjitha çifteve bashkëshortore, ankesat e atyre miliona e miliarda grave që diskriminohen para burrave të tyre, por prej turpi nuk kanë kujt t'i ankohen sepse pastaj ndoshta rihen dhe vriten prej burrave të tyre! Këta janë burra qyqarë mbrohen pas traditës së vendit, se gruaja nuk guxon të ankohet jashtë shtëpisë për çfarëdo që t'i ndodhë brenda në shtëpi. Pas gjithë këtyre abuzimeve të neveritshme që bën burri, ai përsëri njihet si njeri i mirë në shoqëri, sepse askush nuk e di se çfarë malli është ai në shtëpinë e tij. Allahu xh.sh. vazhdon t'i mbrojë të drejtat e gruas me ajetet në vijim:

“Ata prej jush që bëjnë "Dhihar" (epërsia ime ndaj teje është haram si epërsia ndaj nënës sime) ndaj grave të veta, në të vërtetë ato nuk janë nënat e tyre, nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata, ndërsa ata janë duke thënë fjalë të irtuara dhe gënjeshtër, por All-llahu është që lë shumë pa marrë në përgjegjësi dhe shumë falë. Ata që krahasojnë (me nëna) dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj zmbropsen nga ajo që kanë thënë, janë të obliguar që para se të kontaktojnë ndërmjet vete ta lirojnë një rob. Kjo është dispozitë me të cilën porositeni, e Allahu është i njohur hollësisht me atë që ju punoni. E kush nuk gjen (rob për lirim), atëherë le të agjërojë dy muaj rresht para se të kontaktojnë, e kush nuk mundet, atëherë le t'i ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo (dispozitë) ju

shërben) për të vërtetuar ju se besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij (e jo zakonet injorante). Këto, pra janë përcaktimet e Allahut. Ndërkaq, mohuesit kanë dënim të rëndë⁵⁶.

Raporti i gruas me burrin e saj

Tash po të drejtohem ty oj motër muslimane! Ti je gruaja dhe nderi i shtëpisë, ti Allahu xh.sh. të mundësoi detyrën më të mirë në botë, por njëkohësisht më të rëndësishme, edukimin e fëmijëve. Edukimi që ti duhet tua japish fëmijëve duhet të jetë në një vijë me atë të burrit. Mos u thuaj vajzave që të vishen me mini-funde, ndërkohë që babai u thotë të mbulojnë trupin! Mos u thuaj të dalin të zbavitën (me haram) përderisa babai u ka thënë që të jenë të kujdesshme dhe të mos ekspozohen shumë! Fund i fundit, ato në të shumtën e kohës janë me ty e jo me babanë e tyre, më në fund këshillën tënde do e marrin për bazë.

Zbukurohu për burrin tënd kur të vjen në shtëpi dhe sillu mirë me të! Kujdesu për të dhe përgjigju kërkesave të tij! Padyshim dyftytyrësia më e madh e gruas është kur ajo nuk kujdeset për veshjen e saj para burrit, por zbukurohet kur ka për të dalë në treg apo në një takim me shoqet. Një grua mund të martohet me njeriun më të keq, siç ishte Asija e martuar me Faraonin, por kjo nuk e ndryshoi atë e as besnikërinë dhe dashurinë e saj për Allahun xh.sh.. Një grua mund të martohet me njeriun më të mirë, madje edhe me Pejgamber, dhe prapë mos të hyjë në Xhenet, siç ishte gruaja e Lutit a.s.. Një grua mund të mos martohet fare, siç ishte Merjemja a.s. dhe Allahu xh.sh. ia lartësoi pozitën e saj më shumë se çdo gruaje në botë. Andaj motër

⁵⁶ Kur'an, Sure Muxhadele: 2-4

e nderuar, qëndro në rrugën e Allahut dhe mos bjerë nën ndikimin e joshjeve djallëzore!

Në vijim do ta paraqesim bisedën e një çifti bashkëshortor në prag të martesës së tyre: Gruaja i thotë burrit të saj:

“O burri im, unë jam e huaj, prandaj nuk e kam idenë për gjërat që ti i pëlqen dhe gjërat që i urren, më thuaj çka pëlqen, dhe unë do t’i bëj çdoherë, dhe çka nuk të pëlqen, që t’u shmangem atyre. Ti e di shumë mirë se ka shumë femra që njëra prej tyre mund të ishte gruaja jote, në të njëjtën mënyrë, ka shumë burra që njëri prej tyre mund të ishte burri im, sidoqoftë është caktimi i Allahut xh.sh. që unë të jem gruaja jote dhe ti të jesh burri im. Prandaj, bëhu besimtar kur të më trajtosh dhe apliko ajetin e mëposhtëm:

“e (pastaj) ose jetë e njerëzishme bashkëshortore ose shkurorëzim me mirëkuptim”⁵⁷.

Ai ia ktheu: “The disa fjalë të cilat nëse i kthen në vepra, do të shpërblehesh dhe nëse nuk i kthen, fjalët do të kthehen kundër teje. Unë i pëlqej këto e këto dhe i urrej këto e këto. Nëse gjen diçka të mirë te unë, fol për to, por nëse sheh zakone të këqija, mbaj të fshehura ato. Gruaja pyeti: “Sa herë dëshiron t’i vizitojmë prindërit tanë?” Burri iu përgjigj: “Do t’i vizitojmë kohë pas kohe, që ato të mos mërzhiten prej nesh, pasi Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vizitoji të afërmit kohë pas kohe që ata të të duan më shumë”⁵⁸!

Gruaja pyeti: “Po vizita e fqinjëve? Kë dëshiron ta mirëpresim në shtëpinë tonë?” Ai u përgjigj: “Filani dhe filani janë të mirë, por filani dhe filani nuk janë.”. Tregon burri, pasi kaloi një vit, një ditë kur u ktheva në shtëpi, aty ishte vjehrra ime, pasi e përshëndeta, ajo më pyeti: “Sa je i kënaqur me gruan tënde dhe bijën time?” U përgjigja: “Beto hem në Allahun se ajo është grua e mirë!” Pastaj ajo tha: “Një

⁵⁷ Kur’an, Sure Bekare: 229

⁵⁸ Transmeton Ajsheja r.a.



njeri asnjëherë nuk mund të dëmtohet prej një gruaje të mirë”. Pastaj ajo u kthye në drejtim të vajzës dhe i kërkoi që të jetë një grua e mirë dhe të më respektojë mua.”

MBULESA ISLAME, MJET APO QËLLIM?

Të tjerët e shohin bukurinë e femrës në trupin e saj, kurse Islami e ndryshoi këtë koncept duke thënë se kulmi i bukurisë së gruas qëndron te morali dhe dinjiteti i saj. Femra është nevoja dhe dëshira e parë në botë, ajo u krijua pikërisht atëherë kur babai i njerëzimit, Ademi a.s. ishte në mes të parajsës, i rrethuar me bukuritë e saj, me ushqimin dhe freskinë e saj, por ai përsëri ndjente një zbrazëti në shpirti, kjo zbrazëti ishte vetmia dhe mungesa e dashurisë. Njerëzimi duhej të nisë, e Allahu xh.sh dëshironte ta bëjë këtë në formën më të përsosur, duke e krijuar Havanë prej brinjës së Ademit a.s. kur ai ishte në gjumë, krijesën e parë të gjinisë së kundër, femrën. Thotë Profeti Muhamed a.s.:

“Femra është krijuar prej brinjëve të shtrembëta të burrit (prej Ademit), dhe ndoshta nuk të përshtatet në atë që dëshiron ti. Edhe nëse dëfrehesh me të, dëfrehesh ashtu siç është ajo e shtrembër. E nëse tenton ta drejtosh, atëherë e ke thyer atë, e thyerja e saj është shkurorëzimi.”⁵⁹

Pse e krijoi Havën nga brinja e Ademit a.s., e jo nga balta njësoj si Ademi?

Arsyeja e parë është që femra të mos paraqitet si krijesë dualiste, e ndarë dhe e veçuar nga burri, konkurruese dhe kritikuese ndaj tij, por si krijesë që ka të njëjtën gjenezë me Ademin dhe përkrahëse e tij, keshilluese dhe mësuese e burrit, t’i dhimbset ai dhe ta luajë rolin e edukatores shpirtërore për burrin.

Arsyeja e dytë është fakti se brinja në anatomi është një asht i cili i shërben njeriut si parzmore (mburojë) e gjoksit dhe e zemrës, prandaj krijimi i gruas së parë nga brinja e burrit është shenjë se gruaja në të ardhmen e gjirit njerëzor do të jetë mburojë morale për burrin,

⁵⁹ Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejra r.a.

ashtu siç është brinja mburojë për zemrën dhe mushkëritë në trupin e njeriut. Unë besoj se edhe sot e kësaj dite, edhe pse jeta është bërë dinamike, njeriu është bërë egoist dhe mendon se mund të mbijetojë vetë në këtë botë, burri kurrë nuk mund të përparojë pa ndihmën dhe përkrahjen e gruas, por edhe gruaja nuk mund të mbijetojë pa përkujdesjen dhe angazhimin e burrit.

Motër besimtare! Më lejo të të jap disa këshilla: vazhdimisht falënderoju Allahut xh.sh. që të ka ngritur në nivel të lartë, bile edhe më lartë se vetë burri, sepse një kaptinë e tërë të dedikohet vetëm ti, ajo është kaptina Nisa (gratë)! Mos nguro, por vazhdo të bësh vepra të mira! Mos e humb shpresën në shpërblimin e Allahut xh.sh.!

Prej teje kërkohet që të mbash mbulesën islame (hixhabin), ose nëse nuk e ke, vendose atë! Hixhabi është pastërti shpirtërore, pengim i së keqes dhe bllokim i rrezikut të jashtëm që mund të të kanoset. Allahu xh.sh. thotë:

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve, le të venë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues”⁶⁰.

Kur për herën e parë u shpall ajeti që urdhëron vendosjen e mbulesës, sahabët shkuan nëpër shtëpitë e tyre dhe ua transmetuan këtë obligim hyjnor grave të tyre, por pasi gjendja ekonomike në atë periudhë kohore ishte e dobët, ata u detyruan të grisnin pjesë pëlhere nga rrobat e tyre të trupit dhe me to mbuluan flokët e tyre, saqë kur erdhi koha e namazit të radhës, nuk kishte asnjë grua në qytetin e Medines që shihej pa mbulesë.

Në vazhdimësi me argumentet kur'anore të postuara më lartë, me të drejtë pyesim:

⁶⁰ Kur'an, Sure Ahzab: 59

“Çfarë i pengon vajzat muslimane që të vendosin hixhabin?”

Në vijim do të paraqesim disa nga shkaqet dhe pengesat të cilat pengojnë implementimin e urdhëresës së hixhabit (mbulesës islame) dhe kundër argumentet fetare në lidhje me të njëjtat:

Femra e parë mund të arsyetohet se praktikon shumë nga parimet fetare, por këtë urdhër nuk mund ta aplikojë pasi i duket demode, pra ajo praktikon nga feja vetëm atë pjesë që i konvenon asaj, duke braktisur pjesën e ngelur. Kjo neglizhencë ndaj urdhrave të Zotit ka qenë arsyeja që Allahu xh.sh. i ka kritikuar hebrenjtë duke u thënë:

“A e besoni një pjesë të librit e tjetrën e mohoni”⁶¹,

të njëjtat fjalë vlejnë sot edhe për muslimanët që neglizhojnë ajetet e Zotit, kurse në një ajet tjetër thotë:

“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët”⁶².

Femra e dytë mund të arsyetohet se mbulesa islame e pengon që ta ekspozojë bukurinë e saj, duke u shprehur me cinizëm “Pse Zoti më urdhëron të mbulohem kur vetë Ai ma ka falur bukurinë?” Çdo vajzë, kur del nga shtëpia pa hixhab, me apo pa dashje, bëhet shkakatare që shumë meshkuj ta shohin atë me qëllime epshore, dhe si rezultat i këtij shikimi, ato marrin mëkate. Mbasi ajo është shkakatare kryesore e mëkateve të meshkujve, Allahu xh.sh. këto mëkate do t'i ndajë në dy pjesë: për atë që ishte shkak (femra provokuese) dhe për atë që ishte pasojë (meshkulli që u provokua dhe e pa). Prandaj, oj motër, pyete veten se sa mëkate sot u ke dhënë të tjerëve dhe sa vetes sate? Në rastin e kundërt, nëse del me mbulesë islame, sa më shumë djem muslimanë të gëzohen me mbulesën islame, kjo ti bën vigjilent në respektimin personal të urdhërave Kur'anore dhe do ti bën krenar me

⁶¹ Kur'an, Sure Bekare: 85

⁶² Kur'an, Sure Bekare: 208

fenë e tyre. Për këtë ata fitojnë shpërblime nga Allahu xh.sh., por mbasi edhe ti je veshur me hixhab, je shkaktare e shpërblimeve, atëherë Allahu këto shpërblime do t'i ndajë në dy pjesë: për atë që ishte shkaktare (vajza me mbulesë islame) dhe për atë që ishte pasojë (mashkulli që krenohet me femrën muslimane).

Femra e tretë, duke mos dashur të hyjë në këtë debat, thotë: “Ke të drejtë, por mua akoma nuk më ka drejtuar Zoti, ende s’ka ardhur koha”, duke menduar se udhëzimi në Islam është si shkopi magjik që vjen për një çast; Oj motër, dije se Allahu xh.sh. ta ka treguar rrugën e drejtë, të ka lënë të lirë të zgjedhësh mes të mirës dhe të keqes! Prej mëshirës së madhe të Tij të ka dërguar edhe Pejgamber me Libër të saktë, siç është Muhamedi a.s. dhe Kur’ani, kurse ty të ka ngelur vetëm që të zgjedhësh të mirën, të braktisësh të keqen dhe të mos fajësosh askënd tjetër për pasojat e veprimeve tua përpos vetvetes. Allahu xh.sh. thotë në Kur’an:

“Ne atyre u patën treguar rrugën e drejtë, por ata megjithatë më shumë e deshën verbërinë”⁶³.

Femra e katërt është aq shumë e prirë pas modës, saqë mendon se mbulesa islame e privon nga shijimi i të bukurës: “Motra ime! A mos vallë moda është më e dashur për ty sesa Allahu xh.sh.? Mos harro se në çastet e fundit të jetës do të kesh shumë nevojë për dikë! Atëherë, kujt do t’i kërkosh ndihmë, Zotit apo modës? Pastaj, kush të ka thënë se mbulesa e zbeh bukurinë tënde? Ti mund të kesh hixhab dhe përsëri të jesh shumë e bukur, mjafton që mbulesa të mos jetë provokuese dhe të bëhet për ta kënaqur Krijuesin.

Historia vazhdimisht na ka folur për jetën e grave të mëdha, gra që kanë sakrifikuar dhe kanë dhënë kontribut për mbarë njerëzimin, saqë prej në lashtësi është e njohur thënia:

“Pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua e mençur.”

⁶³ Kur’an, Sure Fussilet: 17

Të këshilloj që të lexosh më shumë për jetën e grave (sahabeve) të kohës së Muhamedit a.s., të cilat edhe pse ishin gra të zakonshme, ashtu siç je edhe ti, me veprat e tyre u futën në fletët e historisë, madje disa prej tyre përmenden edhe në Kur'an. Ti mund ta quash veten çka të duash dhe si të duash, por mos harro se Allahu xh.sh. të ka nderuar me shumë tituj të mirë, si: nënë, motër, edukatore, mësuese, përkrahëse, këshilluese etj. Prej teje varet ardhmëria e brezave të ri, prandaj mos harro misionin më të rëndë dhe më të rëndësishëm në jetë, edukimin e fëmijëve.

MARTESA ME JOMUSLIMANE

Familja është boshti kryesor i shoqërisë. Një njeri që ka arritur moshën e duhur dhe nuk formon familje, konsiderohet se ende nuk e ka plotësuar fenë e tij. Martesa është obligim fetar, për këtë Muhamedi a.s. ka thënë:

“Martesa është pjesë e sunetit tim, kush nuk e praktikon sunetin tim, ai nuk është prej meje! Martohuni, sepse unë do të krenohem me numrin e madh të umetit tim mbi të tjerët!”⁶⁴

Fetarisht këshillohet që martesa të jetë brenda llojit, brenda të njëjtit identitet, dhe me identitet nënkuptojmë kombin dhe fenë, prandaj i këshillojmë të gjithë të pamartuarit që të martohen brenda identitetit të tyre. Megjithatë, është edhe një fakt i pamohueshëm, se në mesin e një grupe të vogël të emigrantëve ekzistojnë martesa me anëtarë të komuniteteve tjera, qofshin nga kombi apo feja, bile kanë edhe fëmijë me ta. Sipas islamit, lejohet që një musliman burrë të martohet me një grua krishtere apo hebreje, me kusht që fëmijët të edukohen vetëm në frymën islame sepse Zoti thotë në Kur’anin Famëlartë:

“O ju besimtarë, ruajeni veten tuaj dhe familjen tuaj prej zjarrit të Xhehenemit”⁶⁵.

Mirëpo, nuk lejohet që muslimani ta konvertojë gruan e tij me dhunë. Aq shumë të drejta i ka dhënë Islami kësaj gruaje, sa që e ka obliguar burrin musliman që në shtëpinë e tij, e madhe qoftë apo e vogël, nëse ajo shprehën dëshirë, t’i mundësojë një hapësirë për t’i kryer ceremonitë apo adhurimet e saja fetare.

Gjithsesi, marrë parasysh faktin se ky diverzitet fetar brenda të njëjtës familje do ishte një pasqyrë jo e mirë për fëmijët, megjithatë

⁶⁴ Transmeton Ajsheja r.a.

⁶⁵ Kur’an, Sure Tahrim: 6

është dëshira e secilit prej tyre që të bindë partnerin që ai apo ajo të konvertohet në fenë e tjetrit. Nëse kjo dëshirë shprehet publikisht prej anës së gruas, atëherë burri duhet t'ia tërheq vërejtjen se ajo shkel cakun apo kufirin që është shkatërrimtar për familjen e tyre. Nëse burri tenton ta konvertojë gruan, kjo vjen në shprehje vetëm me pëlqim të gruas dhe jo me imponim apo me dhunë. Gëzimi më i madh për burrin i cili ka marrë një grua krishtere apo hebreje është që ajo me dëshirë të përqafojë fenë Islame.

Para jush do të paraqes tri raste, ku për shkak të dashurisë që ndajnë partnerët për njeri-tjetrin, arrijnë deri aty që të braktisin fenë e tyre dhe të konvertohen në fenë e burrave. Por, a është e mjaftueshme që partneri, i shtyrë vetëm prej dashurisë të konvertohet në një fe tjetër? Sa do të kishte zgjatur ky konvertim? A prishet feja e partnerit nëse ai ose ajo ndahen dhe nuk e dashuron më partnerin? Këta janë dilema që do qartësohen prej këtyre shembujve.

Rasti i parë ka ndodhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një djalë musliman, dashurohet me një amerikane të krishtere dhe kalojnë bashkë disa vite, por pas një kohe, djali duke qenë shok me disa praktikues të fesë, bindet në fe dhe fillon që edhe vetë ta praktikojë atë, gjë e cila e bën të mendojë seriozisht për lidhjen me vajzën e krishterë. Nuk dëshironte të ndahet, sepse e dashuronte shumë atë, kështu që, në fund vendosi t'ia qajë hallin asaj. Për çudi, vajza i tha:

“Gjatë kohës që kam qëndruar me ty, fillova të studioj për fenë Islame, dhe jam në gjendje të bëhem muslimane vetëm që të jemi të bashkuar”.

Vajza e pranoi Islamin, vendoi mbulesën islame (hixhabin), por të gjitha këto veprime të saj nuk e bindën djalin shumë, prandaj e shtyri atë në një sprovë që ta konfirmojë se për çfarë ajo e kishte pranuar Islamin, për hatrin e tij apo thjesht ashtu ishte bindja e saj? Ai vendosi të ndahet kastile prej saj, kështu që, një kohë të gjatë e

vëzhgoi prej në distancë, se mos vallë vajza do ta braktisë Islamin dhe ta heq hixhabin (mbulesën Islame). Thënë thjesht, a do të vazhdojë jetën si muslimane apo jo? Ky vëzhgim zgjati me muaj të tërë, por kur e pa se vajza për asnjë moment nuk u luhat në rrugën që kishte zgjedhur, u bind se ajo është vajza e duhur për të, prandaj, ashtu siç është tradita, shkoi dhe e kërkoi dorën e saj. Sot ata jetojnë të lumtur dhe në harmoni të plotë familjare.

Rasti i dytë është pak më i pazakontë, sepse në krahasim me shembullin e lartpërmendur, këtu janë ndërruar rolet e partnerëve. Një i krishterë, dashurohet në një muslimane me shikim të parë. Ajo sapo ishte shpërngulur në lagjen e tij. Filloi ta vëzhgojë atë çdo ditë, sa herë që ajo dilte për në punë. Një ditë, e ndalën në rrugë dhe ia shprehën dashurinë e tij. Ajo, pasi kupton se ai është fqinji i saj i krishterë, i tregon se feja islame nuk ia lejon një femre muslimane të martohet me të krishterë, kuptohet, derisa ai nuk bëhet musliman. Kështu që ai, pa një pa dy, pranon të konvertohet në Islam vetëm për hatër të dashurisë që ndjente për të, por femra e kushtëzoi, që ky djalë pasi të pranojë Islamin, dyzet ditë radhazi ta falë namazin në xhami, e nëse një ditë apo një kohë nuk shkon do të informohet prej imamit të xhamisë i cili ishte kushëriri i saj. Gjatë gjithë kohës ata nuk guxonin të takoheshin bashkë. Djali pranoi ofertën e saj, deklaroi shehadetin dhe prej asaj dite, për dyzet ditë radhazi nuk mungoi asnjë ditë në faljen e namazit me xhemat. Pas dyzet ditëve, i gëzuar shkon përsëri të bisedojë me vajzën për përmbushjen e kushtit që ia lejonte atij të martohet me atë vajzë. Për çudi, vajza i dha edhe një kusht të fundit për ta kuptuar sinjeritetin e besimit të tij. Ajo i tha: nëse do të martohesh me mua, duhet përsëri të kthehesh në fenë tënde të parë? Vajza këtë sprovë e ka bazuar në këtë hadith të Muhamedit a.s., ku thuhet:

“Ai që fal në xhaminë time dyzet namaze, duke mos i kaluar asnjë namaz, i shënohet atij një pastrim prej zjarrit, shpëtim nga dënimi dhe pastrohet nga dyfytësia”⁶⁶.

Djali i bindur dhe me plotë vetëbesim ia ktheu:

“Më vjen keq! Ty mund të të harroj, por Islamin nuk do ta braktis kurrë!”

Kjo përgjigje ishte e mjaftueshme që ata të martohen dhe të kenë jetë të lumtur.

Rasti i tretë ka të bëjë me një familje ku burri është musliman, ndërsa gruaja krishtere. Burri, pas një kohe të gjatë martese, bëhet praktikues i fesë dhe fillon të insistojë te gruaja që edhe ajo të pranojë Islamin. Qysh atë ditë, mes tyre nisi zënka, filluan të bëjnë debate, polemika, saqë ky filloi të shfaq arrogancë ndaj saj. Filloi ta ngritë zërin, të bërtasë dhe të ulërijë, por ajo assesi të pranonte Islamin. Ajo mbrohej me pretekstin se Islami është fe e mirë, por edhe ajo kishte një fe të mirë, sidomos kur kujtonte se krishterimi ishte feja edhe të prindërve të saj. Ky burrë, një ditë u konsultua me një dijetar dhe ia shpjegoi atij ngjarjen, kurse dijetari e këshilloi që prej asaj dite të mos ia shpjegojë asaj fenë Islame, por t’ia demonstrojë atë praktikisht. Për ta bëtë këtë më mirë, e këshilloi ta lexojë biografinë e Muhamedit a.s., se si ai sillej me gratë e veta. Qysh atë ditë filloi krejtësisht ta ndryshojë sjelljen në shtëpi, tregohej i kujdesshëm për familjen dhe mirëmbajtjen e saj, e lavdëronte gruan, filloi t’i blejë asaj dhurata të ndryshme për ta gëzuar, filloi të kujdeset për fëmijët, të mos qëndrojë gjatë jashtë shtëpisë pa nevojë etj., thënë thjesht, gjithçka që vepronte, e bazonte në biografinë e Muhamedit a.s. dhe në raportin që ai kishte ndërtuar me gratë e veta. Gjatë kësaj kohe, asnjëherë nuk i foli për Islamin apo t’ia shante fenë e saj. Kjo histori zgjati për tre vite të tëra, por një ditë, duke e falur namazin e akshamit, e vëren se gruaja e tij kishte veshur hixhab dhe

⁶⁶ Transmeton imam Ahmedi nga Enes b. Malik r.a.

afrohet për ta falur edhe ajo namazin e akshamit bashkë me të. Ky veprim e gëzoi atë pa masë, saqë prej gëzimit nuk dinte se çka bën, me ç' rast e pyeti:

“Çka të shtyri ta pranosh Islamin pas kaq shumë viteesh?”

Ajo ia ktheu:

“Gjatë këtyre tri viteve që kam qëndruar tek ti, kam parë shembullin e një edukate të përsosur, kam parë një bashkëshort shembullor, një prind familjar, një edukator plot urtësi dhe një kujdestar të palodhshëm për familjen. Nëse të gjitha këto t'i ka mësuar Islami, atëherë edhe unë dua të jem pjesëtare e kësaj feje madhështore”.

Të nderuar besimtar, mbase nuk i kemi të gjitha mundësitë që ta përhapim apo ta shpjegojmë Islamin me fjalë, sepse kjo u takon studiuesve të fesë dhe teologëve, kjo nuk na privon që atë ta prezantojmë me sjelljen tonë. Po ashtu, të mos harrojmë se të tjerët Islamin e shohin në sjelljen tonë.

Në vijim do të paraqes një intervistë të zhvilluar me një motër të konvertuar në Islam, e cila ceremoninë e deklarimit publik të shehadetit e ka bërë pikërisht në xhaminë “Ebu Hanife” në Troisdorf të Gjermanisë në prezencën e gjithë xhematit.

1. Motër e nderuar, cili ishte shkaku kryesor që të bindi ta pranosh Islamin?

Gënjej nëse them se shkaku kryesor i pranimi të Islamit ka qenë dija dhe njohuria ime për fenë Islame, edhe pse fjala e parë në Kur'an është “Lexo!”. Unë nuk dua shumë të bisedoj për të kaluarën time, sepse nuk dua që atë pjesë të jetës sime ta ndaj me askënd, përveçse me familjen time të ngushtë. Ajo që mund të them është se unë jam gjermane me kombësi, prandaj duke marrë parasysh faktin se pjesa dërmuese e gjermanëve janë të krishterë, edhe e kaluara ime ishte e tillë. Fati deshi që unë të martohem me një shqiptar musliman i cili viteve të fundit është kthyer në një praktikues të zellshëm i parimeve

fetare, prandaj, dita-ditës fillova të vërej ndryshime pozitive në karakterin e tij, dhe si rrjedhojë këtë mund ta konsideroj motivin tim kryesor që sot unë jam një muslimane. Pra, më pëlqeu ndikimi që pati Islami në karakterin e burrit tim, prandaj dëshiroja që ky ndryshim të më kaplojë edhe mua.

2. Çfarë ndjenje ishte kur për herë të parë shqiptove shehadetin?

Ndjenjë e jashtëzakonshme, të cilën nuk mund ta përshkruaj me fjalë, por mund ta kuptojnë vetëm ata që e përjetojnë konvertimin. Sot bota ka miliarda muslimanë, pjesa dërmuese e tyre kanë lindur prej prindërve muslimanë, por fatkeqësisht nuk ia dinë vlerën fesë së tyre, kurse ajo pakicë që konvertohet, kalojnë në disa momente delikate dhe peripeci të pa harruara të cilat i kalova edhe unë. Në realitet, gjatë kohës që kam jetuar me burrin, ende pa u bërë muslimane, e kam quajtur veten një gjysmë-muslimane, sepse jeta ime e përditshme ka qenë komfort traditës muslimane. Ajo që më ka munguar ishte vetëm dëshmia dhe zbatimi i parimeve islame.

3. A e ke pranuar Islamin si rezultat i bindjes tënde personale apo sepse jetoje në një familje muslimane?

Unë mendoj se Islami është një fe e mirë, e pastër dhe me plotë vlera. Kushdo që bëhet pjesë e tij, nuk e nderon fenë, por e nderon veten e tij. Megjithatë, lirisht mund të them se shkak kryesor i kësaj dashurie që unë kam për fenë islame është burri im musliman.

4. Sa dallon jeta jote para Islamit dhe tani që je bërë muslimane?

Jeta ime ka bërë një kthesë të çuditshme, por fatmirësisht është bërë më e qetë dhe unë tani fle e sigurt. Sidoqoftë, më duhet të jem e singertë, kohë pas kohe nëpër kokë më vijnë mendime, pyetje dhe dilema të llojllojshme, por atyre u shmangem menjëherë, bile jam e sigurt se ato janë vesvese djallëzore që përpiqen të më prishin rahatinë dhe komoditetin personal.

5. Si reagoi familja jote (burri dhe fëmijët) kur kuptoi se je bërë muslimane?

Atë ditë kur e lajmërova burrin dhe fëmijët, u gëzuan pa masë, saqë vërejta gëzimin në sytë e tyre. Është dashur qysh moti ta ndaj këtë gëzim me ta, por tash deshi Zoti dhe tash u bë.

6. Si reagoi familja jote biologjike (prindërit, motrat dhe vëllezërit) kur kuptoi se je bërë muslimane?

Pak më përpara përmenda historinë time dhe thashë se nuk dua të hyj në detaje, por meqë ju insistoni kaq shumë dhe më ktheni përsëri aty, vetëm mund t'ju them, se prej ditës që jam martuar e deri sot, i kam humbur të gjitha kontaktet me familjen time biologjike. Nëse më lejohet të paragjykoj, mendoj se ata nuk do të ishin të kënaqur me këtë vendim që kam marrë.

7. A mendon se tani që je bërë muslimane mund të bësh më shumë për veten (me pak fjalë, sa je praktikuese e parimeve Islame: hixhab, namaz, agjërim, haxh etj.)?

Ju kujtohet kur thashë që kohë pas kohe kam dilema dhe pyetje, kjo shpresoj të jetë normale për një njeri të konvertuar, sepse besoj se edhe muslimanët e lindur mund të kenë dilema të ndryshme. Unë për vete kam mungesë të madhe për një shoqe muslimane të pajisur me dituri të bollshme për Islamin, e cila do të më ndihmonte për t'i zgjidhur këto dilema dhe të më japë më shumë vetëbesim, në mënyrë që të përforcohet besimi edhe më shumë në zemrën time, sepse gjithçka që unë di tani është vetëm ajo që më mëson burri im apo ajo që kam lexuar nga literatura e ndryshme e huazuar.

8. Çka i kishe këshilluar motrat muslimane në lidhje me Islamin?

Unë jam fillestare dhe nuk e njoh mirë Islamin, prandaj nuk besoj se jam në gjendje t'i këshilloj motrat muslimane, por ajo që më vjen ndërmend për momentin është që ato të kenë kujdes më të theksuar

për dukjen e tyre në publik, sepse kjo mund t'i afrojë apo t'i largojë njerëzit nga Islami. Unë besoj se motrat muslimane duhet të kuptojnë se në çfarë vendi dhe kohe jetojnë, prandaj them se duke mos shkelur konditat fetare të hixhabit, të vishen siç u ka hije, si zonja, dhe të mos importojnë veshje dhe tradita të kombësive që nuk kanë lidhje me konditat themelore të veshjes sipas Islamit.

9. Pyetja ime e fundi është kjo: çfarë domethënë të jesh bashkëshorte e një shqiptari? Sa dallon kjo jetë prej asaj që ke jetuar te prindërit e tu?

Është një jetë komplekse sepse aty puqen dy kultura dhe dy mentalitete të ndryshme. Nuk mund të konsiderohet se është jetë e lehtë për t'u jetuar, sidomos në fillimet e saj, por me kalimin e kohës ajo fillon të lehtësohet dhe çifti i kapërcen të gjitha vështirësitë, nëse gjykon me maturi, tolerancë dhe kompromis. Për veten time, them lirisht dhe fuqishëm, jam shumë e lumtur me këtë jetë që kam zgjedhur, nuk do ta kisha ndërruar me asgjë në këtë botë, mburrem që jetoj me një burrë shqiptar dhe tash ndjehemi edhe më afër se kurrë me njëri-tjetrin dhe me fëmijët. Përveç harmonisë familjare, kemi edhe një ideal të përbashkët, ai është Islami.

Me nderime dhe me shumë respekt, në cilësinë e një motre muslimane, ju përshëndes me fjalët më të bukur në këtë botë: "Es-Selamu alejkum - paqja të mbisundojë në zemrat tuaja, ashtu siç kaploi edhe timen!

NE JEMI PASQYRË PËR FËMIJËT TANË

C ështëja më serioze në jetën familjare është edukimi i fëmijëve. Duhet të veçojmë se besimtari, njeriut të parë që duhet t'ia shpjegon Islamin është fëmija i tij. Fëmija i mirë është sukcesi i tij, kurse dështimi i fëmijës llogaritet dështimi i tij. Ju mund të jeni njeriu më i suksesshëm në botë dhe të keni një karrierë të bujshme, por në të njëjtën kohë, nëse fëmija juaj është në rrugë të gabuar, kjo do të ndikojë që ju t'i humbni të gjitha shpresat e jetës. Prandaj, fëmijët janë kënaqësi prindërore, por disa herë ata mund të kthehen edhe në ankth i tyre. Dashuria për fëmijët është e jashtëzakonshme, ajo s'mund të zëvendësohet me asgjë në këtë botë, nëse p.sh. në rrugë shihni tre adoleshentë që pinë duhan dhe kuptoni se njëri prej tyre është djali juaj, i dyti është nipi juaj dhe i treti një djalë që ju nuk e njihni, fillimisht mërzhiteni për djalin tuaj, pastaj pak më pak për nipin tuaj, kurse në fund, për djalin e tretë ndjeni vetëm keqardhje.

Edukimi i fëmijëve është një proces i vështirë që meriton shumë sakrificë dhe angazhim prindëror dhe familjar. Një gjë është e sigurt: sa sakrificë dhe angazhim të jep prindi, aq do të reflektojnë rezultatet te fëmijët e tyre. Disa, për mossuksesin e tyre i akuzojnë fëmijët, por sot, psikologët kanë ardhur në përfundim se: nuk ka fëmijë të këqij në natyrë, por edukimi jo i mirë është ajo që i bën fëmijët e këqij. Shumë prej prindërve mendojnë se detyrimi i tyre është vetëm mirëmbajtja e fëmijëve, që nënkupton: sigurimin e shtëpisë, ushqimit, veshjes, shkollës etj., por në fakt, ata kanë një obligim më madhor se ky, edukimin e drejtë të tyre në parimet e vërteta islame. Sot, mungesa e edukimit të fëmijëve është një problem global. Pavarësisht se duhet të ketë parime globale për edukimin e fëmijëve, në kultura të ndryshme, ka forma të ndryshme të edukimit të tyre, p.sh.: në Perëndim, edukimi dhe mirëmbajtja e fëmijëve zgjatën deri

në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, kurse pas kësaj kohe, fëmija bëhet i pavarur dhe i mëvetësishëm, ata ndahen prej prindërve, dhe në të ardhmen nuk i lidh asgjë me prindërit e tyre, përveç respektit të ndërsjellë që mund të zgjatë deri në fund të jetës, por mund edhe të thyhet me kalimin e kohës, kështu që prindërit në fund të jetës së tyre detyrohen të zhvendosen në shtëpitë e pleqve dhe aty të presin vdekjen në dëshpërim. Një studim që është bërë në azilet e pleqve në Francë, rezultoi që 90 % e pleqve që jetonin aty mendonin se jeta e tyre s'ka kuptim, e gjithë kjo, nga malli që ndjenin për fëmijët e tyre. Kurse në shumë vendet tjera, ashtu si edhe në vendin tonë, fatmirësisht, lidhshmëria mes fëmijëve dhe prindërve akoma zgjatën deri në fund të jetës. Prindi kujdeset për fëmijën me dashuri derisa ka forcë, ndërsa kur arrin pleqërinë, fëmijët kujdesen për të me respekt dhe dashuri deri në frymën e tij të fundit.

Hapi i parë i edukimit të fëmijëve është zgjedhja e gruas së mirë dhe të moralshme, e cila nesër të jetë nënë dhe edukatore e mirë për fëmijët e tu. Motivet kryesore për të marrë një vajzë për grua janë të shumta, por duhet të pranojmë se fillimisht, burri te femra sheh bukurinë e saj, më tej, pasurinë e saj, më tej, familjen dhe origjinën e saj, dhe fatkeqësisht parim të fundit ka moralin e saj. Sikur renditja të niste mbrapsht, kjo do të ishte më e mirë për të, sidomos nëse kujdeset për edukimin e fëmijëve të ardhshëm.

Kur lind fëmija, ai llogaritet si fleta e pastër apo *fitre*⁶⁷. Në këtë natyrë të tij të pastër ne mund të “vizatojmë” aty çka të duam, mund të vizatojmë diçka të bukur dhe të këndshme ose mund të “shkarrravisim” diçka të shëmtuar. Në bazë të kësaj, psikologët vërtetojnë se shkak i sjelljes të dhunshme të psikopatëve dhe sociopatëve janë pasojat e fëmijërisë të çrregullt të tyre, pasi ata shpesh kanë qenë

⁶⁷ Njejtë si “tabula rasa” nga latinishtja që domethënë: dërrasë boshe apo dërrasë e pastër; është teori që tregon se individ është i lindur pa gatishmëri mendore dhe pa karakter, dhe se njohuritë e tij vijnë duke iu ndërtuar nga përvoja dhe perceptimi jetësor.

dëshmitarë apo viktime të dhunës në familje derisa kanë qenë fëmijë. Kjo teori nuk dallon shumë nga ajo që thotë vetë Muhamedi a.s.:

“Çdo fëmijë është i lindur fitre (i pastër në natyrë)”⁶⁸.

Prej nesh varet se si do të jenë fëmijët tanë. Nëse kemi moral të mirë dhe të njëjtën ua japim atyre, do të jenë të mirë dhe të moralshëm, në anën tjetër, nëse jemi të pamoralshëm dhe u japim këshilla të këqija, do të bëhen të këqij. Nëse tentojmë t’u japim këshilla të mira, por vetë jemi të pamoralshëm, ata do ta shohin punën e jo fjalët tona. Ashtu siç jemi, të tillë do t’i kemi edhe fëmijët, pra, me fjalë të tjera, ne jemi pasqyrë për fëmijët tanë.

Fëmija në moshën parashkollore nuk është i predispozuar që të bëjë shkelje të rëndë, krime, vjedhje etj., sepse kjo nuk përshtatet me moshën dhe me natyrën e tij të pastër, por neglizhenca gjatë edukimit në këtë moshë mund të nisë me gënjeshtër të vogël në fëmijëri dhe mund të përfundojë me diçka më të rrezikshme, si vjedhja, imoraliteti, alkooli, droga etj. në moshën e pubertetit. Rrezikun e gënjeshtres e paralajmëron edhe vetë Profeti a.s., duke thënë se ajo nuk është cilësi e natyrshme njerëzore, ai thotë:

“Besimtari ju është predispozuar natyrshëm të gjitha tipareve përveç tradhtisë dhe rrenës”⁶⁹.

Nëse duam që fëmija ynë të mos gënjejë, duhet fillimisht ne vetë të mos e përdorim gënjeshtren. Përmendet si humor në mesin tonë historia e borxhmarrësit që troket në derën e borxhdhënësit. Ky i fundit, kur e pa nga dritarja se kush është te dera, i thotë djalit: “Thuaji se babi nuk është në shtëpi!” Djali duke mos ditur të gënjejë, del jashtë dhe i thotë vizitorit të pa dëshiruar: “Më tha babai se nuk është në shtëpi!”. Ky rast, shpeshherë përsëritet në jetën tonë të përditshme. Tregoni të vërtetën, a ka ndodhur që duke ju cingëruar telefoni, kur ju s’keni dashur të flisni, t’u thoni anëtarëve të familjes,

⁶⁸ Transmeton Ahmedi nga Xhabir Ibn Abdulla r.a.

⁶⁹ Transmeton Imami prej Ebu Umame el Behlili r.a.

në prezencë të fëmijëve: “Thuaji se nuk jam në shtëpi!” Në këtë rast, fëmija ambientohet natyrshëm me idenë se “nëse babai apo nëna ime gënjen, atëherë nuk qenka ndonjë problem i madh që edhe unë të gënjej”, dhe me këtë, nesër rrezikohet që të kthehet në rrenacak. Kur isha i vogël, shpeshherë në xhaminë e lagjes dëgjoja historinë e fëmijërisë së Abdulkadër el Xhejlanit, një nga dijetarët islamë, i cili kur ishte i ri, nëna i kishte dhënë dyzet dinarë floriri për t’i shpenzuar në shkollimin e tij, por njëkohësisht i kishte lënë amanet që asnjëherë në jetë të mos gënjejë. Rrugës për në shkollë, karvanin e tij e ndalën disa grupe kaçakësh⁷⁰ të cilët nisën t’i plaçkitin të gjithë udhëtarët me radhë, por kur i vjen radha Xhejlanit, një nga ata e pyeti:

“Sa të holla ke me vete?”

Ai i përgjigjet drejtë, dhe i thotë:

“gjithsej dyzet dinarë floriri!”

Grabitësi i parë, duke parë moshën e tij të vogël, nuk e besoi se mund të ketë aq para dhe e anashkaloi, kur erdhi grabitësi i dytë, Xhejlani ia jep po të njëjtën përgjigje, por kur ai e vërtetoi sinqeritetin e djalit, e çoi te udhëheqësi i tyre; e ai, i habitur e pyeti:

“Pse tregove të vërtetën?”

Xhejlani, iu përgjigj:

“Sepse i kam premtuar nënës se çdoherë do të them të vërtetën dhe asnjëherë nuk do të gënjej”!

Në atë moment, grabitqarët u penduan sinqerisht për punët e këqija që i bënin dhe thanë:

“Kur ky djalë i ri i ka premtuar nënës dhe e mbajti premtimin, e ne që shkelim premtimin e Zotit, vaj halli për ne!”

Muhamedi a.s. për vlerën e sinqeritetit thotë:

⁷⁰ Huliganë që grabisin nëpër rrugë

“Është detyrë e juaja të jeni gjithmonë të sinqertë, pasi sinqeriteti udhëzon në devotshmëri absolute dhe devotshmëria çon në Xhenet”⁷¹.

Në kohën e shokëve të Profetit a.s. kishte transmetues hadithesh që udhëtonin me mijëra kilometra, për shembull, prej qytetit të Medinës deri në Basra, bile edhe më shumë, vetëm për të dëgjuar një hadith të vetëm. Nëse sahabët e shikonin se dikush i ndjellë kafshët dhe nuk ka asgjë në dorë, largoheshin dhe konstatonin se ai ishte një person jo i kualifikuar për të transmetuar hadithet e Muhamedit a.s., e gjitha për shkak të një gënjeshtre të vogël.

Prandaj, mundohuni që asnjëherë të mos e praktikoni gënjeshtren. Nëse p.sh. i tregoni ndonjë shoku apo miku se nesër shkoni në ndonjë qytet tjetër, dhe ai të thotë: “A ka mundësi të më blesh diçka prej atje, se këtu nuk ka?”, kurse ti harron t’ia blesh, por nga turpi i arsyetohesh me gënjeshtër, gjoja se shkove ta blesh por shitorja nuk ishte e hapur, Normal, ai do të besojë dhe nuk do të përpiqet të bëjë investigime për ta mësuar të vërtetën, por ti vetë ndjehesh i nënvlerësuar sepse e di se e ke gënjyer dhe se Zoti të sheh shumë mirë. Nëse në këtë gënjeshtër, me ty ka qenë edhe fëmija yt, padyshim se edhe ai kur do të rritet, do veprojë njësoj. Muhamedi a.s. për rastet e këtilla ka thënë:

“Tradhtia më e madhe është ta bindësh vëllain tënd për diçka që ti e di se është gënjeshtër.”⁷²

Edukimi i fëmijëve duhet të nisë në një fazë shumë të hershme të fëmijërisë. Është pikërisht mosha kur ai fizikisht dhe shpirtërisht është i lidhur me prindërit dhe nuk është i predispozuar ndaj botës së egër jashtë oborrit të shtëpisë së tij. Psikologët bashkëkohor kanë arritur në përfundim se karakteri i njeriut formësohet dhe brumset deri në moshën shtatë vjeçare, prandaj, shtatë vitet e para janë vendimtare për edukimin e fëmijëve. Derisa ende nuk ishte zbuluar

⁷¹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

⁷² Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij

kjo e vërtetë shkencore, shumë orientalistë mundoheshin ta njollosin figurën e Muhamedit a.s., duke e akuzuar atë si të dhunshëm ndaj fëmijëve, vetëm sepse na këshilloi kështu:

“Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz kur të arrijnë moshën shtatë vjeçare”⁷³.

Në këtë fazë vendimtare për fëmijët, kur akoma nuk janë të ngarkuar me vështirësitë e kësaj jete, mundohuni të jeni shembull i mirë për ta, qëndroni afër tyre, bisedoni me ta, përgjigjuni dilemave të tyre, rrëfejuani atyre jetën e Muhamedit a.s.: si ai luante me nipërit, Hasanin dhe Husejnin r.a., si ai a.s. e ndaloi ligjëratën javore sapo vërejti se në xhami hynë nipërit e tij, të cilët i puthi dhe përsëri u kthye në hutbe; Kështu mund t’ua bëni të dashur fëmijëve leximin e Kur’anit. Merrni ata në xhami dhe provoni a kanë mbajtur mend diçka nga ligjëratat!

Po tregoj një rast nga përvoja ime si arsimtar i mësim-besimit në vendlindje. Kur për herë të parë drejtori më prezantoi me nxënësit e klasës së katërt fillore, shumë prej kolegëve (arsimtarë) më thanë që të mos mundohem shumë me këta nxënës sepse nuk ia vlen, mes tyre ka shumë nxënës të dobët dhe të pa edukatë. Kur nisa me mësimet, pashë një interesim të çuditshëm, veçanërisht për ndodhitë dhe tregimet islame që ata kishin dëgjuar prej gjyshërve të tyre. Kështu që, dalëngadalë filluan të kyçen në mësim, saqë ju betohem se pas tre muajve, kur erdhi drejtori në një kontrollim rutinë, u habit kur vërejti se gjatë pyetjeve të mia, të gjithë i çonin duart për t’u përgjigjur, dhe njëkohësisht ata treguar maturi dhe sjellje shembullore.

Ka një dallim rrënjësor mes brezave sa i takon afërsisë dhe qasjes së tyre në edukimin e fëmijëve, si për shembull, brezi i prindërve tanë kanë jetuar në një kohë ku ka sunduar “sedri apo burrëria kanunore”, saqë ka qenë turp për prindërit, sidomos për babanë, që të luajë me fëmijët e tij, kurse sot gjërat kanë ndryshuar pozitivisht, pasi sot çdo

⁷³ Transmeton Amër Ibn Shuajb r.a.

ditë mund të shohim nëpër parqe se si baballarët ledhatojnë dhe lozin me fëmijën, dhe kjo më nuk konsiderohet turp. Pra, brezi i baballarëve tanë e kanë kuptuar gabimin e tyre, prandaj si “dëmshpërblim”, dashurinë që s’kanë pasur mundësi t’ua shprehin fëmijëve të tyre, ua shprehin nipërve dhe mbesave. Natyrisht, një veprim i tillë ka qenë i ekzagjeruar dhe i tepruar, sepse shprehja e dashurisë ndaj fëmijëve ka qenë evidente prej në shek. XII, qysh në kohën kur profeti Muhamedi a.s. u thoshte të pranishmëve:

“Kush prej jush ka fëmijë, le të luajë me ta dhe le të aktrojë si fëmijë!”⁷⁴

Fëmijët janë imitues të fortë të prindërve, ata shohin çdo lëvizje të tyre dhe të çdo anëtarit tjetër të familjes, pastaj i imitojnë ata. Shpesh më ka rastisur në lagje, të shoh fëmijë që lozin dhe bëjnë sikur pinë alkool apo janë të dehur. Nënkuptohej se kjo sjellje është imitim i prindërve të tyre në shtëpi, prandaj, ju këshilloj të falni namazin, që fëmijët t’u imitojnë në faljen e namazit, grave ju këshilloj të veshin mbulesat islame, që edhe vajzat e tyre t’i imitojnë me mbulesë, ashtu që nesër të mos i vijë rëndë të dalë e mbuluar para shoqeve. Kur t’ju trokasim në derë të varfrit, ndihmoni ata dhe mos i dëboni duke i sharë apo ofenduar, pasi nesër do t’ju imitojnë edhe fëmijët tuaj!

Të gjithë mendojnë se familja ideale është ajo familje që e shohim në reklama televizive, ku çifti bashkë me fëmijët të tyre qëndrojnë në parqe të bukura dhe lozin hareshëm. Unë pajtohem me këtë, por besoj se më idealja që më kanë parë sytë ishte koha kur shkova në Meke për ta kryer haxhillëkun, dhe aty shikoja çifte nga e gjithë bota që kryenin *tavafin* dhe pranë vetes i kishin fëmijët, të cilët i imitonin prindërit e tyre në ibadete.

⁷⁴ Transmeton Ebu Muaviju r.a.

Mosha e pubertetit

Rëndësi shumë të madhe në jetën familjare ka edhe edukimi në moshën e pubertetit. Kjo moshë është shumë delikate për edukim. I riu apo e reja gradualisht mendon se ka filluar të bëhet e pavarur, saqë fillon të paraqitet një hendek mes tyre dhe prindërve. Fajtorë gjithsesi janë të dy palët, fillimisht fajësohet prindi sepse akoma e konsideron fëmijën të vogël dhe nuk i ka ndryshuar metodat e edukimit, por gjithashtu fajtorë janë edhe “hormonet e pubertetit” të fëmijës që ai/ajo mendon se është rritur dhe nuk ka nevojë për kujdesin e prindërve dhe si rezultat i gjithë kësaj, acarohen raportet mes tyre, dhe prindërit bëhen të ashpër dhe brutalë ndaj tyre, me ç’rast shkelin një nga urdhëresat profetike, ku Muhamedi a.s. thotë:

“Mësoni ata, por mos i trajtoni ashpër, pasi mësuesi është më i mirë se mizori!”⁷⁵

Sot, në shumë debate publike shqyrtohet çështja se a duhet të llogaritet fëmija si shok apo jo? Personalisht mendoj se prindi me fëmijën nuk duhet të jetë “shok” me plotë kuptimin e fjalës, por ama duhet të sillet si i tillë me ta! Atyre duhet t’u bëhet e qartë pozicioni i të qenët “prind”, duhet të gëzojë një respekt maksimal, por në këtë fazë, ajo që duhet të ndryshojë është edhe metoda e diskutimit, ajo duhet të jetë më elastike, më moderne dhe më atraktive. Në këtë fazë kritike të edukimit, fëmija duhet të testohet sa është i sigurt në atë çka thotë. Prindi duhet ta pyesë atë ku ka qenë, me kë ka qenë dhe duhet të verifikojë a ka thënë të vërtetën. Procedura e kontrollimit të tyre nuk është e lehtë, por është e nevojshme. Ju duhet të shkruani në një fletore premtimet që ua keni dhënë fëmijëve dhe premtimet apo betimet që fëmijët ua kanë dhënë juve. Në rastin kur fëmijët t’i shkelin ato premtime, ju duhet menjëherë t’ua tërhiqni vërejtjen. Psikologët thonë se në këtë moshë 40% në sjelljen e fëmijës

⁷⁵ Transmeton Harithi nga Ebu Hurejre r.a.

adoleshent ndikon familja, kurse 60% shokët e tij, prandaj prindi duhet të di se kush janë shokët e fëmijëve të tij, nëse shokët janë në rrugë të drejtë, në rregull, kurse nëse shokët janë në rrugë të gabuar, duhet t'i largojnë prej tyre. Si shembull: nëse fëmija është në një shoqëri që ka kontradikta mes shokëve, ku dikush është pro Islamit dhe dikush kundër, fëmija është i rrezikuar të zgjedhë qëndrimin e shokut i cili është kundër Islamit, prandaj ju duhet ta ruani fëmijën tuaj nga kjo shoqëri dhe njëkohësisht ta edukoni të qëndrojë i balancuar me vetëbesim karshi këtyre kontradiktave dhe tendencave. Në botë ka metoda të çuditshme, por njëkohësisht edhe interesante për përmirësimin e sjelljes të fëmijës; p.sh. në disa vende, fëmijët pajisen me një pajisje elektronike që shënon sjelljen e mirë të tyre me rezultate: nëse i bëjnë detyrat e shtëpisë, kjo pajisje u shënon menjëherë dhjetë pikë, nëse ndihmojnë nënën në punët e shtëpisë, marrin pesë pikë, e kështu me radhë, por kjo pajisje shënon edhe sjelljen e keqe të tyre: nëse gënjen dikë, humb dhjetë pikë, nëse nuk i lan dhëmbët, humb pesë pikë etj., pastaj tubohen pikët për tërë vitin, dhe si rezultat, nëse ka fituar (ta zëmë) tre mijë pikë, ai fiton një biçikletë ose ndonjë dhuratë të preferuar.

Në fazën e pubertetit, gjithashtu nuk duhet të anashkalohet edhe dhënia e dijes islame. Prindi nuk duhet vetëm ta pyesë fëmijën se a e ka falur namazin, por duhet ta pajisë fëmijën me dituri nga feja. Vazhdimisht t'ia shpjegojë atij urtësinë e shijimit të namazit, kurse në rast se ai personalisht nuk ka shumë njohuri, le ta dërgojë te një njeri i ditur. Sot, fatkeqësisht, kur prindi sheh një kapacitet mendor te fëmija i tij, ai menjëherë e dërgon atë në shkolla profesionale si: medicinë, inxhinieri, ekonomik, finance, arkitekturë, politikë etj., dhe asnjëherë nuk i shkon ndërmend që fillimisht ta çojë në studime islame, që atje të brumosë moralin e tij për tu ballafaquar me këtë botë të egër, dhe pastaj ai vetë të merr drejtimin e duhur në studime.

Besoni, gjëja më e mirë në jetën tuaj është të keni një fëmijë të moralshëm që respekton urdhëresat e Zotit dhe largohet nga

ndalesat e Tij. Para disa kohësh, në rrugë pashë një grup të rinjsh që ecnin rrugës, afër tyre kaloi një femër me tesha provokuese. Ajo që më bëri përshtypje ishte reagimi i tyre pozitiv, pasi ata në atë çast ulën shikimin. Përderisa ka njerëz të tillë, ka shpresë për një të ardhme të sigurt të fëmijëve tanë. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit”⁷⁶.

Inkurajoni fëmijët tuaj të bëjnë gjërat që ju i keni ëndërruar, por nuk i keni realizuar asnjëherë! Assesi, mos i detyroni nëse i shihni se ata nuk duan të veprojnë një gjë të tillë, sepse edhe ata kanë ëndrrat e tyre! Asnjëherë mos i nënvlerësoni fëmijët dhe nxënësit tuaj, sepse ndoshta në të ardhmen mund të bëhen shkencëtarë apo presidentë. Disa herë, disa gjëra na duken të pamundshme dhe absurde, por mos harroni se të gjithë ne udhëtojmë brenda planeve të Zotit dhe nuk e dimë se çfarë ka përgatitur Allahu xh.sh. për ne dhe për fëmijët tanë; një foshnjë e hedhur në det (Musai a.s.) ishte zbrazëtirë në zemrën e nënës dhe mërzi e madhe për të, saqë Zoti tha:

“E zemra e nënës së Musait a.s. agoi e zbrazët (kur e hodhi djalë dhe kuptoi se ka rënë në dorë e Faraonit) dhe ishte gati ta zbulojë atë (sekretin e fëmijës) sikur të mos ia forconim Ne zemrën e saj që të bëhet e bindur”⁷⁷,

por që vullneti i Zotit që pikërisht kjo foshnjë të rritet në kujdesin e gruas së Faraonit, e pastaj kur të bëhej burrë, me leje të Zotit, ta shkatërrojë perandorin djallëzore të Faraonit.

⁷⁶ Kur'an, Sure Furkan: 74

⁷⁷ Kur'an, Sure Kasas: 10

KRIZAT E RINISË NË PERËNDIM

Babai i një adoleshenteje e thërret hoxhën për ta pyetur diçka në lidhje me një problem që ka me vajzën e vet. Kur hyn hoxha në shtëpinë e tyre dhe takohet me ata dy, vetëm prej paraqitjes dhe pamjes së jashtme të vajzës, e kupton se është një vajzë e përkëdhelur dhe e çorientuar. Vajza kishte disa dilema që nuk ua dinte përgjigjet, si për shembull:

Pse duhet Zoti të na dënojë në zjarrin e Xhehenemit përderisa ju thoni se Zoti është i Mëshirshëm? Pse Zoti e ndalon homoseksualizmin kur Ai vetë i ka krijuar të tillë? Ja p.sh., unë disa të tillë i kam në klasë dhe mua më duket se janë njerëz normal dhe të mirë. Përse Allahu e ka ndaluar mishin e derrit, kur atë vetë e ka krijuar dhe, mbi të gjitha, është një ushqim që e hanë gati e tërë bota? Pse ndalohet shkuarja nëpër klube dhe disko nate, kur atje të kënaqet shpirti dhe ndjehesh mirë në ato çaste?” Dhe shumë e shumë pyetje të tjera.

Imami heshti për një çast, pastaj iu përgjigj kështu:

“Unë do të përgjigjem ty duke të parashtruar disa pyetje të thjeshta: “A beson ti moj vajzë se Kur’ani është fjalë e Zotit, se meleku Xhibril a.s. ia ka zbritur Muhamedit a.s. dhe se Kur’ani është udhërrëfyes për në rrugën e drejtë dhe shpëtim nga rruga djallëzore? A beson se një ditë, pasi të vdesim të gjithë, do të ringjallemi dhe do të japim llogari para Zotit?”

Ajo u përgjigj:

“Pavarësisht se im at më urdhëron të besoj këtë, unë dyshoj në këto gjëra.”

Sot kriza e umetit islam është se rinia nuk është mjaftueshëm e edukuar në Islam, por sepse ajo ka dilema në besimin e tyre. Prindërit e këtyre fëmijëve duke u frikësuar për këtë gjendje, nuk dinë si të

veprojnë. Ka prej tyre që i izolojnë fëmijët në shtëpi dhe nuk i lejojnë të shkollohen qëllimisht, ashtu që të mos shoqërohen me të huajt, por ka edhe prej atyre që vetëm e dorëzojnë te xhamia, kurse vetë largohen prej saj.

Sa i përket alternativës së parë, ata edhe pse mendojnë se fëmijët i kanë shpëtuar duke i izoluar prej shoqërisë, në realitet ata vetëm e gënjejnë veten, sepse sot fëmijët kanë mënyra të tjera se si të dalin jashtë mureve të shtëpisë, jo fizikisht, por mendërisht dhe shpirtërisht. Kjo realizohet me anë të zhvillimeve teknike dhe teknologjike. Njëherë kisha rastin të vizitoj një të afërm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku gjatë qëndrimit në shtëpinë e tij dëgjoja zhurmë të mëdhe në dhomën private të djalit të tij. Kur e pyeta babanë e tij, se kush është lart, ai më tha se është vetëm djali. Duke qenë se ishte i afërm i imi, shkova ta vizitoj në dhomën e tij dhe vëreja se, edhe pse ai fizikisht ishte vetë, virtualisht ai në dhomë i kishte të gjithë shokët e klasës, dhe kjo është lehtësisht e realizueshme me anë të internetit. Pra, edhe pse prindi mendonte se djali i tij është vetë në dhomë, në realitet ai në dhomë e kishte futur “gjithë botën”. Gabimin më të madh që e bën sot shoqëria jonë është se, qysh në moshë shumë të re, u lejon fëmijëve hapësira personale ose dhoma të mëvetësishme, dhe aty u fusin edhe kompjuterë bashkë me internet. Sot fëmijët mund të mbushen me informacione të rrejshme apo propaganda kundër Islamit, gjë e cila pastaj do t’i shtyjë ta nënvlerësojnë fenë apo të fusin dyshime në të. Këtu nuk duhet të anashkalojmë edhe shkollën, pavarësisht se në përgjithësi kemi mendime pozitive për shkollimin, sepse ajo është mishërim i fjalës së parë të Kur’anit, “Lexo”, megjithatë në Perëndim ka hapësira dhe orë të mjaftueshme ku ata debatojnë për fetë, kulturat dhe civilizimet e ndryshme botërore, flasin për origjinën e njeriut, filozofinë e krijimit dhe shumë tematika të tjera, e gjithë kjo në emër të “laicizmit” dhe “sekularizmit”. Pra, ky i ri apo e re përballet me armikun e brendshëm dhe armikun e jashtëm, fillimisht derisa ishte në shtëpi,

prej mediemeve i lindën dyshimet e para për Islamin, dhe tashmë këto dyshime i vërtetohen edhe përmes teorive antifetare që i mëson në shkollë, dhe kështu, në fund fiton bindjen se ata paskan të drejtë që mendojnë se muslimanët janë fanatikë dhe të prapambetur.

Alternativa e dytë e prindërit është dërgimi i fëmijëve në xhami duke mos marrë pjesë personalisht aty. Edhe kjo nuk është e mjaftueshme, sepse në një xhami në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është bërë një eksperiment interesant, njëqind fëmijë janë pyetur një pyetje të vetme:

“Sa besoni se Allahu i pranon lutjet?”

Pyetjes i përgjigjen pozitivisht të gjithë fëmijët duke i çuar duart lartë, por kur e pyesin secilin veçmas me anë të pajisjes që tregon të vërtetën, prej tyre vetëm tre fëmijë e kishin besuar këtë fakt, kurse të tjerët nuk e kishin besuar.

Cilat janë rrugëdaljet nga këto probleme?

Zgjidhja e parë është zgjedhja e një shoqërie të vërtetë islame e cila duhet mes veti dhe këshillohen mes veti në emër të Allahut xh.sh., që të punojnë së bashku në avancimin e çështjes islame dhe të përmirësimit të shoqërisë ku ata jetojnë. Të edukojnë fëmijët e tyre në Islam dhe kështu të krijojnë një gjeneratë të re me vlera të përkryera fetare. Të shoqërohen, të ndihmohen me njëri-tjetrin dhe të punojnë bashkërisht për të krijuar edhe ata në të ardhmen gjeneratë më të mirë se vetvetja, pastaj të vazhdojë kështu me radhë, gjeneratë pas gjenerate. Në këtë formë, dalëngadalë do të formohet një shoqëri apo komunitet i madh dhe i fuqishëm, me punë dhe me profesione të ndryshme, kuptohet, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, që nesër të mos jenë të varur prej të tjerëve. Raste të tilla nëpër botë ka shumë, por unë dëshiroj të spikas vetëm dy prej tyre: e

para është lagjja e hebrenjve në zona të ndryshme të Amerikës, familjet e të cilëve ishin aq të dendur në këto lagje, saqë nuk kishte mundësi që në mesin e tyre të futet ndonjë pjesëtar i fesë tjetër. Kishin dyqanet, bizneset dhe shkollat e veta, madje nëse kaloje me makinë andej, të dukej vetja se je në Tel Aviv, kurse ata të shikonin me sy të vrenjtur dhe kritik; Rasti i dytë është rasti i turqve në Gjermani, të cilët janë aq shumë në numër, saqë kur futesh në lagjet e tyre, jo që ndjehesh si në Stamboll, por ndoshta, nëse u drejtohesh në gjuhën gjermane, ka prej tyre që nuk të kuptojnë se çka flasësh.

Zgjidhja e dytë është shoqërimi i prindit me fëmijën, edhe pse kjo duket absurde për gjeneratat më të vjetra, të cilët në atë kohë nuk kanë guxuar as t'i afrojnë dhe as t'i puthin fëmijët e tyre në publik. Duke u shoqëruar me ta, prindi do t'i mësojë shumë sekrete të cilat fëmijët nuk kanë guxuar t'ua tregojnë, do ta kuptojnë mentalitetin, bindjet, dyshimet dhe kapacitetin e tyre të fshehtë, gjëra këto të cilat fëmijët nuk i kanë ekspozuar, sepse prindi gjithë kohës ka qëndruar në distancë me të apo sepse ata kanë pasur frikë prej tij. Fëmija si fëmijë, në fillim është i hapur me prindin dhe e pyet lloj-lloj pyetjesh, por kur prindi nuk di t'i përgjigjet, ai thotë:

“Mos më pyetni kesi pyetjesh se është haram”,

kurse në realitet, harami më i madh është të mendosh se pyetja është haram. Kur’ani është sqarues për çdo gjë. Allahu xh.sh. thotë në Kur’anin Famëlartë:

“Ne ta zbritëm ty (o Muhamed) Librin (Kur’anin) që është sqarues për çdo gjë!”⁷⁸

Islami është fe e mendjes dhe e arsyes, nuk ka ndonjë urdhër apo ndalesë që mos të ketë edhe arsyetime apo argumente logjike apo mendore pse duhet vepruar apo ndaluar së vepruari. E nëse prindi nuk di t'i përgjigjet fëmijës së tij, më mirë është t'u thotë atyre se nuk

e di përgjigjen dhe t'i drejtojë te njerëzit e thirrur që t'ua sqarojnë atyre dilemat.

Këshilla e tretë është që prindi ta mësojë fëmijën prej në vegjëli, t'i japë informacione të bollshme për Islamin, t'ua sqarojë dilemat dhe, mbi të gjitha, t'u mbjellë vetëbesim që kur të shkojnë në shkollë, të mos ndjehen të stresuar dhe të frikësuar se mos vallë dikush do t'i pyesë diçka në lidhje me fenë e tyre. Përkundrazi, të jenë këta ata të cilët do të parashtronjë pyetje, të bëhen si Ibrahim i a.s. i cili asnjëherë nuk u pyet prej të tjerëve, por çdoherë pyeste i pari! Zoti tregon në detaje bisedën që pati Ibrahim i a.s. me idhujtarët:

“Kështu Ne i treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës, me qëllim që të ishte prej besimtarëve të vendosur. Kur e mbuloi nata me errësirën e saj, ai pa një yll dhe tha: "Ky është Zoti im." Por kur ylli u zhduk nga shikimi, tha: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë." Kur pa hënën që ngrihej lart, tha: "Kjo është Zoti im." Por kur ajo perëndoi, ai tha: "Nëse nuk më udhëzon Zoti im, unë do të jem prej njerëzve të humbur." Kur pa diellin të ngrihej lart, tha: "Ky është Zoti im. Ky është më i madh." Por kur ai perëndoi, tha: "O populli im! Unë nuk kam asnjë lidhje me ata që ju adhuronin në vend të Allahut." "Unë i drejtohem - larg besimeve të kota - Atij që krijoi qiejt e Tokën dhe unë nuk jam prej idhujtarëve.”⁷⁹

Edhe Muhamedit a.s. vazhdimisht i parashtronin pyetje nga më të ndryshmet, një nga pyetjet e tyre ishte edhe kjo:

"Kush do t'i ringjallë këto eshtra të kalbura?"⁸⁰

Allahu xh.sh. kësaj pyetje iu përgjigj:

“Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë.”⁸¹

⁷⁹ Kur'an, Sure En'am: 74-79

⁸⁰ Kur'an, Sure Jasin: 78

⁸¹ Kur'an, Sure Jasin: 79

prandaj ju pyes, kush ju krijoi për herë të parë?!

Do ta përmbyllim këtë ligjëratë duke e përmendur rastin e arsimtarit ateist në Shqipërinë Moniste, i cili deklaronte se s'ka Zot.

Një ditë një arsimtar, i nxitur nga arroganca, del në natyrë bashkë me nxënësit dhe i pyet: "Nxënës! A i shihni malet?" – "Po!", u përgjigjën njëzëri nxënësit. "Domethënë malet ekzistojnë!", ua kthen ai. "Po a e shihni diellin?" Ata përsëri përgjigjen: "Po!" - "Domethënë dielli ekziston.", – pohon arsimtari. "Tani keni kujdes se çfarë ju pyes: "A e shihni Zotin?"" Ata heshtën për një çast dhe pastaj me zë të zbehtë përgjigjen: "Jo!". Arsimtari ua ktheu: "Domethënë Zoti nuk ekziston.". Në mesin e tyre ishte një nxënës shumë i shkathët dhe inteligjent. E ngriti dorën për të parashtruar një pyetje dhe tha: "Arsimtar! Po ju a shihni mendjen dhe logjikën tuaj?" Ai me nervozizëm ia kthen: "Jo, nuk e shoh, e çka dëshiron të thuash më këtë?", - "Unë nuk thashë gjë, por në bazë të argumenteve që the, se gjithçka që shihet ekziston dhe gjithçka që nuk shihet nuk ekziston, i bie që ju nuk paskeni mendje dhe logjikë".

TRE SPROVA NGA ZOTI

Ka një grup njerëzish që fatmirësisht e kanë gjetur dhe e shijojnë në zemra ëmbëlsinë e të qenët besimtarë. Ky besim reflektohet në fytyrat e tyre. Këta njerëz, pavarësisht se në të kaluarën kanë qenë me emër musliman dhe me prindër muslimanë, nuk kanë qenë praktikues të Islamit, dhe tashmë pas rikthimit të tyre në binaret e qëndrueshme të Islamit, e ndryshojnë për së mbari karakterin e tyre, fillojnë të flasin ndryshe, të vishen ndryshe, të shprehen ndryshe, të mendojnë ndryshe, të sillen ndryshe në familje dhe shoqëri. Dëshiroj të ndalem pikërisht te kjo kategori njerëzish, të cilët janë në fazën fillestare të praktikës së Islamit, dhe duke ndryshuar krejtësisht personalitetin, ata shihen me syrin kritik, bile në shumë raste edhe nënçmues, fillimisht prej familjes së vet më të ngushtë, pastaj edhe nga ata që i rrethojnë. Veç kësaj, u thonë:

“Mos hyn kaq thellë në fe se do të zhytesh”.

Kjo është një fjalë që nuk buron prej urrejtjes dhe xhelozisë, por prej injorancës së tyre në fe. Sa herë që të keni raste të tilla me familjet tuaja, mos u sillni ashpër me ta, sepse kjo është prova e parë që Allahu xh.sh. ua bën juve. Allahu xh.sh. thotë:

“A menduan njerëzit të thonë: “ne kemi besuar e të mos vihen në provë. Ne i provuam ata që ishin para tyre...”⁸²,

por duhet t’ju karakterizojë një qetësi në ballafaqimin me ta; pa marrë parasysh sa të ashpër janë prindërit me ju, nuk guxoni t’ua ktheni fjalët me ton të lartë, por duhet të reflektoni një sjellje dhe edukatë që e keni trashëguar prej Muhamedit a.s., e nëse ata ende nuk kuptojmë, atëherë duhet të bëni durim dhe t’i luteni Zotit që t’i zbutë zemrat e tyre. Nuk guxoni t’u bërtisni atyre me nervozë, të

⁸² Kur’an, Sure Ankebut: 2-3

thoni se nuk dinë asgjë apo se do të dënohen prej Zotit. As t'ua përplasni derën dhe të largoheni, por të qëndroni aty dhe të ballafaqoheni me problemin me qetësi, ashtu siç i takon një muslimani të sjellshëm.

Besimtari që fillon ta shijojë Islamin e vërtetë, ballafaqohet edhe me një sprovë të dytë, shoqëria e vjetër e ahengejeve dhe zbavitjeve nuk mund ta kuptojnë atë, sepse nuk e gjejnë në vendet e zakonshme, prandaj si rezultat i kësaj ata fillojnë ta tallin dhe gradualisht të largohen prej tij, edhe pse ky nuk e dëshiron këtë gjë.

Ka edhe një sprovë tjetër, ai duke u larguar prej veseve djallëzore, fillon të vetëdijesohet dhe t'u largohet punëve që janë të përziara me haram. Nëse ka punuar në vende ku përhapet imoraliteti, ku është pirë alkooli, ku luhej bixhozi, e kështu me radhë, ky njeri fillon të mendojë për të dhënë dorëheqje nga këto punë të cilat ia shqetësojnë shpirtin.

Nëse besimtari ballafaqohet me këto tri probleme, të cilat janë sprovë prej Zotit, Allahu xh.sh. i largon këto sprova, ia kthen në kënaqësi dhe ia hapën dyert e suksesit dhe të mirësisë nga ku ai s'e paramendon. Familjarët e tij fillojnë ta kuptojnë, t'u pëlqejë sjellja dhe përkushtimi i tij ndaj tyre, saqë fillojnë ta pëlqejnë edhe atë që prezanton ai. Shoqëria fillon ta kuptojë se ai ka ndryshuar tashmë për së mbari dhe ky bëhet shkaktar që edhe ata të fillojnë të vijnë në xhami bashkë me të. E nëse kjo nuk ndodhën, atëherë Allahu xh.sh. atë shoqëri të shthurur ia zëvendëson me një shoqëri të vërtetë vëllazërore dhe islame. Pas shumë përpjekjesh, ai gjen edhe një punë më të mirë dhe më të sigurt. Fillon që bereqeti t'i shtohet më shumë, por edhe nëse do të ketë më pak sesa ka pasur përpara, ai do të jetë i kënaqur, sepse është një pasuri e fituar në mënyrë të ndershme.

Nuk duhet të sillemi me arrogancë ndaj atyre që nuk e kuptojnë mënyrën e jetesës sonë, sepse edhe ne dikur kemi qenë si ata, por të tregojmë edukatë dhe sjellje shembullore ndaj tyre, dhe të

komunikojmë me ata në mënyrë të qetë. Ndoshta kjo do të reflektojë tek ata pozitivisht dhe do pajtohen me ne. Allahu xh.sh. kur i tha Musait a.s. që të shkojë t'ia tërheqë vërejtjen Faraonit i cili kishte mohuar Allahun xh.sh. dhe e kishte shpallur veten për zot, i tha:

“Atij thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet”⁸³.

Të gjithë ata që e konsiderojnë veten besimtarë, kurse në anën tjetër mundohen t'ua imponojnë të tjerëve Islamin, u themi se ju nuk janë më të mirë se Musai a.s., ndërsa ata që janë përball jush, familjarët apo shokët tuaj, të cilët ende s'e kanë kuptuar realitetin e Islamit, mos mendoni se janë më të këqij se Faraoni, prandaj, ashtu siç Musai i foli Faraonit me fjalë të buta, ashtu flisni edhe ju njerëzve tuaj!

⁸³ Kur'an, Sure TaHa: 44

FESTIMI I VITIT TË RI

Profeti Muhamedi a.s. ka thënë:

“Do të pasoni adetet e atyre që kanë qenë para jush pëllëmbë pas pëllëmbë e kut pas kuti, saqë po të hynin ata në vrimën e hardhucës edhe ju do t'i pasoni ata.” E pyetëm: “Kush janë ata, çifutët dhe të krishterët?” U përgjigj: “Kush tjetër pos tyre?!”⁸⁴

E kanë pyetur një teolog: “Në qoftë se një njeri ka pasur një vit të mbarë, a lejohet që ta festojë fundin e tij?” Nëse, për shembull, bëhet fjalë për një student i cili në vitin që la pas kishte sukses shembullor, ose për një tregtar i cili në bilancin përfundimtar ka dalë në suficit (fitim), ose një punonjës publik apo nëpunës i cili ka pasur vlerësime në punë dhe gradim në karrierë, ose një bujk që brenda vitit ka pasur të ardhura të kënaqshme, a ka diçka të ndaluar që ai ta festojë përfundimin e atij viti?” Përgjigjja e menjëhershme e teologut ishte: “Po, mund ta festosh, nëse me festimin tënd nuk shkel kufijtë e Zotit (haramet)” Kjo përgjigje e shtyu përsëri pyetësin që ta parashtrojë një nën pyetje: “A lejohet të festohet viti i ri nëse viti që ke lënë pas ka qenë i suksesshëm?” Përgjigjja e teologut ishte e shkurtë dhe qartë: “Jo, nuk lejohet imitimi i të tjerëve në fe!”

Një nga festat që më shumë festohet në Perëndim është padyshim ndërrimi i viteve. Unë si asnjëherë më parë, do të përmend një argument për ndalimin e festimit të 1 janarit, jo prej Kur’ani, por prej vetë Biblës e cila është libër i shenjtë i atyre që sot me të madhe e festojnë këtë festë, bile duke qenë bartës të ligjeve, ua imponojnë edhe të tjerëve duke u dhënë pushime dhe duke ua zbukuruar me propaganda të ndryshme vizive dhe mediatike. Bibla thotë:

⁸⁴ Transmeton Buhariu

“Me ngulmim, në emër të Zotit, ju them: “Ju s’duhet të jetoni më si paganët... Meqë nuk e njohin Perëndinë dhe s’duan të dinë gjë për Të, janë të verbër për të vërtetën dhe s’kanë asnjë pjesë në jetën e vërtetë, e cila vjen nga Perëndia...”⁸⁵

Duke u bazuar në thënien e lartshënuar biblike, të krishterët njëmbëdhjetë shekuj patën neveri (e ndaluan) nga festimi dhe kremtimi i 1 janarit të vitit të ri si traditë pagane, por me kalimin e kohës Kisha e pranoi 1 janarin si fillim të vitit të ri diellor, pra, me këtë kuptojmë se në vend që krishterimi ta krishterizojë Evropën, ndodhi e kundërta, Evropa e paganizoi Krishterimin, prandaj sot ndodhën një fenomen i ngjashëm, në vend që Krishterimi ta krishterizojë Perëndimin, Perëndimi e modernizoi apo reformoi Krishterimin.

Pra, e kuptuam se festimi i vitit të ri ka bazë në paganizëm, por parashtrohet pyetja:

“Forma e sotshme e festimit, a përngjan me të atëhershmen?”

Duke e shikuar këtë në prizmin e aktualitetit shqiptar, festimi, kremtimi, ceremonia, blerjet jo normale, ndejat e shfrenuara me pije alkoolike, puthjet dhe përqafimet në publik, fishekzjarrët, të shtënat me armë, shpërthimet eksploduese, thyerjet e xhamave, prishja e rendit publik dhe e qetësisë së qytetarëve, pritja e përbashkët zhurmëmadhe e vitit të ri, urimet dhe programet speciale me muzikë, këngë dhe valle, nuk janë asgjë tjetër veçse vazhdim i traditës, riteve dhe zakoneve të vjetra pagane e idhujtare të egjiptianëve të vjetër dhe të romakëve të cilat i bënin për nder të hyjneshave të tyre të rrejshme.

“Çka mendojnë njerëzit kur festojnë?”

Ata thonë:

⁸⁵ Bibël, Libri i Efesianëve, 4:18

“Me vitin e vjetër mbetet çdo gjë e vjetër, në radhë të parë shpresat e parealizuar, ndërsa viti i ri, si çdo gjë e re do t'i përmbushë dëshirat dhe ëndrrat tona”.

Por në realitet, me ndërrimin e moteve nuk ndryshon koha, nuk ndryshojnë gjërat vetvetiu, as nuk transformohet njeriu brenda natës. A nuk është koha diçka tjetër përveç se sot, dje dhe nesër? Ajo shkon dhe kthehet te ne duke na dhënë herë natën herë ditën. Nuk kalon koha, por ne jemi ato që kalojmë dhe plakemi. Mos vallë mendoni se nesër ashtu rastësisht do të ndryshojë gjithçka për sëmbari? Mos vallë mendoni se nesër ashtu rastësisht të papunët do të punësohen, të varfrit do të pasurohen? Zoti thotë në Kur'an:

“Allahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli përderisa ata vetë nuk e ndryshojnë gjendjen e tyre”⁸⁶.

Prandaj, si mund të festojmë sot kur të gjithë jemi të pakënaqur me jetën tonë ekonomike, politike dhe sociale. Përse vallë t'i festojmë vitet e reja kur gjithmonë na përsëritet e njëjta histori?!”

Edhe vendosja dhe zbukurimi i pemës së krishtlindjeve, pavarësisht kotësisë së saj, fatkeqësisht ka mbetur traditë te ne. Nëse secilin njeri do ta kishim pyetur se prej ku buron kjo traditë, do të ishte përgjigjur se është traditë krishtere. Prandaj duke u bazuar në vetë Dhjatrën e Vjetër, diçka e tillë është shpikur para ardhjes së Jezusit (Isait a.s.), më konkretisht prej në kohën e paganizmit romak. Bibla, në Librin e Jeremias, thotë:

“Kështu tha Perëndia: mos ndiqni zakonet e kombeve tjera e as mos u frikësoni nga shenjat që jepen në qiell, ndonëse të tjerët mund të tmerrohen prej tyre, pasi zakonet e popujve tjerë janë të pavlera, ata presin një pemë në pyll dhe me daltë i japin formë. E zbukurojnë me

argjend e flori dhe e gozhdojnë për të mos lëvizur.. prej tyre nuk vjen ndonjë e keqe, por ama nuk vjen edhe asnjë e mirë”⁸⁷.

Me këtë mund të përfundojmë se nuk duhet të festohen festat e huaja përderisa kemi tonat, dhe nuk duhet të imitojmë të tjerët (krishterët dhe çifutët), sepse edhe vetë ata imitojnë të mëhershmit. Prandaj, kurrë mos e braktis identitetin tënd, se të huajt s’të lanë të marrësh të tyren.

⁸⁷ Libri I, 10: 2-5

FRYTET E MUAJIT TË AGJËRIMIT

E falënderojmë Zotin që na e mundësoi përsëri të takohemi me mikun tonë të vçantë dhe shumë të dashur për të gjithë ne. Ky muaj njëkohësisht është edhe lajmëtar i Allahut për gjendjen tonë shpirtërore, ai është muaji i bekuar i Ramazanit.

Muaji i agjërimit është muaj i kthimit te Allahu xh.sh., kërkimi i faljes dhe ecja drejt Tij. Agjërimi është paqe me Zotin e botrave, dhe një qetësi shpirtërore e pa përshkruar. Këtë ndjesi e kupton vetëm ai që e ka arritur qëllimin e agjërimit, është pikërisht ai besimtar që ardhjen e këtij muaji e priste me padurim, njësoj sikur ta priste vëllain, motrën apo një mik që e do shumë, të cilin nuk e ka parë me vite të tëra. Nga dashuria e madhe, emocionohet dhe e mbulojnë lotët kur e përqafton. Këtë ndjesi e kupton ai besimtar i cili kur përfundon muaji i Ramazanit, pikëllohet pa masë sepse nuk është i sigurt se a do ta takojë përsëri vitin e ardhshëm, njëjtë si shembulli i prindërve pleq, të cilët të pikëlluar, përshëndeten me djalin e tyre që shkon në mërgim, sepse janë të vetëdijshëm se ndoshta nuk do jenë gjallë ta takojnë atë përsëri vitin e ardhshëm.

Agjërimi është gjithashtu edhe paqe me veten, pasi në këtë muaj djalli i mallkuar është i prangosur dhe i burgosur, kurse besimtari ka bërë pakt me trurin që ky i fundit të pakësojë kërkesat dhe t'u japë urdhër organeve që gjatë ditës edhe ato të qëndrojnë të qeta dhe në heshtje. Kjo është arsyeja se pse habiten të huajt jomuslimanë kur u themi se ne qëndrojmë pa hëngër dhe pa pirë afërsisht deri 19 orë në ditë, ato nuk e kuptojnë se gjithcka lidhet me zemrën dhe trurin tonë.

Muhamedi a.s. gëzohesh shumë me ardhjen e Ramazanit, këtë gëzim e ndante me familjen dhe me shokët e tij, me nevojtarët,

jetimët dhe me të sëmurët. Ai e çmonte shumë muajin e Ramazanit, saqë në një rast tha:

“Kur vjen muaji i agjërimit, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e zjarrit dhe prangosen djajtë e mallkuar”⁸⁸.

Të nderuar lexues, ky muaj është shumë i rëndësishëm për jetën e besimtarëve, ata mezi presin që të takohen me Ramazanin, por edhe ky muaj mezi pret që të takohet me besimtarët, prandaj “jo rastësisht, çdo vit vjen dhjetë ditë më parë”. Në këtë muaj është një natë e cila është vendimtare për njeriun dhe është më e vlefshme se një mijë muaj, ajo është Nata e Kadrit. Allahu Fuqiptotë në Librin e Tij ka zbritur një sure të plotë për këtë muaj, përveç kësaj, gjithashtu e ka titulluar me emrin e tij, surja e Kadrit. Allahu xh.sh. thotë:

“Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në Natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se ç'është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.”⁸⁹

Pra, vlera më e madhe e Muajit të Ramazanit është se ky muaj është ditëlindja e Kuranit. Në këtë natë, derisa profeti Muhamed a.s. ishte në shpellën Hira, në afërsi të vendlindjes së tij Mekes, për herë të parë pas shumë qindra vitesh ballafaqohet qiellorja me tokësoren, me urdhrin e Zotit zbret Shpirti i Shenjtë, Xhibrili a.s. dhe ia shpallën Fjalën e Zotit **“Ikre – lexo!”⁹⁰** dhe fillimin e Kuranit Famëlartë, të Dërguarit modest, Muhamedit a.s..

Të flasësh për Kur'anin është detyrë e rëndë, sepse çdo fjalë duhet të jetë superiore, në anën tjetër, ekziston edhe frika se mos vallë fjala jonë nuk do ta përcjellë porosinë ashtu siç Ai e meriton. Shumë

⁸⁸ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

⁸⁹ Kur'an, Sure Kadr: 1-5

⁹⁰ Kur'an, Sure Alek : 1

dijetarë, shkrimtarë, filozofë, poetë, shkencëtarë etj., e kanë lavdëruar Kuranin, por më mirë se të gjithë këto e di vetë Allahu xh.sh., pasi Kurani është fjala e Tij e amshuar. Kur Allahu xh.sh. tregon për vlerën e Muajit të Ramazanit, Ai gjithashtu tregon edhe për domethënien e Kuranit, Ai thotë:

“(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në të (filloi të) shpallet Kur'ani, i cili është udhërrëfyes për njerëz, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)”⁹¹.

Agjërimi i muajit të bekuar të Ramazanit është një urdhër Perëndie. Allahu xh.sh. është Zoti, Krijuesi dhe Furnizuesi ynë, kur Ai na obligon me diçka, nuk ka nevojë dhe nuk detyrohet të na arsyetohet, s'ka detyrim të na tregojë arsyen dhe qëllimin e një urdhri të tillë. Megjithatë, duke e njohur natyrën njerëzore, se njeriu para se të veprojë një veprim të caktuar është kureshtar ta dijë se përse duhet ta veprojë atë, , Allahu xh.sh. e tregon edhe qëllimin final të agjëritimit. Ai thotë në Kur'anin Famëlartë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”⁹²

Ky ajet parasheh tre elemente kryesore:

1. Agjërimi i Muajit të Ramazanit është privilegj vetëm për besimtarët. Allahu xh.sh. nuk tha “O ju njerëz!” apo “O ju muslimanë!”, por tha: “O ju besimtarë!” për arsye se ka shumë njerëz që thonë se janë të mirë dhe zemërbardhë, gjithashtu ka shumë njerëz që kanë emra muslimanë apo pretendojnë se janë të besimit Islam, por me punët që veprojnë dhe me fjalët që flasin nuk mund të jenë asgjë tjetër pos pasues të djallit të mallkuar, madje jo që vetë nuk agjërojnë Ramazanin, por pengojnë edhe tjerët që të agjërojnë. Kur Allahu

⁹¹ Kur'an, Sure Bekare: 185

⁹² Kur'an, Sure Bekare: 183

xh.sh. na drejtohet me fjalën “besimtarë” ne duhet të jemi në gatishmëri t’i themi: “Urdhëro o Zot, ne të bindemi në gjithçka që urdhëron!”, me këtë rast kthehemi në misionarë të Zotit në Tokë dhe obligohemi të urdhërojmë në të mirë dhe të ndalojmë nga e keqja. Kështu vepronin sahabët, sa herë që Zoti u drejtohej me “o ju besimtar!”, ata hapnin veshët dhe prisnin me gatishmëri se çfarë do t’i urdhërojë Zoti.

2. Agjërimi nuk është një ibadet i ri vetëm për umetin e Muhamedit a.s., por është një ibadet që e kanë pasur edhe popujt e mëparshëm, siç ishte agjërimi i Davudit a.s. një ditë po dhe një ditë jo, agjërimi i Ditës së Ashurës nga Musait a.s., agjërimi i Isait a.s. dyzet ditë para shpalljes së Tevratit, etj. Me këtë Allahu xh.sh. dëshiron të na qetësojë, duke na bërë të kuptojmë, se nuk jemi të parët që agjërojmë, por ka pasur edhe para nesh njerëz që kanë agjëruar. Këtë e bën sepse ka shumë njerëz që më shumë binden me traditën e të parëve të tyre sesa me fjalën e Zotit. Shihni se si i përshkruan Kur’ani përgjigjet e idhujtarëve kur janë pyetur për besimin e tyre:

“Dhe kur atyre u thuhet: "Pasoni atë që e shpall Allahu!", ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë që gjetëm tek prindërit tanë!" E edhe sikur djalli t’i kishte thirrur ata në dënimin e zjarhtë!”⁹³

Me fjalën: “ashtu siç ka qenë borxh edhe për popujt para jush”, Allahu xh.sh. atyre që mundohen të arsyetohen për mos agjërimin e tyre ua mbyll të gjitha shtigjet e arsyetimeve kurse ata që kanë agjëruar ua kujton se janë duke ndjekur traditën e baballarëve të tyre musliman dhe kjo i bën ato krenar.

3. Qëllimi final i agjërimin është arritja e devotshmërisë shpirtërore. Po çka në realitet është devotshmëria? Ku gjendet ajo? Cilat janë frytet e saj?

⁹³ Kur’an, Sure Llukman: 21

Devotshmëri domethënë, vendosja e pengesës mes robit dhe hidhërimit të Allahut xh.sh., apo mes tij dhe zjarrit, duke vepruar vepra të mira dhe duke u larguar nga mëkatet. Origjina e devotshmërisë është në zemër, siç ka thënë Profeti a.s.:

“Devotshmëria është këtu, devotshmëria është këtu (duke bërë me gisht drejt gjoksit të tij)”⁹⁴.

Kurse fryti i devotshmërisë është qetësia shpirtërore, prehja dhe mbështetja vetëm te Krijuesi i gjithësisë. Allahu i Lartësuar në Librin e Tij thotë:

“Kush i frikësohet Allahut (arrin devotshmërinë) dhe iu përmbahet dispozitave të Tij, Allahu do t’i jep atij zgjidhje (rrugë) për çdo vështirësi”⁹⁵.

Sahabiu Ebu Dherr, ka thënë: “Kur zbriti ky ajet kur’anor, Pejgamberi a.s. filloi ta lexojë pa ndalë, derisa më erdhi dremitja (gjumi), pastaj më tha:

“O Ebu Dherr, nëse njerëzit realisht besojnë në këtë ajet, do t’u mjaftonte atyre (për të kuptuar fenë)”⁹⁶.

Agjërimi, adhurim i veçantë

Allahu xh.sh. në një hadith kudsij thotë:

“Të gjitha ibadetet e bijve të Ademit janë vetëm por ta, përpos agjërit. Agjërimi është për Mua dhe vetëm Unë do të kujdesem për shpërblimin e agjëruësve”⁹⁷.

⁹⁴ Transmeton Muslimi

⁹⁵ Kur’an, Sure Talak: 2

⁹⁶ Transmeton Hakimi

⁹⁷ Transmeton Ibn Maxheja

Kjo nuk do të thotë se për ibadetet dhe obligimet tjera të kryera prej besimtarëve do t'i shpërblejë dikush tjetër pos Allahut, por Zoti i Madhërishëm shpërblimin e agjëruesve e bën enigmatike dhe surprizuese vetëm për Botën Tjetër. Jo rastësisht, kur Muhamedi a.s. i tregon gëzimet e agjëruesve, citon Zotin përmes hadithit Kudsij:

“Agjërimi është për Mua dhe Unë e shpërblej për të, ai i largohet kënaqësive dhe ngrënies për Mua. Për agjëruesin ka dy gëzime, një kur ha iftarin dhe tjetri kur të takojë Zotin e tij. Era e gojës së agjëruesit, tek Allahu është më e mirë se era e miskut.”⁹⁸

Agjëruesi nuk gëzohet kur pas shumë orësh etje dhe uri, i rikthehet ushqimit, por gëzohet sepse e çoi në vend porosinë e Zotit, iu përmbajt premtimit dhe besës së dhënë. Pa marrë parasysh kushteve dhe rrethanave, ai nuk do të hajë, nuk do të pijë dhe nuk do t'u nënshtrohet epsheve, prej agimi deri në perëndim të diellit. Kurse gëzimi në Botën Tjetër është shumë më i madh, sepse në fund do ta kuptojë shpërblimin e agjërimit që ia kishte premtuar Allahu qysh në këtë botë,, pra do t'a zbulojë enigmën dhe do ti qartësohet sekreti i shpërblimit të Zotit.

Agjërimi është akt i veçantë i adhurimit sepse është një punë e fshehtë që nuk duket dhe nuk preket. Të gjitha obligimet tjera që i bën besimtari janë të dukshme dhe kërkojnë veprim, p.sh. namazi kërkon pastërti dhe abdes, lëvizje trupore, përkulje dhe gjunjëzim; zeqati kërkon transferim të hollash te të varfërit, haxhi kërkon mundësi materiale dhe nisje në udhëtim për në vendet e shenjta, kurse agjërimi është privim prej veprimit, abstenim dhe largim nga punët që në situata normale janë të lejuara, si: haja, pija, dhe marrëdhëniet intime prej në agim deri në perëndim të diellit. Etja dhe uria nuk mund të shihen apo të preken, por ato vetëm ndjehen. Një njeri mund të paraqitet para njerëzve gjoja se agjëron, por pastaj

⁹⁸ Transmeton Buhariu

mund të veçohet duke menduar se nuk e sheh askush dhe të hajë apo të pijë. Besimtari i vërtetë këtë nuk e bën asnjëherë, sepse ai e di se Allahu xh.sh. e shikon shumë mirë, prandaj nuk dëshiron që ta thyen besën e dhënë Zotit të botëve. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Agjërimi dhe Kur’ani janë dy ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit. Agjërimi do të thotë: “O Zot! Unë e shtyva agjërimtarin që të largohet nga ushqimi dhe nga epshi gjatë gjithë ditës. Lejomë të ndërmjetësoj për të!” Kur’ani do të thotë: “Kurse Unë e pengova nga gjumi natën. Lejomë të ndërmjetësoj për të!” Dhe ndërmjetësimi i tyre do të pranohet”⁹⁹.

Ramazani, muaji i faljes

Ramazani është burim i faljes nga i Madhi Zot, këtë e vërteton Muhamedi a.s., i cili thotë:

“Kush agjëron Ramazanin nga besimi dhe kërkon shpërblim nga Allahu, të gjitha mëkatet e kaluara do t’i falen”¹⁰⁰.

Ta ilustrojmë këtë falje të Zotit me një shembull konkret:

Imagjinojmë se një njeri ka marrë një shumë të madhe parash prej dikujt borxh, në afatin që duhet t’i kthejë të hollat, ai nuk ka mundësi materiale, kështu që borxhmarrësi detyrohet t’i bëjë aktpadi në gjyq. Gjyqi merr vendim që tërë pasurinë e patundshme t’ia konfiskoje borxhliut, por jo vetëm kaq, edhe ta burgosin. Kështu që, përveç dënimit dhe falimentimit, ai do të nënçmohet para familjes dhe shoqërisë. Borxhliu prej halleve që e kanë kapluar, mund të kalojë në gjendje stresuese dhe në depresion, bile mund të fillojë të mendojë edhe për vetëvrasje. Imagjiloni sikur t’i afrohej një pasanik këtij borxhliu, t’i jepte një ofertë të mirë dhe t’i thoshte:

⁹⁹ Transmeton Muslimi

¹⁰⁰ Transmeton Buhariu

“Nëse vjen tek unë në punë dhe punon çka të të urdhëroj, do të t’i shlyej të gjitha borxhet e kaluara.”

A thua vallë ky njeri do të hezitonte që të pranojë ofertën e punës? Gjithsesi se do ta pranonte punën me kënaqësinë më të madhe. Kështu është edhe me Ramazanin, Allahu xh.sh. na ka dhënë një ofertë shumë fitimprurëse, nëse e agjërojmë Muajin e Ramazanit me besim dhe me pendim, Ai do të na i falën të gjitha mëkatet e kaluara.

Ramazani, muaj trajnues dhe mbushës i besimit tonë

Një njeri që në periudhë të Ramazanit largohet prej hajes, pijes dhe epshit, nuk e ka të vështirë që nesër pas Ramazanit të largohet nga mëkatet e vogla dhe të mëdha. Agjërimi është trajnues, na bën më të fortë në një botë mizore në të cilën tenton të mbizotërojë ligësia. Të gjitha obligimet dhe urdhrat e Zotit kanë urtësinë dhe dobinë e tyre. Dobia e tyre në këtë botë ka hapësirë kohore, kurse në Botën e Amshueshme u bën dritë atyre. Ibadetet janë mbushës energjish në periudhë të caktuar kohore. p.sh. namazet ditore, prej njërit namaz në tjetrin, janë fuqi shpirtërore dhe fizike, prandaj Ebu Se’id el-Hudri r.a. ka thënë se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

“Pesë namazet e shlyejnë atë çka është mes tyre”¹⁰¹.

Xhumaja është mbushës javor dhe informues i ngjarjeve javore. Haxhi është mbushës i besimit tonë jetësor dhe pastrues i mëkateve tona jetësore. Ebu Hurejreja përcjell nga i Dërguari i Allahut a.s. se ka thënë:

¹⁰¹ Transmeton Bezari dhe Taberani

“Kush e bën haxhin në këtë shtëpi (duke aluduar për Qaben) dhe nuk flet fjalë të kota e as që bën mëkate, kthehet i pastër nga mëkatet sikur që e ka lindur nëna”¹⁰²

Në këtë prizëm, agjërimi i Muajit të Ramazanit konsiderohet një mbushës vjetor i besimit tonë dhe ripërtërirës i besimit tonë.

Ramazani, përkujtues se njeriu është nevojtar për Zotin

Njeriu shpeshherë i bën padrejtësi vetes dhe bëhet arrogant, i pacipë, i ligë, tradhtar dhe kryelartë kundrejt urdhreve të Zotit. Ai shpesh e harron natyrën e tij nevojtare dhe e harron Krijuesin e tij që është Mëshirues, Furnizues dhe Mbikëqyrës, saqë kemi raste kur pasuria, fama dhe pozita, njeriun e bën kryelartë ekstrem dhe në fund e shpallën veten edhe zot (njësoj si Faraoni). Ndonjëherë pasuria dhe fama bëhen shkaktarë që njeriu të harrojë se pasuria është mirësi prej Zotit.

Dikur ka jetuar një mbret, një ditë e urdhëron shërbëtorin që t'i mbushë një gotë ujë. Aty afër qëndronte edhe këshilltari i tij i cili e pyeti diçka mbretin: “O mbret! Ta zëmë se nuk ke pirë ujë me ditë të tëra, sa pasuri do të kishe dhënë për këtë gotë ujë?” Ai përgjigjet: “Gjysmën e pasurisë!” Vazhdon këshilltari: “Po sikur të kishe pasur vështirësi me ditë të tëra për ta nxjerr këtë ujë nga trupi (të urinosh), sa pasuri do të kishe shpenzuar për ta nxjerrë?” Ai përgjigjet: “Edhe gjysmën tjetër të pasurisë!”

Pra, nëse pasuria e këtij mbreti paska vlerën e një gote uji, vallë sa vlerë mund të ketë pasuria e njerëzve të thjeshtë?! Nga ky shembull kuptojmë se një njeri që ka nevojë s'mund të jetë diçka më shumë sesa një nevojtar për Zotin e tij. Këtë më mirë e kuptojmë gjatë agjërit.

Një pronar i pasur, ka qenë shumë arrogant me punëtorët, saqë ditë për ditë ua ka shtuar punën fizike dhe nuk u ka dhënë ushqim të mjaftueshëm. Punëtorët, çdo ditë i janë ankuar, por ai nuk ua ka varur veshin. Një ditë, fshehurazi dëgjon punëtorët duke thënë: “Le të punojë njëherë si ne dhe do ta shohë se s’ka të drejtë të bëhet arrogant ndaj nesh”. Kështu, që ditën e ardhshme vendosi të shndërrohet në një punëtor të thjeshtë, të punojë sa tjerër dhe të hajë sa ata. Ditën e nesërme, pas një pune të lodhshme, befasohet për vështirësinë e punës. Gjithashtu, kur erdhi koha e ushqimit të drekës, ushqimi ishte aq i pamjaftueshëm, saqë dukej si para haje. Pra, pronari duhej të shndërrohet në punëtor për të kuptuar hallet e tyre. Ashtu është edhe me agjëruesin, besimtari asnjëherë nuk mund t’i kuptojë vuajtjet e të varfërve dhe të sëmurëve nëse vetë nuk e përjeton urinë, etjen dhe dhimbjen e stomakut. Me agjërimin e Ramazanit, njeriu bëhet më i ndjeshëm dhe më i mëshirshëm me këtë kategori të rrezikuar të njerëzve, sepse uria dhe etja e shtyjnë atë që të mendojë për të varfrit dhe, në të ardhmen, të kontribuojë për ta. E lus Allahun e Madhërishëm dhe të Plotfuqishëm që të na e pranojë agjërimin dhe të gjitha ibadetet tona! Të na e mundësojë që të hyjmë në Xhenet përmes derës *Rejjan*, derë e posaçme vetëm për ata që kanë agjëruar dhe janë përmbajtur prej punëve të këqija!

Çka pas Ramazanit?

Është heroizëm që, kthimin dhe pendimin te Ai ta vazhdojmë edhe pas këtij muaji, duke i vazhduar të gjitha sjelljet shembullore që i kemi pasur gjatë këtij muaji madhështor.

Miqte e mi, tani jemi në periudhën pas Ramazanit, periudhë që shpresojmë të kemi arritur titullin e “personave të devotshëm”, sepse Zoti na obligoi me agjërim pikërisht për të arritur këtë titull, njëjtë si studenti që detyrohet të japë mbi dyzet provime për të arritur në

fund të diplomimit titullin e shumëpritur. Zoti xh.sh. në Kuran thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”¹⁰³

Devotshmëri domethënë arritje e gradës në të cilën Allahu, Zoti I botëve, është i kënaqur me ne dhe me punën tonë. Besimtari arriti grada të larta në këtë muaj, këto garda të përsosmërisë morale fitohen në ditë të caktuara kohore, siç është rasti në Natën e Kadrit, në të cilën zbresin melekët më të dalluar me në krye Xhibrilin a.s. vetëm për t’i dëgjuar lutjet e besimtarëve dhe për të kërkuar prej Zotit t’i përmbush nevojat e tyre. Është mëkat i madh, që pas kësaj përsosmërie morale, të kthehemi në zakonet e vjetra që kanë qenë para muajit të Ramazanit, duke kaluar kohën kotë, duke u zbavitur dhe duke shkelur dispozitat e Allahut xh.sh.. Një poet, ndjenjën mëkatore pas përfundimit të këtij muaji e përshkruan kështu:

“Ramazani është përfunduar, prandaj më sillni një gotë raki, sepse atë e ka marr malli për mua dhe mua më ka marrë malli për të.”

Por kur njeriu, pas një adhurimi drejtuar Zotit, i kthehet përsëri avazit të vjetër, ka mundësi t’i prishet gjithë ajo që ka bërë gjatë muajit të agjërit, por ndoshta edhe për gjithë jetën.

Ne besimtarët, tash pas Ramazanit duhet të jemi më të kujdesshëm me veten dhe me të tjerët. Duhet të tregohemi të sjellshëm në jetën personale, në marrëdhëniet tona me prindërit, me bashkëshortin apo bashkëshorten, me fëmijët, me fqinjët, me farefisninë etj.. Sot ne duhet të tregoheni të kujdesshëm me të gjithë ata që s’kanë agjëruar, sepse nëse sjellja jonë është joshembullore, atëherë ata do të thonë:

“Çfarë dobie kanë pasur agjëruesit që janë privuar nga haja dhe pija, kur ata vazhdojnë të jenë të paedukatë”.

Ky muaj ka qenë një shans vjetor dhe një mundësi për ne që të fitojmë dashurinë e Zotit dhe Faljen e Tij, sepse transmetohet se Muhamedi a.s. një ditë të xhuma hipi në shkallën e parë të hutbes dhe tha: “Amin!”, ashtu vepron edhe në shkallën e dytë dhe të tretën. Kur zbriti poshtë, shokët e pyetën se përse kishte vepruar ashtu. Pejgamberi a.s., mes tjerash u tha:

“Më erdhi Xhibrili a.s. dhe më tha: “Ai që e ka arritur muajin e Ramazanit dhe nuk e ka fituar faljen e Zotit është i humbur dhe i dëshpëruar. Nëse në Ramazan nuk e fiton faljen e Zotit, atëherë kur mund ta fitosh atë?!”, dhe unë i thashë: “Amin, ashtu qoftë!”¹⁰⁴

Një nga veprimet që ne kemi praktikuar gjatë muajit të Ramazanit është falja e namazit të sabahut dhe të jacisë me xhemat në xhami. Këto, sabahu dhe jacia, janë namazet më të vështira për dyftyreshin (mynafikun), prandaj Muhamedi a.s. thoshte:

“Nuk ka namaz më të rëndë për munafikët se sa namazi i sabahut dhe i jacisë. Po ta dinin se çfarë vlere dhe të mirash ka në to do të vinin, po qe nevoja edhe duke u zvarritur.”¹⁰⁵

Nëse ne vazhdojmë faljen e tyre edhe pas Muajit të Ramazanit, atëherë do të na ngelin shprehi e mirë gjatë gjithë vitit kalendarik. Vura theksin mbi këto dy kohë, sepse në kohën e drekës, iqendisë dhe akshamit, besimtari mund të ketë obligime pune dhe ka mundësi t'i falë edhe në vendin e punës.

Gjithashtu, gjatë Muajit të Ramazanit, kemi lexuar edhe shumë Kur'an. Leximi i Kur'anit është një nga adhurimet më të çmuara në Islam. Shpresoj që një ibadet të tillë do ta vazhdojmë edhe pas Ramazanit. Mbase, edhe mund të lexojmë më pak sesa në Ramazan,

¹⁰⁴ Transmeton Ahmedi

¹⁰⁵ Transmeton Buhariu

por assesi të heqim dorë tërësisht, ngase e dimë shumë mirë se në një shtëpi ku lexohet Kurani Fisnik ka mirësi dhe bereqet, pastaj, mund ta imagjinoni sa mirë është t'i drejtoheni me lutje Atij që disa minuta më parë me kënaqësi ia keni lexuar ajetet e Tij. Njësoj si studenti i cili në provimi shkruan citate nga libri i fundit i atij profesori, tek i cili duhet të hyjë në provim.

Tani u drejtohem atyre që nuk agjëruan:

Të gjithë muajt e vitit janë Ramazan. Nëse Ramazani përfundoi, Allahu xh.sh. është i Gjallë dhe nuk vdes kurrë, kështu që ke ende kohë të pendohesh dhe t'i plotësosh ato ditë. Allahu xh.sh. është Mëshirues dhe Bujar. Nëse Nata e Kadrit kaloi, Kur'anin ende e ke para vetes, lexoje atë dhe fito devotshmërinë që të iku në Ramazan!

MBRET I VETES APO ROB I ZOTIT?

Aspirata për pushtet e ndjek njeriun gjatë gjithë jetës. Hierarkia e dëshirës për pushtet s'ka mbarim, ajo fillon me hapa shumë të vogla dhe nuk shteret asnjëherë, derisa të del fryma e fundit. Nuk besoj se ka ndonjë person që është në një detyrë apo funksion dhe të mos aspirojë diçka më shumë, tjetër çështje është, a mund ta arrijë atë apo jo, ai përsëri vazhdon të ëndërrojë për të. Është një thënie popullore në të cilën thuhet:

“Ai që arrin kulmin në karrierën profesionale, nuk i ngelet asgjë tjetër përpos që të bjerë teposhtë përsëri”,

jo rastësisht, njeriu vazhdimisht ëndërron për më lartë, sepse është i sigurt se nëse pretendon se ky ishte kulmi i karrierës së tij, atëherë s'i ngelet gjë tjetër veçse të zbres teposhtë. Kjo i ngjan fotografisë që tregon hapat e njeriut në jetë: fillon duke qenë fëmijë, me shumë nevoja, dhe përfundon duke e lënë këtë botë përsëri si nevojtar.

Njeriu, qysh në fëmijëri ka nevojë për nënën, për shtratin e rehatshëm që të bëjë gjumin dhe të rritet sa më shpejtë. Me kalimin e kohës, dalëngadalë fillon të ngritet në gjunjë, në këmbë, duke ecur, duke vrapuar, duke punuar, duke u zhvilluar, duke arritur suksese etj., dhe përfundon përsëri duke përjetuar pleqërinë: vitet lënë gjurmë të thella jashtë dhe brenda trupit, lëkura më nuk është e butë siç ishte, flokët janë zbardhur, shikimi dhe dëgjimi janë dobësuar, ka dhimbje të këmbëve, të trupit, fillon ta kaplojë harresa, shndërrohet përsëri në nevojtar për ndihmën e të tjerëve, me kalimin e viteve vazhdon të dobësohet, t'i humb fuqia, t'i zvogëlohet trupi, t'i ndërrojë forma dhe pamja derisa të kthehet në gjendje sikur fëmija i pafuqishëm, pa logjikë dhe pa mundësi të kuptimit të gjërave, kthehet dhe shtrihet përsëri në shtrat, por kësaj radhe, jo për t'u

rritur si në fillim, por për të pritur vizitorin e pa dëshiruar, melekun e vdekjes, për t'ia marrë shpirtin. Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

“All-llahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsmë, më i fuqishëm”¹⁰⁶.

Çudia më e madhe është se asnjëri prej nesh nuk e dëshiron pleqërinë, por derisa jemi të rinj, të gjithë lutemi që të jetojmë gjatë. Shihni se si e përshkruan vetë profeti Zekeria pleqërinë:

“Tha: “Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar”¹⁰⁷.

Referencë e kësaj ligjërate është hadithi i transmetuar nga Zuhriu r.a., i cili ka thënë:

“Qemë informuar se një engjëll i erdhi profetit Muhamed a.s., i cili nuk i kishte ardhur më parë. Në shoqërim të Muhamedit a.s. ishte meleku Xhibril a.s., kështu, engjëlli fliste, kurse Muhamedi a.s. heshte. Meleku tha: “O Muhamed, Zoti yt kërkon të dijë nëse do të jesh një mbret apo një peygamber – rob?” Peygamberi a.s. shikoi Xhibrilin a.s. sikur po kërkonte këshillën e tij. Xhibrili i bëri me gjest që të tregohej i përlur. Kështu, i Dërguari i Allahut tha: “Peygamber rob”.

Si rrjedhojë, dëshirojë t’ju parashtroj një pyetje hipotetike të cilën shpeshherë ia kam bërë edhe vetes:

“Nëse do të kishit mundësi të zgjidhni mes të qenët rob apo mbret, çfarë zgjidhje do të kishit bërë?”

Po të thoshit se do të zgjidhnit robërinë, besoj se s’do të ishit krejtësisht të sigurtë me veten. Unë padyshim do zgjidhja mbretërinë, pasi kjo do të konfirmonte natyrën tonë njerëzore që

¹⁰⁶ Kur'an, Sure Rrum: 54

¹⁰⁷ Kur'an, Sure Mejrem: 4

çdoherë zgjedh më të mirën, pozitën më të lartë, sepse është një natyrë aspiruese në pafundësi, dhe pikërisht këto cilësi neve na dallojnë nga pejgamberët e zgjedhur, të cilët pjesë të karakterit të tyre e kanë pasur modestinë, thjeshtësinë, përvulësinë, jetën mesatare, etj., duke mos aspiruar pasurinë, forcën dhe pushtetin.

Qëllimi final i besimtarit të vërtetë nuk është materializmi, sepse ai është i sigurt se pasuria materiale është relative dhe e përkohshme, prandaj, duke qenë i sigurt se pasuria më e madhe e tij është ana shpirtërore, ai tenton të arrijë qetësinë e brendshme shpirtërore. Muhamedi a.s. ka thënë:

”Kushdo që zgjohet në mëngjes i shëndetshëm në trupin e tij, i sigurt në lagjen e tij dhe duke pasur të sigurt bukën e gojës (për të dhe familjen), do të jetë sikur ka në posedim të gjitha të mirat e botës”¹⁰⁸.

Kjo nuk do të thotë se besimtari duhet të jetë i varfër apo që të kursen për në të ardhmen, përkundrazi, me arritjen e kësaj qetësie të brendshme, ai fiton forcë të madhe për t’i përballuar sfidat e jetës. Pastaj ai e ka shumë të lehtë të kap majat më të larta të suksesit në të gjitha poret e jetës, duke mos anashkaluar edhe pasurinë materiale. Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë thotë:

“Allahu është shumë Bamirës për robërit e vet; Ai e begaton atë që do; Ai është i Gjithëfuqishmi, Ngadhënjesi. Kushdo që dëshiron fitimin e Botës Tjetër (Ahiretit), Ne do t’ia shtojmë fitimin e tij, e kush e dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne ia japim, por në Botën Tjetër ai nuk ka hise.”¹⁰⁹

Duke qenë modest, i thjeshtë dhe i përvulur, nuk do të kesh vetëm cilësi profetike, por edhe gradë të lartë të të qenët besimtar. Të jesh besimtar, domethënë të jesh person i veçantë. Nëse muslimani nuk ndjehet i veçantë, atëherë nuk është besimtar i mirëfilltë. “I(e) veçantë” nënkupton që individualiteti i tij mund të vërehet në të

¹⁰⁸ Transmeton Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe

¹⁰⁹ Kur’an, Sure Shura: 19-20

gjitha poret e jetës. Frika dhe dëshira e besimtarit nuk janë të ngjashme me ato të njerëzve të thjeshtë. Ai i sheh gjërat në një mënyrë të veçantë, prandaj privilegjet e tij ia mundësojnë që ai të jetë i dalluar në mesin e njerëzve të tjerë. Mirëpo, për ta arritur këtë gradë, atij i nevojitet besim i fuqishëm, prej tij kërkohet punë e vështirë, dëshirë e madhe, shoqëri e duhur, edukatorë fetarë dhe të moralshëm, dhe soditje e detajuar e argumenteve të Zotit. Të qenët besimtar në Zotin, kërkon kohë, mund, sakrificë dhe dëshirë.

Ditët e sodit, ka shumë muslimanë që mendojnë se besimi mund të praktikohet vetëm duke dëgjuar kohë pas kohe një ligjëratë fetare apo duke prezantuar në faljen e xhumasë atëherë kur nuk ka ndonjë pengesë për të mos shkuar. Ky besim nuk e çon njeriun në Xhenet. Xheneti kërkon punë dhe përpjekje të madha. Një hoxhë i ndjerë në qytetin tim shpesh thoshte:

“Prej krevati nuk shkohet në Xhenet”.

Prandaj, nëse e ndjen veten besimtar apo dëshiron të jesh në grupin e tyre, atëherë dije o njeri, se ti duhet të kesh vizionin tënd, ndjenjat, ambiciet, qëllimet, mjetet, frikët dhe shpresat e tua. Kjo nuk arrihet menjëherë, por duhet t'i dedikosh një kohë relativisht të konsiderueshme besimit tënd, duke pasur njëkohësisht një dëshirë të flaktë për ta arritur kulmin e besimit. Pra, dije, mbret apo rob besimtar qofsh, pleqëria dhe vdekja përsëri do të të kaplojnë! Aspiro në jetë, por në fund, suksesin tënd mos ia dediko vetes, sepse ajo të bën kryelartë, por dedikoj Allahut xh.sh., Atij që të mundësoi të arrish në këtë pedestal të lartë.

“PASHA KOHËN!”

Allahu i Lartmadhëruar nuk betohet në diçka që nuk ka vlerë, përkundrazi, betohet në krijesat e posaçme të Tij, si për shembull: në Meken, në Turi Sina-në, në fikun dhe në ullirin që simbolizojnë Kudusin, etj.. Njerëzit, për të gjitha këto kenë njohuri të detajuara shkencore të marra nga studimet, hulumtimet, vrojtimet etj., të cilat vërtetojnë esencën dhe dobinë e tyre. Por Allahu xh.sh., mes tjerash, betohet edhe në një krijesë të veçantë të cilën e titullon “kohë”, por në këtë rast njerëzit s’mund ta kuptojnë tërësisht krijimin dhe esencën e saj, pavarësisht se janë munduar të japin shumë sqarime.

Koha është dëshmitarja e heshtur e të gjitha ngjarjeve botërore. Koha ka dëshmuar për krijimet fillestare, krijimin e njeriut, dëbimin e djajve dhe xhinëve, ndodhitë peygamberike në krye me ardhjen e profetit fisnik, Muhamedi a.s., katastrofat natyrore gjatë shekujve si: vërshimet, tërmetet, cunamet, vullkanet, furtunat etj., ardhjen e faraonëve, nemrudëve, fashistëve, nacistëve, sionistëve, titistëve, enveristëve, globalistëve, modernistëve, etj. Pavarësisht se të gjithë njëzëri themi se koha është një dëshmitare e heshtur, por të mos harrojnë të shtojmë se një ditë ajo do të ketë gjuhë me të cilën do të flasë zëshëm, dhe kjo ditë është Dita e Gjykimit.

Tani, le t’i referohemi sures që titullohet ashtu si edhe vetë tema jonë, “Koha”. Për rëndësinë e kësaj sureje imam Shafiu r.a. ka thënë:

“Do të ishte e mjaftueshme për njerëzimin të kuptojë vetëm këtë kapitë dhe t’i praktikonte urdhrat e saj.”

Allahu xh.sh. në Kur’an thotë:

“Pasha Kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të

mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm¹¹⁰.

Imam Raziu, duke komentuar suren e Kohës, thotë:

“Është betuar Allahu në Asr e cila është "koha" sepse në të ka gjëra të çuditshme, për arsye se në të njeriu gëzohet, zhgënjehet, sëmuret, shërohet, fiton dhe humb pasurinë, në jetë nuk ka asgjë më të shtrenjtë se koha. Sikur t'i kaloje një mijë vjet në gjëra të kota, pastaj të pendoheshe dhe ta arrije lumturinë në momentet e fundit, do të jesh në Xhenet përgjithmonë, atëherë e kupton se momentet më të mira të jetës tënde ishin ato momente, dhe koha ishte prej dhuntive më të mëdha, prandaj është betuar edhe Allahu në të. Dita e nata janë dy shanse që njeriu i humb. Këtu kupton se koha ka më shumë vlerë se vendi, për shkak se Allahu është betuar në të. Arsye tjetër pse koha është dhunti është fakti se ajo nuk ka të meta, por me të meta është ai që humb atë.”

Pasi Allahu xh.sh. betohet në kohën, më tej e përmend njeriun, me ç' rast të shtyn me kureshtje të pyesësh “Ku është lidhja mes kohës dhe njeriut?”. Dijetari Hasan el Basri ka thënë:

“Çdo ditë që kalon, merr diçka (të çmuar) nga ne, një pjesë tonën!”.

Pra, sikur ka dashur të thotë “koha jemi ne, njerëzit”.

Ibnu Kajim el xhevziu, thotë:

“Njeriu i ditur është i biri i kohës, në qoftë se e humb, i humbin të gjitha të mirat, sepse pikënisja e të gjitha të mirave është koha, në qoftë se e humb kohën, nuk do ta arrijë atë asnjëherë më.”

Cila kohë konsiderohet humbje e sigurt?

Koha llogaritet e humbur kur prej saj nuk kemi asnjë dobi. Një natë, në televizion shikoja me vëmendje një dokumentar i cili tregonte profilin e fizikanit më inteligjent në botë, fillimisht, kur

tregonin të arriturat dhe sukseset e tij në fizikë, fillova ta admiroj, por aty kah fundi thanë se mes tjerash ky dijetar vërtetonte “teorinë e evolucionit” dhe njëkohësisht mohonte ekzistencën e Zotit. Në atë moment, në sytë e mi ky ishte njeriut më injorant në botë dhe kuptova se kam humbur gati një orë kohë të çmuar duke e shikuar atë, pasi Allahu xh.sh. për ta ka vulosur në Kur’anin Famëlartë:

“Thuaj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre? Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre as takimin (ringjalljen) me Të, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t'u japim kurrfarë vlere.”¹¹¹

Koha për njeriun është pasuria më e çmuar, derisa është gjallë duhet ta shfrytëzojë. Ai është i lirë ta zgjedh formën e harxhimit apo menaxhimit të saj: ose duke bërë qejfe dhe ahengje nëpër klube, pabe e disko, ose duke e shfrytëzuar për dobi individuale, familjare dhe kolektive, duke medituar rreth krijesave të Zotit, rreth vetes së tij, me të vetmin qëllim që ta njohë Zotin dhe ta kënaq Atë.

Koha ka disa dukuri, mes tyre mund të veçojmë se:

“Koha ecën shpejt”;

Koha noton natyrshëm, por në bazë të situatave dhe rrethanave personale, ajo duket se ngadalësohet apo përshpejtohet. Në ditët e festave, gëzimeve, ahengjeve, përvjetorëve e pushimeve, ajo ecën shumë shpejt, kurse në ditët e pikëllimit, dëshpërimit e dënimit ecën shumë ngadalë. Po marr disa shembuj: rruga për të shkuar në SHBA, për ta takuar tim vëlla, të cilin s’e kisha parë trembëdhjetë vite, më erdhi sikur kaloi sa hap e mbyll sytë, kurse rruga e njëjtë, gjatë kthimit mu bë sikur zgjati me muaj. Të burgosurve, dita u duket sikur

¹¹¹ Kur’an, Sure Kehf: 103-105

nuk përfundon asnjëherë, kurse për gardianët është një ditë e zakonshme pune në burg. Koha gjatë ceremonisë martesore, për dasmorët kalon shpejt, por jo edhe për kamerierët dhe punonjësit e hotelierisë, e kështu me radhë;

Shfrytëzo shanset e mira që të ofrohen në jetë dhe mos nguro!

Amerikanët përdorin një thënie popullore “koha është para”, në sajë të kësaj thënie ata vërsulen pas parasë, dhe si rezultat i kësaj, SHBA-ja është shteti me standard më të lartë jetese në botë, pra, ata e shfrytëzojnë kohën maksimalisht për të punuar, organizojnë oraret dhe u përmbahen atyre, shfrytëzojnë çdo shans dhe mundësi që u jepet në jetë, dhe nuk ngurojnë. Të njëjtin pasion duhet ta kemi edhe ne muslimanët, kuptohet, jo vetëm për aspektin material, por edhe për atë shpirtëror, të garojmë për vepra të mira dhe angazhime kolektive për të mirë të shoqërisë dhe fesë. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Shfrytëzoni pesë gjëra para se të vijnë pesë të tjera: rininë para se t’ju kaplojë pleqëria; kohën e lirë para se të angazhoheni me punë; pasurinë para se të varfëroheni; shëndetin para se të sëmureni dhe jetën para se të vdisni!”¹¹²

Përsëri do të huazoj një thënie të dijetarit Hasan el Basri, i cili ka thënë:

Çdo ditë që agon dielli, ajo thotë: “O biri i Ademit, unë jam dita e re, por jam edhe dëshmitare e veprave tua, prandaj shfrytëzomë mua sepse unë nuk do të kthehem te ti deri në Ditën e Gjykimit”.

Kurse në një thënie të urtë thuhet:

“Secilit në jetë i ofrohet një mundësi e mirë, por ai duke pritur rastin ideal, prolongon shansin që i ka ardhur, kështu koha ia vjedh edhe këtë rast të dhënë, sepse detyra e kohës është që t’i merr me vete ato.”

Për ta përforcuar edhe më shumë këtë që sapo thamë, Imam Shafiu ka thënë: “I kam shoqëruar sufijët dhe nuk kam përfituar asgjë

¹¹² Transmetohet nga Abdullah Ibn Abbasi

prej tyre, me përjashtim të dy fjalive: “koha është si shpata, në qoftë se nuk e pret, të pret”, e dyta: “shpirtin tënd, në qoftë se nuk e angazhon në punë të mira, do ta angazhosh në punë të liga”.

Në historinë Islame tregohet vullneti i pavdekshëm i Ebu Jusufi, nxënësit të Ebu Hanifes, edhe pse ndodhej në momentet e fundit të jetës së tij. Ibrahim bin Xherrah thotë:

“E kam vizituar Ebu Jusufin, e atij i ishte humbur vetëdija, por pasi u kthjellua pak, më tha: “Çka thua për këtë çështje (për një nga çështjet e Islamit)?” Ia ktheva: “Po edhe në këtë gjendje kujdesesh për çështjet fetare?”. Ai u përgjigj: “Do të mësojmë sepse ndoshta dikush ka dobi prej saj.”;

Koha që kalon nuk kthehet pas!

Njerëzit çdoherë e qajnë kohën që ka kaluar, dikush me nostalgji e kujton të kaluarën, e dikush tjetër është penduar pse e ka bërë ashtu dhe s’e ka bërë kështu, por të gjithë janë të vetëdijshëm se ajo kohë nuk kthehet më, zaten edhe nëse kthehej, shumë prej tyre do ta kishin vepruar të njëjtën gjë. Zoti xh.sh., dështimin më të madh të njeriut në këtë jetë, që është mosbesimi dhe arroganca, e paralajmëron në këtë pjesë nga Kur’ani:

"Dhe ata do të klithin aty: "O Zoti ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!" Po a nuk u dhamë juve jetë aq saqë ai që ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe pejegamberi, pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar"¹¹³.

Allahu xh.sh. njeriun nuk dëshironte ta le në humbje të sigurt, por e mësoi se si ta shfrytëzojë kohën. Sa herë që koha tenton t’i kalojë kot, ia kujtojnë paralajmëruesit e kohës, të cilët janë: ajetet e Kur’anit të Shenjtë, thëniet profetike dhe shenjat e pleqërisë në trupin e tij.

¹¹³ Kur’an, Sure Fatir: 37

Do ta përfundoj këtë ligjëratë me historinë e Omerit r.a., i cili pasi u zgjodh udhëheqës i muslimanëve, punësoi një person që vazhdimisht t'ia kujtonte frikën e Allahut. Pas shumë viteve, Omeri r.a. e thërret personin e punësuar dhe i thotë se prej asaj dite ai më nuk kishte nevojë për shërbimin e tij. Shërbyesi i tha:

“O prijës i besimtarëve, a nuk i frikësohesh më Zotit?”

Omeri r.a. ia ktheu:

“I frikësohem më shumë se çdo herë, por tashmë unë kam paralajmërues të rinj, ato janë thinjat që më kanë dalë në kokë dhe në mjekër.”

PËRMENDE ALLAHUT QË EDHE AI TË TË PËRMENDË TY!

Shpeshherë na ndodh në jetën e përditshme që ta përmendim Zotit për të mirat që na i ka dhënë, për mirësitë e pakontestueshme dhe për qetësinë shpirtërore. Ka raste kur njeriu me të padrejtë hidhërohet me Zotin, për sprovat që e kaplojnë atë dhe familjen e tij, këto sprova mund të jenë materiale dhe shpirtërore. Hidhërimi mund t'i kalojë edhe në mohim, por pastaj, sa e kalon atë sprovë, kupton se ka bërë gabim të madh që padrejtësisht e ka akuzuar Zotin për një sprovë kalimtare, prandaj pendohet. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta, e edhe nga frytet, po ti jepu myzhde durimtarëve!”¹¹⁴

Allahu xh.sh. e ka dhënë edhe të mirën edhe sprovën, edhe pse ne mund të na duket si e keqe. Disa herë, brenda të njëjtit njeri paraqitet edhe gëzimi edhe hidhërimi karshi Zotit të gjithësisë. Në fillim Allahu xh.sh. e shpërblen, e pastaj e sprovon. Në këtë aspekt, dallimi mes besimtarëve dhe njerëzve të luhatur në fe, apo të atyre që nuk besojnë, është shumë i madh. Sa i takon këtyre të fundit, gjendjen e tyre e përshkruan Allahu në Kur'an:

“Njeriu është i prirë që të jetë i paduruar. Kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Por kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt

¹¹⁴ Kur'an, Sure Bekare: 155

në faljen e namazit, të cilët nga pasuria ndajnë një pjesë të caktuar për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp¹¹⁵.

Kurse gjendjen e besimtarëve e përshkruan Muhamedi a.s.:

*“Çështja e besimtarit është e habitshme. Në fakt e gjithë çështja e tij është mirësi. Kjo i ndodh vetëm besimtarit. Nëse i vjen një e mirë, ai falënderon dhe kjo është mirë për të. Nëse e godet një e keqe, ai duron dhe kështu është mirë për të.”*¹¹⁶

Përmendja e Allahut xh.sh. në çdo vend është e mirëseardhur, por nëse Allahu xh.sh. nuk përmendet në Shtëpinë e Tij, pra në xhami, ajo konsiderohet si diçka shumë e vogël në krahasim me mëshirën dhe bereqetin që Ai i ka dhënë njerëzimit. Kur dikush të ka ndihmuar në ndonjë hall të madh, ose të ka dhënë disa të holla borxh, si mendon, si bëhet më mirë, nëse i thua vetëm faleminderit në rrugë kur e takon rastësisht, apo nëse shkon në shtëpi enkas për t’iu falënderuar dhe pini bashkërisht një kafe? Islami dhe muslimanët, për dallim nga religionet dhe popujt e tjerë, ne adhurimet drejtuar Allahut xh.sh. mund t’i bëjnë në çdo vend dhe hapësirë, kurse të tjerët i bëjnë vetëm në kultet e tyre fetare. Profeti i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë:

*“Më janë dhënë pesë veçori të cilat nuk i janë dhënë asnjë Profeti para meje: Jam ndihmuar me frikën e armikut në largësi një muaj, toka më është bërë xhami (vend-falje) dhe e pastër, prandaj çdo besimtarë kudo që e zë namazi le ta falë atë (në këtë tokë), më është lejuar plaçka e luftës e cila nuk i ishte lejuar askujt para meje, më është dhënë ndërmjetësimi (shefati) dhe çdo Profet është dërguar vetëm tek populli i tij, kurse unë jam dërguar për mbarë njerëzimin”*¹¹⁷.

Njeriu shpesh e keqkupton këtë mirësi dhe mëshirë të Zotit, mendon se vetëm me një të përmendur të Zotit e ka kryer borxhin

¹¹⁵ Kur’an, Sure Mearixh: 19-25

¹¹⁶ Transmeton Suhejb ibn Sinan

¹¹⁷ Transmeton Xhabir ibn Abdullah

ndaj mirësive të Tij. Ai shpeshherë thotë: “Shyqyr Zotit! Faleminderit Zotit! etj.”, por kur shpëton nga e keqja thotë: “Më shpëtoi sadakaja!”, “Paskam qenë i drejtë!” etj. Me kaq mendon se ka shpëtuar nga detyrimet islame. Të njëjtit, nëse i thuash që pas kësaj sprove të rëndë duhet t’i kthehesh rrugës së Zotit dhe të prezantosh në xhami për të fal namazin, ai menjëherë tërhiqet gjoja se është tepër i angazhuar me punë. Është për t’u habitur me mirësinë e Zotit tonë, ne e përmendim Atë për hallet tona, kurse Ai për këtë përmendje na shpërblen në dy botët.

Cili është shpërblimi i përmendjes së Zotit?

Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë thotë:

“Pra, ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shpërblime). Më falënderoni e mos Më mohoni!”¹¹⁸

Kujtimi dhe mburrja e Allahut në prezencë të engjëjve më të lartë është një nga shpërblimet më të veçanta për atë që e përmend Zotin, Ky është vetëm fillimi i shpërblimeve nga Zoti, sepse Ai për perkujtuesin e Vet ka përgatitur shumë shpërblime në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

¹¹⁸ Kur’an, Sure Bekare: 152

VLERA E KONSULTIMIT NË ISLAM

Sot bota është bërë shumë e ndërlikuar dhe e vështirë për të jetuar, sepse është humbur besimi te njëri-tjetri dhe njerëzit i shohin të tjerët me rezervë, nuk kanë kujt t'ia besojnë fjalën, pasurinë, sekretet, bile edhe planet apo projektet e ardhshme. Duke u mbyllur secili në vetvete, nuk jenë të vetëdijsëm se cilat janë opinionet e masës së gjerë për vendimet e tyre. Një fjalë e urtë thotë:

“Kush konsultohet me një njeri të urtë, huazon mendjen e tij”!

Nuk ka qarkulluar rastësisht në popull fjala:

“Pyet njëqind vetë dhe bëj siç di vetë!”

Sot njerëzit nuk pyesin askënd, as edhe familjen dhe miqtë e vet. Sot njerëzit nuk pyesin si do ta bëjmë, por pasi e kanë bërë vetë, qetësojnë veten duke pyetur tjerët “Si e kam bërë?” dhe të tjerët duke ditur se opinion i tyre nuk ka më asnjë peshë, nuk duan të prishin raporte me të, dhe vetëm i thonë “Më mirë s’ka ku shkon!”. Ju mund të fitoni pesëdhjetë vite eksperiencë nga dikush me përvojë jetësore më të madhe se ju vetëm duke e pyetur atë me mirësjellje: “Çka mendoni ju për këtë çështje?” Prandaj, boshti kryesor i këtij punimi është pikërisht konsultimi dhe mirësjellja gjatë këshillës vëllazërore. Allahu xh.sh. i drejtohet profetit Muhamed a.s., por njëkohësisht edhe gjithë besimtarëve, me këto fjalë:

“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërdheshin prej teje, andaj ti falu atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të

vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten¹¹⁹.

Kur zbriti ky ajet, konkretisht pjesa **“konsultohu me ta në të gjitha çështjet”**, profeti Muhamed a.s. tha:

*“Allahu dhe profeti i Tij s’kanë nevojë për konsultim, por Allahu zbriti këtë ajet si mëshirë për umetin tim, prandaj kushdo që konsultohet me të tjerët, asnjëherë nuk do t’i mungojë arsyeja, dhe secili që përmbahet nga konsultimi (nuk konsultohet) do të devijojë nga e duhura*¹²⁰.

Muhamedi a.s. ishte njeriu më i ditur në rruzullin tokësor, njëkohësisht edhe njeriu më me ndikim në botë, sepse mësimet i merrte nëpërmjet Xhibrilit a.s., prej vetë Allahut xh.sh.. Ai ishte më i miri i djemve të Ademit a.s., dhe kishte privilegje të larta te Zoti. Për ta vërtetuar këtë që thashë, ju kujtoj udhëtimin e Muhamedit a.s. në Isra dhe në Miraxh. Kur Profeti hyri në xhaminë e Aksasë, në Palestinë, aty i gjeti të gjithë vëllezërit e tij, pejgamberët, prej te Ademi a.s. e deri te Isai a.s., dhe në çastin final të faljes së namazit, edhe pse ishte vëllai më i vogël i trungut profetik, Xhibrili a.s. e urdhëroi atë që t’u prijë imam të gjithë profetëve. Pra, ky njeri nuk kishte nevojë të konsultohet me askënd, sepse urdhrat i vinin prej Zotit, por parashtrohet pyetja, nëse ai nga modestia këshillohej me shokët, atëherë cilat janë urtësitë e konsultimit?

Me konsultim do të qetësoni veten!

Nëse dëshironi të merrni një vendim, por s’jeni të sigurt se çka do të mendojë opinioni i gjerë rreth atij vendimi, atëherë e keni patjetër që të konsultoheni me familjen dhe shokët e tu, pastaj kur ata do t’jua japin opinionin e njëjtë me tuajin, ju do të fitoni forcë dhe kurajë më të madhe për realizimin e atij vendimi, dhe assesi nuk keni pse luhateni. Kur Muhamedi a.s. u ballafaqua për herë të parë me melekun Xhibril a.s. në shpellën Hira, kur i erdhi shpallja kur’anore, u

¹¹⁹ Kur’an, Sure Ali Imran: 159

¹²⁰ Transmeton Ibn Udaji dhe Bejhekiu

frikësua tej mase, kështu që, u kthye me shpejtësi në shtëpi që të mbulohet, por pasi u qetësua, konsultimi me Hatixhen r.a. i dha atij mbështetje, kurajë dhe forcë që ta përballojë këtë sfidë në të ardhmen.

Me konsultim do t'i qetësoni dhe do t'i zbutni edhe zemrat e atyre që konsultoheni!

Konsultimi është mëshirë dhe lidhje që krijohet mes dy personave të cilët ndihmojnë me këshilla të sinqerta njëri-tjetrit. Kur kryetari, punëdhënësi, menaxheri, drejtori apo koordinatori i një grupi urdhëron ndonjërin prej puntorëve apo pjesëtarëve të ekipit të bëjë diçka pa ia sqaruar atij arsyen e veprimit, apo pa u konsultuar me të, ai do të ndjehet si vegël në duart e tyre. Në anën tjetër, nëse paraprakisht ata organizojnë një mbledhje për t'u konsultuar, kjo i bën ata të ndjehet si bashkëpunëtorë apo partnerë në atë detyrë.

Muhamedi a.s. vazhdimisht konsultohet me shokët. Transmeton Shafiu nga Ebu Hurejreja r.a., i cili thoshte:

“Nuk kam parë ndonjë njeri më të etur për konsultime me shokët sesa Muhamedi a.s.”.

Profeti Muhamed a.s. konsultohet me shumë sahabë, por më shumë konsultohet me Ebu Bekrin dhe Omerin r.a., saqë ai shpeshherë u thoshte: *“Nëse ju (Ebu Bekër dhe Omer) pajtoheni në diçka, unë nuk do t'ju kundërshtoj”*¹²¹.

Përveç shokëve, ai konsultohet edhe me bashkëshortet e tij, siç ishte rasti në marrëveshjen e Hudejbisë, ku Muhamedi a.s. u konsultua me njërën nga bashkëshortet dhe e mbështeti mendimin e saj që i pari ai të heq ihramin dhe të pres kurbanin në kohën kur sahabët hezitonin ta bënin këtë veprim sepse ishin irituar prej rezultatit (sipas tyre) “negativ” të marveshjes së Hudejbijes, por kur panë Muhamedin a.s. të vepron ashtu ju zbut atyre zemra dhe

¹²¹ Transmeton Ahmedi nga Ebu Bekri dhe Umeri r.a.

vepruan si ai. Nëse Profeti Muhamed a.s. konsultohet me familjen dhe shokët, edhe pse nuk kishte nevojë, por e bënte këtë që t'i qetësojë zemrat e shokëve dhe të gëzojë mbështetje të fuqishme në rrugën e Allahut xh.sh., atëherë parashtrohet pyetja: “Sa ne konsultohemi me familjen dhe shokët tanë?”, sepse për dallim nga profeti, ne gabojmë dhe jemi shumë të nevojtarë për këshilla. Pse vallë kur duhet të marrim vendime nuk shqyrtojmë edhe opinionet e njerëzve rreth nesh? Allahu xh.sh., kur na urdhëron diçka në Kur'an, na tregon urtësinë e saj. Zoti kishte mundësi të na thotë: “Agjëroni pse Unë dua!”, por Ai tha: “Agjëroni që të bëheni të devotshëm!”. Po ashtu, kishte mundësi të na thotë vetëm “faluni pse Unë dua!”, por tha “faluni që namazi tu largon nga punët e shëmtuara dhe të neveritura!” Ekzistonte mundësia të na vetëm të na urdhërojnë me zeqat, por tha “jepni që t'ju pastrohet pasuria!”, e kështu me radhë. Allahu xh.sh., Muhamedin a.s. e bëri shëmbëlltyrë të gjallë të të gjitha dispozitave kur'anore, ashtu që, kur e pyetën Aishen r.a. se çka ishte Muhamedi a.s., ajo u përgjigj:

“Muhamedi a.s. ishte Kur'an që ecte”.

Tani do t'u referohemi dy rasteve unike nga jeta profetike e Muhamedit a.s., të cilat në shikim të parë duken si “harresë” apo “gjykim jo i drejtë”, por në realitet, urtësia e të dy shembujve është jetësimi praktik i dispozitave konkrete islame përmes jetës së Muhamedit a.s. dhe vlera e konsultimit në Islam.

Një nga mrekullitë që Allahu xh.sh. ia dhuroi Muhamedit a.s. ishte aftësia për t'i nxënë menjëherë të gjitha ajetet kuranore, kurse me rastin e faljes së namazit, ai çdoherë këshillohej me Xhibrilin a.s., por Allahu xh.sh. përveç kësaj thotë edhe diçka tjetër në Kur'an:

“Ne do ta lexojmë ty e nuk do të harrosh (Kur'anin). Përveç asaj që All-llahu dëshiron. Ai e di të hapëtën e të fshehtë”¹²².

¹²² Kur'an, Sure A'la: 6-7

Një ditë, Muhamedi a.s. duke u falur , në vend të katër reqateve namaz, ai fali vetëm dy reqate, por Xhibrili kësaj here nuk erdhi që ta korrigjojë, andaj një nga sahabët që e vërejti këtë lëshim të Profetit, e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut, a e shkurtove namazin me urdhër të Allahut xh.sh. apo harrove një pjesë të tij?” Profeti a.s. iu përgjigj: “As nuk e shkurtova, as që jam në dijeni se kam lënë diçka mangët prej tij?” Ai ia ktheu: “Po, i Dërguar i Allahut, i harrove dy reqate.” Pastaj Profeti i pyeti njerëzit që ishin të pranishëm, por dhe ata i konfirmuan atij gjithashtu se kishte falur vetëm dy reqate...”¹²³.

Profeti kishte mundësi ta pyesë vetë Xhibrilin a.s. dhe ai t’ia konfirmonte gjendjen faktike, por Muhamedi a.s. zgjodhi t’i pyesë shokët që të mos i neglizhojë sepse ata ishin vetë dëshmitarë. Si rezultat i kësaj historie, dijetarët islamë vijnë në përfundim se nëse Profeti a.s. nuk do të kishte bërë këtë lëshim, atëherë nuk do të kishte zbritur dispozita e Sehvi Sexhdes¹²⁴.

Rasti i dytë është në Luftën e Bedrit. Allahu nuk e udhëzoi Muhamedin a.s. se ku do ta poziciononte ushtrinë, pavarësisht se kjo ishte një luftë vendimtare për muslimanët dhe për fenë e Allahut xh.sh. Muhamedi a.s. nga vlerësimet dhe bindjet e veta vendosi që ushtria muslimane të pozicionohet në një pikë të caktuar. Një nga shokët e tij e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut, të inspiroi Allahu që të zgjedhësh këtë vend apo është vlerësimi yt personal nga strategjia ushtarake dhe nga produkti i konsultimit?”,-“Është thjesht mendimi im personal dhe nuk jam urdhëruar prej Zotit!”, u përgjigj Muhamedi a.s.. “Atëherë, unë mendoj se ky vend nuk është i përshtatshëm!”, ia ktheu sahabiu. - Profeti a.s. duke mos u ofenduar nga reagimi i tij, e pyeti: “Po ku mendon se është vendi më i përshtatshëm?” Sahabiu spikati vendin

¹²³ Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

¹²⁴ Përmisimi i namazit në uljen e fundit me dy sexhde në raste të haresës

*më të mirë për t'u pozicionuar, kurse Muhamedi a.s. e aprovoi planin e tij dhe e zhvendosi ushtrinë në atë pozicion*¹²⁵.

Nga forma e parashtrimit të pyetjes, nënkuptohet se, sikur të kishte thënë Muhamedi a.s. se ai pozicionim ishte rezultat i shpalljes nga Allahu xh.sh., sahabiu s'do të kishte reaguar asnjëherë, por do t'i ishte bindur urdhrit të Allahut xh.sh..

Disa mendojnë se nuk është me rëndësi se prej kujt e merr këshillën, mjafton që ajo të jetë e dobishme dhe e sigurtë. Sot konsultimi është shndërruar profesion në vete, ku konsultanti jep këshilla profesionale në sfera të veçanta: siguri, menaxhment, kontabilitet, resurse njerëzore, marketing, marrëdhënie me publikun etj., madje çdo person publik apo juridik ka një ose më shumë këshilltarë që kujdesen për imazhin e tij apo të kompanisë. Muhamedi a.s. ka vendosur vetëm një kusht për konsultimin, ai thotë: *“Kërkuesi i këshillës është kërkues (nevojtar) ndihme, prandaj konsultanti duhet të jetë i besueshëm, kështu që, kur kërkohet prej jush konsultim, konsultohuni me të njëjtin mendim sikur konsultoheni për veten tuaj!”*¹²⁶

Ta ilustrojmë këtë me një shembull konkret: nëse ndonjë shok kërkon mendimin tuaj në lidhje me ndonjë djalë që ka kërkuar dorën e vajzës së tij për grua, dhe ai mes tjerash të thotë:

“Për hir të Zotit, kërkoj të më tregosh të vërtetën, A do ta pranoje për dhëndër nëse ai do të kishte kërkuar dorën e vajzës suaj?”

Atëherë, nëse s'do ta kishte pranuar atë për dhëndër, fillimisht duhej t'ia tregosh të vërtetën shokut tënd.

Këshilltari, nuk mjafton që të jetë vetëm i besueshëm, por gjithashtu duhet të jetë edhe ekspert i fushës përkatëse. Nëse do të ishte vetëm ekspert dhe jo i besueshëm, ai do të kishte konflikt

¹²⁵ Transmeton Ibn Ishaku, libri: The life of prophet Muhammad Ibn Kathir al-Sirah al-Nabawiyyah, volume 2 faqe 267, përkthyer nga Trevor Le Gassick, UK, 1998

¹²⁶ Transmeton Kashf El Hafa'a nga Ajsheja r.a.

interesi dhe do të fshihte diçka prej teje, kurse nëse do të ishte vetëm i besueshëm dhe jo ekspert, atëherë do të jepte opinione të gabueshme nga injoranca. Në fund, besimtari duhet të jetë transparent karshi këshillave, dëgjues i mirë i këshillave, s'duhet ta konsiderojë personin që e këshillon një person që ka kaluar kufijtë, por duhet ta falënderojë atë dhe gjithë jetën ta respektojë si person që është kujdesur për të. Do ta përfundojmë këtë ligjëratë me fjalët që Omeri r.a. i thoshte shpesh:

“Personin që e dua më shumë është ai që me sugjeron apo kritikon më shumë.”

FRIKA NDAJ ALLAHUT NË PRIVATËSI DHE NË PUBLIK

Ka shumë njerëz që publikisht shtiren se janë shumë të përkushtuar në fe, kurse në realitet ata nuk frikësohen prej Allahut kur janë vetëm. Njeriu është i krijuar me një karakter të tillë që kur takohet me ndonjë person të rëndësishëm, të pasur apo të ditur, e ndryshon sjelljen dhe tregohet më i sjellshëm, më i kujdesshëm, i matën fjalët më shumë, vishet mirë, parfumohet etj., pra, të gjitha këto i bën me qëllim që të le përshtypje të mirë para tij. Ose rasti kur vjen një vizitor në shtëpi, ose ti shkon vizitor diku, ti je i kujdesshëm që të mos e provokosh, nervozosh, je i përqendruar në bisedë me vizitorin etj. Më ka ndodhur të takoj në rrugë apo në taksi rastësisht shumë njerëz që i bëjnë të gjitha të zezat, por para meje (duke e ditur se jam hoxhë) kanë rënë në *shehadet* dhe më kanë dhënë përshtypje se janë besimtarë të fortë. Raste të tilla, me siguri keni hasur edhe ju.

Nëse sjellja e njeriut ndaj njeriut është e tillë, atëherë paramendoni në çfarë niveli duhet të jetë sjellja, edukata dhe përqendrimi i njeriut ndaj Allahut xh.sh.

Një gjë nuk duhet ta anashkalojmë: një person që është pa edukatë dhe nuk sillet mirë me të tjerët, ai gjithsesi është i pamoralshëm edhe në raport me Zotin. Muhamedi a.s. ka thënë:

*“Ndër ato fjalë që kanë arritur te njerëzit nga fjalët e profetëve të mëparshëm është edhe kjo: Në qoftë se nuk keni turp, atëherë bëni çdo gjë që dëshironi”*¹²⁷

¹²⁷ Transmeton Buhariu nga Ibn Mes’udi r.a.

Me këtë sikur do të na thotë: “Nëse s’keni turp, nuk jeni prej nesh.”

Pejgamberi në dy raste tjera ka thënë:

“Vërtetë, çdo fe ka moral ndërsa morali i Islamit është turpi”¹²⁸ dhe “besimi është i ndarë në shtatëdhjetë e ca degë ndërsa turpi është një prej degëve të besimit.”¹²⁹

Një besimtar ishte pronar i një fabrike, përpiquej që të gjithë punëtorët t’i zgjedhë të moralshëm. Dikur i duhej një punëtor i ri dhe nxori një konkurs për punësim. Në fillim të intervistës, një nga konkurrentët për punë i la përshtypje të mirë dhe e punësoi. Ditën e parë të punës, pas një pune të lodhshme, të gjithë futen në banjë publike që të bëjnë një dush. Të gjithë ishin me pantallona të shkurta, përveç punëtorit të ri, ai lahej lakuriq. Kur e mori vesh pronari, e lëshoi nga puna dhe i tha: “Merri të hollat për ditën e sotme dhe nuk kemi nevojë më për ty!” Sot veprime të tilla ndodhin ditë e përditë, saqë gati në të gjitha sallat sportive apo banjat publike ka disa të rinj dhe të moshuar që lahen në publik lakuriq. Kam parë njerëz në Qabe dhe në Arafat të cilët qeshin me të madhe, lozin, flasin dhe përgojnë. Kam dëgjuar për gra me mbulesa (hixhabe) që kanë hequr mbulesat sa kanë hipur në aeroplan. Këto harrojnë se Allahu xh.sh. i sheh dhe i di veprimet dhe qëllimet e tyre. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Më e mira e fesë është të dish se Allahu është me ty në çdo vend dhe situatë”¹³⁰.

Isa a.s. u tha havarijunëve (shokëve të vet):

“O shokët e mi, flisni me Allahun xh.sh. më shumë se sa u flisni njerëzve!” Ata i thanë:

“O profet, si mund ta arrijmë këtë?”

¹²⁸ Transmeton Ibni Maxhe

¹²⁹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

¹³⁰ Transmeton Taberani

Isa u përgjigj:

“Lutuni vazhdimisht dhe bëni biseda sekrete me Të!”

Zoti xh.sh. foli me Musain a.s. dhe i tha:

“O Musa! A dëshiron që Unë të jem miku yt?”

Musa a.s. ia ktheu:

“E si mund të arrihet kjo, o Zot?”

Allahu xh.sh. i tha:

“Unë jam miku i atij që më përmendë Mua dhe pastaj më gjen atje ku më kërkon”.

Këtë ligjeratë do ta përfundoj me një shembull të dobishëm:

Një njeri shkoi te dijetari i quajtur Ibrahim Ed’hem dhe i tha:

“Ndihmomë, o rob i Zotit! Kam dëshira dhe epshe që s’mund t’i kontrolloj. Tregomë se si t’i mbuloj dhe t’i fsheh këto mëkate para Zotit?!”

Ibrahim Ed’hemi i tha: “Këtë mund ta bësh nëse i plotëson këto pesë kushte:

mos ha nga ajo që Allahu ofron; mos qëndro në pronën e Tij; për ta bërë mëkatin, gjeje një vend që Ai s’mund të të shikojë; kur të të vijë meleku i vdekjes, lute të ta shtyjë afatin; dhe kur të të vijnë engjëjt e zjarrit për të të futur në Xhehenem, mos iu bind atyre!”

Njeriu, kur i dëgjoji këto, iu përgjigj:

“Çka po thua, ku ka furnizim tjetër pos atij të Zotit, ku ka pronë tjetër pos asaj të Zotit, ku ka vend të fshehtë që Ai s’e di, si mundet ta lus melekun kur ai nuk më bindet mua, por i bindet vetëm Zotit dhe ku kam forcë unë të mos u bindem engjëjve që do më fusin në zjarr?!”

Ibrahim Ed’hemi, atëherë i tha:

“Edhe unë s’mund të të ndihmoj për të shkelur kufijtë e Zotit.”

DIMENSIONE SHPIRTËRORE

Shpirti i njeriut është shpirt racional. Nuk themi që kafshët, shpezët dhe insektet nuk kanë shpirt, porse shpirti i tyre është joracional. Para profetësisë së Muhamedit a.s., bota kishte informacione të pakta dhe të paqarta në lidhje me shpirtin. Në një rast disa çifutë deshën ta provokojnë dhe ta vërtetojnë profetësinë e Muhamedit a.s. duke i bërë një pyetje në lidhje me shpirtin. Abdullah ibn Mes'udi transmeton se:

“Derisa isha duke ecur me Muhamedin a.s. në një lëndinë, ai u ndal të pushojë nën hijen e një palme dhe aty pranë kaluan disa çifutë. Njëri prej tyre u tha të tjerëve: “Pyeteni në lidhje me shpirtin!”. Një tjetër tha: “Çka ju shtyri të pyetni për të?”. Të tjerët thanë: “Mos e pyetni atë sepse mund t’u jep përgjigje që ju s’do t’ju pëlqejë”. Por pastaj ndërruan mendje dhe thanë: “Pyeteni!” Kështu që e pyetën. Profeti për një çast heshti dhe nuk u dha përgjigje, në atë çast unë e dija se atij i zbret shpallja, kështu që qëndrova në vend. Kur zbritja e shpalljes përfundoi, Profeti lexoi ajetin:

“Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: "Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.”¹³¹

Kur shpirti (ruhi), të cilin engjëlli e fryn në barkun e nënës (fetus), bashkohet me trupin, ai kthehet në ego (nefs), pastaj nën ndikim të trupit merr cilësi të caktuara, qofshin ato të mira apo të këqija, pra ose bëhet një shpirt i qetë dhe i kënaqur, ashtu siç thotë Allahu në Kur'an:

“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar! Hyn në turmën e robërve të Mi! Dhe hyn në Xhenetin Tim!”¹³²

ose do të jetë një epsh i prirë për të keqe, ashtu siç thotë Allahu xh.sh:

“Epshti është shumë nxitës për të keqen”¹³³.

Ashtu siç uji i jep jetë pemës, pastaj nga përzierja me pemën ai transformohet në diçka tjetër, p.sh.: ose bëhet lëng rrushi për ta pirë njerëzit ose verë që të dehën. Në këto raste ai nuk quhet më ujë, përveç në përdorime metaforike.

Allahu xh.sh. e krijoi dhe e përsosi qenien e parë fizike, mendore dhe shpirtërore, e cila do t'i sfidonte të gjitha krijesat e tjera. Ai për krijimin e Ademit a.s. tha:

“E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t'i japë atij shpirtin që është krijesë Imja atëherë ju bini atij në sexhede!”¹³⁴

Allahu xh.sh., gjithashtu kujdeset edhe për krijimet njerëzore në barqet e nënave deri në Ditën e Gjykimit. Allahu xh.sh është Ai që në ditën e njëqindënjëzet të shtatzënisë urdhëron melekun t'ia jep shpirtin fëmijës në barkun e nënës. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Secili prej jush qëndron në barkun e nënës në gjendje sperme për dyzet ditë. Më pas kthehet në copë gjaku dhe qëndron i tillë për dyzet ditë. Më pas kthehet në copë mishi dhe qëndron po aq i tillë. Më vonë dërgohet meleku i cili urdhërohet të shkruaj katër gjëra: shkruan rizkun, kohën e vdekjes, veprat dhe nëse do të jetë i lumtur apo i vuajtur dhe do i japë shpirtin”¹³⁵.

¹³² Kur'an, Sure Fexhr: 27-30

¹³³ Kur'an, Sure Jusuf: 52

¹³⁴ Kur'an, Sure Hixhr: 29

¹³⁵ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

Parashtrohet pyetja: "Me çka na dallon ne Allahu xh.sh. nga krijesat tjera dhe me çka na privilegjon?"

Këtë shumë mirë e tregon vetë Aliu r.a., i cili thotë: *"Engjëjt janë krijuar me mendje, pa pasur dëshira (nevoja), kafshët janë krijuar nga dëshira (nevoja), pa pasur mendje, kurse njeriu është krijuar me të dyja, me dëshira dhe me mendje."*

Kur Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s. i urdhëroi engjëjt bashkë me Iblisin (që ishte prej xhinëve), i cili deri atë kohë ishte besimtar i përkushtuar, t'i bëjnë sexhde njeriut të parë, ku të gjithë melekët ranë, përveç Iblisit, ai kundërshtoi dhe u bë kryelartë.

"(All-llahu) Tha: "Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?" Ai (Iblisi) tha: "Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!". (Allahu) Tha: "Zbrit nga ai (Xheneti), nuk të takon të bësh kryelartësi në të, dil jashtë, s'ka dyshim ti je i poshtëruar". (Iblisi) Tha: "Më afatizo gjer ditën kur ringjallen (njerëzit)!" (Allahu) Tha: "Ti je i afatizuar!" (Iblisi) Tha: "Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë"¹³⁶.

Iblisi u dëbua nga Xheneti dhe sipas tij fajtor ishte njeriu, ai tashmë jo vetëm që e xhelozonte atë, por edhe e urrente aq shumë, saqë kërkoi leje prej Allahut xh.sh. që ta afatizojë deri në ditën e gjykimit, që me cytjet e tij ta devijojë njeriun nga rruga e Allahut. Allahu xh.sh. ia mundësoi këtë sepse ishte i sigurt në përparësinë e njeriut (besimtarit) karshi djallit të mallkuar. Ky superioritet ka të bëjë me dimensionet e tij të brendshme.

Do të mundohem që në këtë ligjëratë të bëjë një analogji mes teorive psikologjike dhe atyre fetare në lidhje me dimensionet e brendshme të njeriut, të cilat ndikojnë në shpirtin e njeriut. Zigmond

Frojdi, një nga psikoanalistët më të shquar botëror, e shikon personalitetin njerëzor si një fushë beteje ku luftojnë **idi**¹³⁷, **egoja**¹³⁸ dhe **super-egoja**¹³⁹ të cilat maten për ndikim në karakterin e njeriut.

1. Atë që psikologjia e quan “idi” në mësimet islame quhet “efekt djallëzor” dhe ka lidhshmëri me premtimin e Iblisit dhe pasardhësve të tij, të cilët do t’i ndjekin njerëzit dhe do të mundohet t’i devijojnë nga Rruga e Vërtetë. Në bazë të kësaj, çdo njeri e ka një djall (shejtan) shoqërues, i cili çdoherë i qëndron pranë dhe i bën cytje atij, gjë të cilën e pohon edhe vetë i Dërguari i Zotit a.s. ku thotë:

*“Nuk ka asnjë nga ju përveçse i është përcaktuar shoqëruesi i tij nga xhindët (djajtë) dhe shoqëruesi i tij nga melekët”. Sahabët i thanë: “A edhe ty, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe mua, vetëmse All-llahu më ndihmoi kundër tij, kështu që ai e pranoi Islamin dhe nuk më urdhëron përveçse të bëj mirë”.*¹⁴⁰

Djalli e di çfarë njeriu ka në zemër, e sheh dhe e dëgjon atë që ai i thotë vetvetes. Për më shumë, djalli ka kontroll mbi zemrën e njeriut, dhe kur njeriu e kujton Allahun xh.sh., ai tërhiqet, kur njeriu

¹³⁷ Idi: një grumbull instinktesh epshore dhe agresive të përqendruara në pjesën e pa vetëdijshme të mendjes dhe vepron mbi bazën e parimit të kënaqësisë. Nuk njeh gjykime të vlerës, nuk njeh as të mirën as moralen.

¹³⁸ Egoja: një grup i funksioneve psikike si: gjykim, testimi i realitetit, kontrolli, planifikimi, mbrojtja, funksionimi intelektual, memoria, etj., që na ndihmojnë të organizojmë mendimet tona dhe t’u japim kuptim atyre në raport me botën përreth nesh.

¹³⁹ Super egoja: synon për përsosmëri dhe vepron mbi bazën e primeve morale, zhvillohet me anë të edukimit dhe sanksioneve të ndryshme që vendosin prindërit, edukatorët dhe shoqëria. Ajo tenton të qëndrojë në kundërshtim me dëshirat e “idit” për shkak të objektivave të tyre kontradiktore. Si rezultat, ajo në mënyrë konstante shikon çdo lëvizje të “idit” dhe dënon atë me ndjenjat e fajit, ankthit dhe inferioritetit. Ajo përpiket për të vepruar në një mënyrë të përshtatshme me shoqërinë.

¹⁴⁰ Transmeton Muslimi nga Abdull-llah Ibn Mes'udi r.a.

tregohet i shkujdesur ndaj (dhikrit) kujtimit të Allahut xh.sh., ai i pëshpëritë atij (për punë të këqija). Në lidhje me këtë thotë Allahu xh.sh. në Kur'an:

“Kush mbyll sytë para këshillave të All-llahut, atij ia shoqëron një shejtan që nuk i ndahet kurrë” (Ez-Zuhruf: 36)

2. Atë që psikologjia e quan “ego” sipas mësimave islame ajo mund të deshifrohet si “ndërgjegje e brendshme” apo “shpirt qortues”. Allahu xh.sh. thotë:

“Beto hem në shpirtin që është shumë qortues!”¹⁴¹

Ky shpirt ndihmohet nga engjëlli shoqërues i çdo njeriu, i cili ia kujton njeriut që para kryerjes së mëkatit, si preventivë të aktivizojë trurin, ndërgjegjen dhe dinjitetin e tij, në mënyrë që njeriu të tërhiqet nga ai mëkat. Edhe engjëlli pra, përkundër djallit, në njëfarë mënyre ndikon pozitivisht mbi zemrën e njeriut dhe e bën atë të anojë nga e mira.

3. Ajo që psikologjia e quan “super-ego” në mësimet islame quhet “ndjenja e shijimit të Islamit apo devotshmëria”. Kur e pyetën Muhamedin a.s. se ku qëndron devotshmëria, ai tha:

“Devotshmëria është këtu (duke bërë me shenjë tri herë kah gjoksi i tij)”¹⁴². Nëse sipas Frojdit “idi” është vazhdimisht në konflikt me “super-egon” edhe sipas fesë, djalli është vazhdimisht në luftë me besimtarin e devotshëm. Allahu xh.sh. ia lejoi djallit të bëjë cytje te njeriut i dobët sepse e dinte se shumica e njerëzve kanë superioritet ndaj djajve, ashtu siç thotë në Kur'an:

“Në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë fuqie ndaj robërve të Mi. Mbrojtja e Zotit tënd është e mjaftueshme (për ata)”¹⁴³.

¹⁴¹ Kur'an, Sure Kijame: 2

¹⁴² Transmeton Muslimi

¹⁴³ Kur'an, Sure Isra: 65

Besimtari e prangos djallin e vet duke iu bindur Allahut xh.sh. dhe duke iu përmbajtur fesë së Tij. E poshtëron atë derisa ai të dobësohet dhe të mos jetë në gjendje ta parandalojë atë nga bërja e mirësive apo rënia në punë të këqija, përveç asaj çka do Allahu xh.sh.

Ku është lokacioni i shpirtit?

Nëse u referohemi ajeteve kur'anore dhe haditheve profetike, do të bindemi se të tre dimensionet shpirtërore të lartpërmendura kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zemrën e njeriut. Zemra nuk është vetëm një organ muskulator që pompon gjakun nëpër enë, por është gjithashtu edhe epiqendra e dimensioneve të brendshme të njeriut. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në trupin e njeriut është një organ i cili nëse është i mirë ai, i gjithë trupi do të jetë në gjendje të mirë, dhe nëse ai është i prishur, i gjithë trupi do të jetë i prishur. Ky organ është zemra”¹⁴⁴.

Tregohet shembulli i një të sëmuri prej zemre i cili rezistonte këshillën e familjes për të bërë transplantimin e zemrës së tij, arsyeja ishte se ai mendonte se dashuria që ndjen për të tjerët e ka burimin në zemër. Kur doktori tentoi ta bindë me fakte medicinale se zemra është vetëm një pompë gjaku, ai e pyeti: “Po mirë o doktor, po të pyes diçka, a ka ndodhur të të japim ndonjë lajm të keq për fëmijët e tu e të mos jesh ndjerë keq në kraharor?” Kjo nuk domethënë se nëse bëhet transplantimi i zemrës, ky njeri nuk do të ketë shpirtin e njëjtë, por është shembull që tregon se Zoti deshi që burimi kryesor i njeriut të jetë në vendin më të pastër dhe më të sigurt të trupit, e që është kraharori. Devotshmëria e besimtarit bën që zemra e tij të bëhet e butë dhe e pastër nga mëkatet. Ajo zemër që e do Zotin, mbushet nga

¹⁴⁴ Transmeton Buhariu

vetë Allahu xh.sh. me energji dashurie që ai pastaj t'i dojë edhe të tjerët. Imam Gazaliu ka thënë:

“Kërkoje zemrën në tre vende: derisa lexon Kur'an, derisa falesh dhe derisa kujton vdekjen. Nëse nuk e gjen, dije se nuk ke zemër, prandaj lute Zotin të të pajisë me zemër!”

Allahu xh.sh. vërteton se arsyeja pse njerëzit i afroheshin Muhamedit a.s. ishte zemra e tij e butë. Allahu xh.sh. thotë:

“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje”¹⁴⁵

Gjithashtu edhe shokët e tij të ngushtë kishin cilësime pothuaj të njëjta, ata faleshin njëjtë si pjesa dërmuese e sahabëve, por ajo që i dallonte prej tjerëve ishte zemra e butë dhe njëkohësisht e madhe e tyre.

Cytja djallëzore shkakton që zemra e njeriut të bëhet e vrazhdë, e pa përgjegjshme, e fëlliqur nga mëkatet dhe nuk arrin ta shikojë dritën e Zotit, sepse nuk mbushet nga energjia e pashtershme e Tij. Ajo është një zemër gati e vdekur që në të nuk depërton as udhëzimi, as këshilla. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Në zemrat e tyre kanë sëmundje, e All-llahu ua shton sëmundjen edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtrojnë, pësojnë dënim të dhembshëm.”¹⁴⁶

Edhe pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u bënë të forta si guri, e edhe më të forta”¹⁴⁷.

Për fund, ju pyes:

“O besimtar, nëse Allahu xh.sh. ju ka lavdëruar dhe ju ka ngritur në pedestal të lartë, duke ju dalluar nga të gjitha krijesat, a keni bërë

¹⁴⁵ Kur'an, Sure Ali Imran: 159

¹⁴⁶ Sure Bekare: 10

¹⁴⁷ Kur'an, Sure Bekare: 74



ju diçka për ta merituar këtë pozitë?! Prandaj, qofshim shpirtra të bindur plotësisht, apo sipas gjuhës së psikologjisë, paçim “super-ego”, por kurrë mos u bëfshim super-egoistë!

BAMIRËSIA NË ADHURIM

Hazreti Omeri r.a., një ditë ishte dëshmitar i një ndodhie të rrallë, për të cilën na tregon vetë ai:

“Një ditë të zakonshme derisa ishim të ulur në prezencë të Muhamedit a.s., vjen një “person” i panjohur për ne, i veshur me petk të bardhë dhe me flokë të zeza. Afrohet te ne dhe ulet përball Muhamedit a.s., saqë gjunjët e tij u prekën me gjunjët e Muhamedit a.s., dhe e pyeti se çka është Imani, Islami, Ihsani dhe kur do krisën Kjameti? Në çdo përgjigje të saktë nga ana e Muhamedit a.s., ai e pohonte përgjigjen duke i thënë Muhamedi a.s. se e ka qëlluar përgjigjen. Kur largohet, Muhamedi a.s. na pyeti neve se a e dinim se kush ishte ky, ngase ne nuk e dinim se ai ishte meleku Xhibril a.s. i cili dëshironte të na e mesojë fenë. Kur Xhibrili a.s. e pyeti në lidhje me Ihsanin – bamirësinë dhe mirësinë në adhurim, Muhamedi a.s. iu përgjigjet: “Të besosh Allahun sikur me e pa Atë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”¹⁴⁸

Të nderuar miq, nëse besimtari do të besojë singlerisht në këtë që sapo thamë, ai do të ishte besimtari më i përkushtuar në fe. Shumë njerëz, kur mëkatojnë apo shkelin ndalesat e Krijuesit të tyre, shpesh harrojnë se Allahu xh.sh. i sheh dhe i vrojton, bile ka ndodhur shpeshherë që mëkatari, para se ta bëjë mëkat sheh majtas - djathtas dhe sigurohet se në prani të tij s’ka askush pos tij. Para disa kohe po “diskutoja” me një musliman praktikant, por me tendenca “ekstremiste” në lidhje me një çështje delikate, personi në fjalë kishte marrë “fetva” apo shqip bindje dhe opinion nga ndonjë “pseudo-hoxhë” se muslimanët që jetojnë në shtete laike, si ky i yni, kanë të drejtë të mos respektojnë ligjet e atij vendi, por përkundrazi t’i shkelin ato. Ai si shembull e merrte energjinë elektrike dhe thoshte

se “sipas fesë lejohet që të vidhet rryma elektrike në vendin tonë laik”. Unë e pyeta:

“Po ju rrymën elektrike në çfarë kohe e vidhni, ditën apo natën?”

Ma kehtu:

“Natën!”,

“Po kur e vidhni rrymën, a ju shohin fqinjët?”,

e pyeta unë. Ai tha:

“Jo, sepse më vjen turp prej tyre!”,

atëherë e shfrytëzova momentin dhe e pyeta:

“Po a nuk ke turp prej Allahut xh.sh. që të sheh se çka vepron dhe Ai t’i di të gjitha të fshehtat?! Të supozojmë se pas një gabimi gjatë vjedhjes të kapë rryma elektrike dhe u digjen duart, nesër kur t’ju pyesin për djegien, ju a do t’ia tregoni të vërtetën?”

Tha:

“Jo!”,

“Po mos dashtë Zoti, ta zëmë se gjatë vjedhjes vdisni në vend, a e dini se në Ditën e Gjykimit ashtu si keni ndërruar jetë, ashtu do të ringjallenit? A do t’ju pëlqente ringjallja juaj duke qenë vjedhacak?”

Në fund ai e kuptoi të vërtetën dhe u bind.

Hadithi i lartpërmendur i cili flet për *Ihsanin* ka një lidhshmëri të madhe me ajetin në vazhdim:

“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xheneti) e edhe më tepër (do ta shohin Allahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi, as nënçmimi, ata janë banues të Xhenetit, aty janë përgjithmonë”¹⁴⁹.

Të gjithë besimtarët të cilët në këtë botë kanë pasur cilësinë e *Ihsanit* (të besosh Allahun sikur me e pa Atë, pasi edhe nëse ti nuk e sheh

¹⁴⁹ Kur’an, Sure Junus: 26

Atë, Ai të sheh ty), Allahu në botën tjetër do të jep një shpërblim më të madh, “*atyre u takon e mira (Xheneti) e edhe më tepër*”, që është shikimi i Allahut xh.sh. drejtpërdrejt dhe pa pengesë. Me fjalë të thjeshta, kush e beson Allahun xh.sh. në këtë botë sikur me e parë me sy, në Botën Tjetër Allahu xh.sh. do t’ua mundësojë shpërblimin më të madh, shikimin e Zotit, pra, jo sikur me e pa, por duke e parë Atë realisht. Kjo do të jetë një ditë shumë e rëndësishme dhe e gëzueshme për besimtarët e nënshtruar, sepse më në fund do të kenë mundësi ta shohin Krijuesin e tyre. Zoti gëzimin e tyre e përshkruan në Kur’an, ku thotë:

“Atë ditë do ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara) që Zotin e tyre e shikojë”¹⁵⁰.

O njerëz, vetëm ndjesia se jemi vazhdimisht në shikim të Zotit është një privilegj për ne. Ai vëzhgim s’mund të krahasohet me asgjë në këtë botë, por për ta kuptuar më mirë, do të bëjmë një krahasim të thjeshtë nga një përvojë e imja në televizion: Të gjithë gazetarët, moderatorët dhe intervistuesit në njërën anë, dhe të ftuarit në studio apo të intervistuarit në anën tjetër, e dinë shumë mirë ndjesinë e vëzhgimit të telespektatorëve dhe shikuesve në emisione të ndryshme. Në fakt, ju mund të jeni vetë në studio dhe të jeni të qetë, por sa ndizet drita e kuqe e incizimit, menjëherë ju nisin emocionet dhe sikleti. Arsyeja për këtë është se ju e ndjeni se dikush ju vëzhgon në anën tjetër të monitorëve, pra është publiku nëpërmjet televizorëve të tyre. Ashtu siç jeni të sigurt se ju shohin njerëzit përmes televizorit, edhe pse ju nuk i shihni, ashtu duhet të jeni të sigurt se ju sheh Allahu xh.sh., edhe pse ju nuk e shikoni Atë.

Pavarësisht se dikush mund të mendojë se dënimi më i madh në Botën Tjetër është Xhehenemi, unë mendoj se dënimi më i madh në Ahiret është “të mos dëshirojë Allahu xh.sh. të të shikojë” për shkak të asaj se ti nuk i ke respektuar urdhëresat dhe ndalesat e Tij. Shihni

¹⁵⁰ Kur’an, Sure Kijame: 22-23

se si Allahu xh.sh. e përshkruan këtë moment të tmerrshëm për pabesimtarët:

“Jo dhe jo! Atë ditë do të jenë të penguar prej (shikimit të) Zotit të tyre”¹⁵¹.

Dënimi më i madh që mund t’ia jep prindi fëmijës së prapë është të mos ia lëshojë sytë. Hidhërimi më i madh i shokëve është kur njëri i thotë tjetrit: “Largohu, mos të t’i shoh sytë!” Dritarja e mirësisë është syri, kurse errësira e mëkatit është ulja e syve dhe kokës. Kur njeriu prangoset para familjes dhe miqve për ndonjë krim, ai i ulën sytë dhe kokën. Kur krimineli ballafaqohet me viktimën apo familjen e viktimës, e ulën shikimin dhe kokën. Kur borxhliu, pas përfundimit të afatit, takohet me borxhmarrësin që ende s’i ka të hollat, ai i ulën sytë dhe kokën. Kështu pra, çdo gjë lidhet me sytë dhe shikimin. Duke u bazuar në këta shembuj nga përditshmëria, mund të kuptojmë edhe sekretet e urdhëresave dhe ndalesa Kur’anore, madje jo vetëm të mëkateve të mëdha, por edhe të atyre të voglave, p.sh.:

kur burri në rrugë shikon një vajzë të huaj, mendon se nuk bën ndonjë gabim të madh sepse nuk ka ligj që e ndalon atë të sheh dikë, por kur ai e di se Zoti xh.sh. e sheh, ai ulën shikim e tij.

Në fund, e lusim Zotin të na bëjë prej atyre që në këtë botë kujdesemi të mos i shkelim kufijtë e tij, që nesër në Ahiret të kemi Xhenete dhe të mira pa kufi!

¹⁵¹ Kur’an, Sure Mutaaffin: 15

STUDIUES APO MANIPULUES I FESË, VARET PREJ TEJE!

Teologjia Islame është “profesioni” misionar më i çmuar në botë, por nëse nuk përmbahet në parimet fundamentale të bazuara në Kur’an dhe Sunet, ai mund të kthehet në “zanatin” më të rrezikshëm në botë. Ai që e bën të çmuar apo të rrezikshëm këtë profesion është ngase këta njerëz punojnë dhe veprojnë me ligjet e Allahut xh.sh. , me Librin e tij të Shenjtë, pra me Kur’anin Famëlartë. Nëse i përmbahen Kur’anit me sinqeritet dhe devotshmëri, Allahu xh.sh. do t’i ngrejë në një pedestal të respektuar në këtë botë dhe në Botën Tjetër, por nëse e shfrytëzojnë Kur’anin për interesa personale, duke manipuluar me fjalët e Zotit, Allahu xh.sh. do t’i dënojë për veprimet e tyre. Muhamedit a.s. sqaron se hoxhallarët dijetarë janë trashëgimtarë të misionit profetik, me ç’rast thotë:

“Kushdo që ecën në një rrugë për të kërkuar dije, Allahu ka për t’i lehtësuar atij një rrugë për në Xhenet. Me të vërtetë Melekët ulin krahët e tyre në shenjë kënaqësie për kërkuarësin e dijes. Banorët e qiejve dhe banorët e Tokës, madje edhe peshku në ujë, kërkojnë falje për dijetarin. Vlera e dijetarit para adhuruesit të thjeshtë është si vlera e (ndriçimit të) Hënës para (vezullimit të) yjeve. Vërtet dijetarët janë trashëgimtarë të Profetëve. Profetët nuk lënë pas trashëgimi as dinarë e as dirhem por dije, dhe kushdo që merr prej saj ka marrë një thesar të mjaftueshëm”¹⁵².

Muhamedi a.s. shpeshherë u tërhiqte vërejtjen shokëve që të kenë kujdes se si flasin dhe prej kujt dëgjojnë fenë. Në një rast i drejtohet djalit të Omerit r.a. dhe i thotë:

“O Ibn Omer, kujdesu për fenë tuaj! Ajo është mishi jot dhe gjaku yt! Prandaj duhet të jesh shumë i kujdesshëm prej kujt e merrë atë. Merr nga ato që janë të drejtë dhe braktis ato që shmangin”¹⁵³.

Veprimi më i urryer në Islam është të flasësh pa dije për çështjet fetare. Sot ka shumë prej atyre që pavarësisht se mbi supë kanë përgjegjësi të mëdha fetare, guxojnë që pa dije dhe pa argumente të japin opinione personale në lidhje me dispozitat fetare, me ç’rast ngatërrojnë hallallin me haram, këta njerëz, pa dituri, kthehen në manipuluesit e fesë të Allahut xh.sh..

Imam Ahmed bin Hambelit i erdhën disa studiues nga Andaluzia (Spanja e sodit) dhe e pyetën tridhjetë pyetje, por ai u përgjigj vetëm në shtatëmbëdhjetë prej tyre. Atëherë njëri prej tyre pyeti:

“O Imam i nderuar, po pjesa e mbetur?”

“Nuk i di!”

u përgjigj Imami.

“Imam Ahmed i nuk di?”

ia ktheu ai.

“Po, nuk i di!”,

u përgjigj Imami!

“Epo çfarë t’i themi popullit kur të na pyesë?”, tha i dyti.

Atëherë, Imami tha:

“Thoni popullit të Andaluzisë se Imami nuk di!”

Sikur të kishte thënë se i di të gjitha, do të kishte bërë mëkat të madh! Prandaj, kini kujdes për fenë tuaj, e nëse ju pyesin diçka që ju nuk e dini, mos t’ju vijë turp të thoni “Më vjen keq, por nuk e di!”, e nëse keni pak informacion, mos nxitoni të jepni opinion të shpejtuar, por fillimisht konsultohuni me më të diturit! Mos u turpëroni të

¹⁵³ Transmeton Abdulla ibn Omeri r.a.

pyesni nëse nuk dini, e as mos u dekurajoni nëse dikush ju nënçmon për pyetjen! Një ditë, një besimtar më pyeti për përdorimin e medikamenteve të bëra me kapsula nga xhelatina¹⁵⁴, dhe pasi nuk isha I sigurt në përgjigjen, i thashë të më japë pak kohë derisa të konsultohem! Pasi i shkrova një letër elektronike njërit nga dijetarët me të cilin konsultohem, brenda kohe e hapa si çështje para disa shokëve, por u befasova kur njëri prej tyre më tha:

“pse merresh me kësi punësh të vogla”,

ai harroi se, nëse për të ishte çështje e vogël, për dikë mund të jetë çështje jetike.

Në Islam nuk lejohet të jepen opinione personale për çështjet e qarta islame. Mund të preferoni qëndrime, opinione apo mendime të huaja, por jo të jepni opinion apo ta zbërtheni urdhrinë apo ndalesën sipas kushteve dhe rrethanave që ju konvenon, për atë që më parë është vendosur nga Allahu dhe profeti i tij. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Kur Allahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës”¹⁵⁵.

Po ju parashtrojë dy pyetje të cilat në shikim të parë duken shumë të lehta për t'u përgjigjur, por nëse koncentrohemi më thellë, do të kuptoni se nuk është e lehtë të jepet opinion për çështjet fetare, e para:

kush mendon se ka bërë mëkat më të madh, një që ka hapur një klub nate dhe aty bëhen të gjitha mëkatet, apo një shkrimtar që ka publikuar një libër i cili e shan Islamin dhe Muhamedin a.s.?! Siç ishte

¹⁵⁴ Substancë nga mbetjet e produkteve të kafshëve

¹⁵⁵ Kur'an, Sure Ahzab: 36

aktuale edhe tek ne botimi i librit “Vargjet Satanike” të Selman Ruzhdie. *E dyta:*

cila mendoni se është më e keqe, varrosja e vajzave të gjalla, siç praktikohej te arabët para ardhjes së Islamit apo moskokëçarja e prindërve të sodit që lejojnë vajzën e tyre të del në mbrëmje me dashnorin, duke mos llogaritur pasojat fatale të atij veprimi?!

Zhvillimi i teknologjisë ka mundësuar që sot bota të duket shumë e vogël; nëse dikur njëra anë e globit nuk e ka ditur se çka ndodh në anën tjetër, sot mjafton të shtypësh telekomandën e televizorit dhe menjëherë do të marrësh një grumbull informacionesh për gjithçka që ndodhën nëpër botë; dikur për të bërë një punim të mirëfilltë shkencor është dashur të udhëtosh me qindra kilometra për të huazuar një libër nga biblioteka, kurse sot mjafton të kesh qasje në faqen elektronike të bibliotekës më të largët dhe mund ta huazosh librin në mënyrë elektronike vetëm me një klikim; dikur, nëse duhej të shkosh në një konferencë shkencore në një shtet tjetër, nuk mund të merrje me vete më shumë se dy apo tre libra për shkak të ngarkesës dhe pengesës ligjore, kurse sot mund t’i fusësh në xhepin e xhaketës të gjitha koleksionet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit, tefsiret e Ibn Kethirit, Raziut dhe Kurtubiut, enciklopeditë botërore, romanet etj., duke i instaluar nëpër CD apo USB; nëse bota dikur kishte pesë kontinente, dje ajo u shndërrua në një *fshat global*, kurse sot ajo është minimizuar në një ekran televizori apo laptopi, prandaj shfrytëzoheni zhvillimin e jashtëzakonshëm shkencor dhe teknologjik i cili i mundëson secilit prej jush të keni librarinë tuaj virtuale për të përhapur fenë e Allahut xh.sh. në Tokë.

Ushtrojeni misionin tuaj me ndërgjegje e me dinjitet, qëndroni të paluhatshëm në rrugën tuaj edhe nëse jeni të vetëm apo nuk keni përkrahje nga njerëzit. Ashtu siç mjekët kanë betimin e Hipokratit, ashtu edhe ju keni më shumë se aq, i keni dhënë besën Allahut xh.sh. që nuk do të monopolizoni me fenë e Allahut xh.sh., nuk do të

përkuleni dhe zmbrapseni para atyre që janë armiq të Allahut xh.sh., atyre që dëshirojnë ta “modernizojnë apo reformojnë fenë Islame”, duke polemizuar me ju dhe me besimtarët e tjerë se dispozitat e Kur’anit duhet të reformohen, si p.sh.:

pozicionimi i agjërimit të Ramazanit vetëm gjatë stinës dimërore për shkak të intervalit të vogël kohor dhe temperaturave më të përshtatshme, falja e namazit me gjuhën e komunitetit, ezani sipas gjuhës së popullit etj..

Këtyre hipokritëve, përgjigjuni duke lexuar ajetin në vijim:

“Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ata që nuk besojnë takimin Tonë (ringjalljen), thonë: "Sillna një Kur'an tjetër, ose ndryshojë këtë!". Thuaj: "Mua nuk më takon që ta ndryshoj vetë, unë e përcjell vetëm atë që më shpallet, unë nëse kundërshtoj Zotit tim i frikësohem dënimit të një Dite të madhe”¹⁵⁶.

Më në fund mund të them:

“Ka dallim të madh mes njohurisë së ligjit të Allahut xh.sh. dhe njohurisë për Allahun xh.sh.. Një person të ditur mund ta pyesësh njëqind pyetje për ligjet e Allahut xh.sh. dhe ai të të përgjigjet saktësisht në shumicën prej tyre, por nëse e sheh atë duke mos iu nënshtruar Allahut xh.sh., do të kuptosh se njohuria e tij për Allahun xh.sh. është shumë e vogël.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Frika ndaj Allahut është dituria më e madhe që mund të ketë një njeri, dhe të qenët i kënaqur me atë që ka arritur në dituri, tregon injorancën e tij”¹⁵⁷. Zoti na ruajt prej tyre!

¹⁵⁶ Kur'an, Sure Junuz: 15

¹⁵⁷ Transmeton Masruku

DIALOGU NDËRFETAR, DOMOSDOSHMËRI E KOHËS DHE VENDIT!

Sot, në ditët e përhapjes së dhunës dhe joharmonisë kolektive që fatkeqësisht shpesh herë bëhet edhe në emër të Zotit, e ndjej të arsyeshme të shkruaj disa fjalë dhe shpresoj ti jap një shtytje të vogël procesit të dialogut.

Kjo është koha kur shoqëria njerëzore i ka mbyllur sytë para realitetit të hidhur dhe ka shkuar aq larg saqë ka përjashtuar religionin nga debati publik sepse sistemi jetësor bazohet në materializëm të skajshëm i udhëhequr vetëm prej llogjikës materialiste.

Sot bota gjithnjë e më shumë ka nevojë për dialog të mirëfilltë që të afron dhe jo të përçan dhe për të arritur këtë atë duhet konsideruar imperativ kohor.

Dialogu bëhet për të përmisuar bashkëjetesën mes komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike dhe si e tillë në rastin më të mirë ai zhvillohet gjatë fërkimeve fillestare ndëretnike dhe ndërfetare me qëllim që të mos eskalon edhe më shumë situata, dhe në rastin më të keq, dialogu shihet si vegla e fundit në aritjen e paqes pasi ka eskaluar situata në konflikt të armatosur apo luftë civile.

Nevoja për dialog ndërfetar është shumë i nevojshëm por njerëzit nuk e kuptojnë qëllimin e tij. Ç'farë rëndësie kanë fjalët e bukura që përmenden në libra, gazeta apo medime kur në anën tjetër shohim sjelljen brutale të besimtarëve të feve të ndryshme në emër të "fesë" së tyre?

Një nga dëshirat e Allahut xh.sh. është padyshim edhe diverziteti në besimet e njerëzve. Ai thotë në Kur'an:

“Sikur të kishte dashur All-llahu i kishte tubuar (qeniet njerëzore) në rrugë të drejtë; po ti mos u bën nga të padijshmit (dhe mos u brengos).”¹⁵⁸

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”¹⁵⁹

“Sikur të donte All-llahu, do t'ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t'ju sprovtojë në atë që ua dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t'ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit”.¹⁶⁰

Parashtrohet pyetja:

A mund ta imogjinonim botën sikur të gjithë njerëzit të ishin të njejtë: të flisnin njejtë, të visheshin njejtë, të besonin njejtë, e kështu me radhë?

Kjo do ishte një jetë prej roboti, ku njerëzit do kishin vetëm një sistem, një parti, një qeveri, një kuvend, një president, një gjyqë, etj.

Në pamje të parë kjo fotografi mund të na duket shumë e mirë, por:

Sikur në këtë sistem monist do ishte paraqitur korrupsioni, nepotizmi, shantazhi, vjedhja, padrejtësia, vrasja e padrejtë, etj. atëherë sado që do dëshironim ta ndryshonim situatën nuk do kishim mundësi, sepse s'do kishim alternativë tjetër, s'do kishim planin rezervë.

Diverziteti i religjioneve, popujve, racave, ngjyrave dhe gjithcka që ndërlihet me mbarvajtjen e shoqërisë siç është: politika, qeverisja, presidenca, gjyqësori etj. janë sprova nga Zoti se sa ne dimë ti mana-

¹⁵⁸ Kuran, Sure En'an: 35

¹⁵⁹ Kur'an, Sure Junus: 99

¹⁶⁰ Kur'an, Sure Maide: 48

xhojmë ndryshimet mes nesh, por mbi të gjitha edhe sa dimë ti balancojmë fuqitë mes nesh. Thotë Allahu xh.sh. në Kur'an:

“Dhe sikur All-llahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po All-llahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit.”¹⁶¹

“E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut.”¹⁶²

Sipas ajetit të parë kuptojmë se sikur të mos kishte pasur diverzitete mes njerëzve dhe sikur fuqia do ishte në dorën e vetëm një grupi (një populli, një etniteti, një race, një feje etj.) bota do ishte e korruptuar sepse natyra e njeriut është e tillë që çdoherë dëshiron të ketë dominim total ndaj tjerëve por kur kjo natyrë ballafaqohet me natyrën e tjetrit që ka dëshirë të njejtë atëherë domosdo të bëhet balancimi i fuqive të tyre me qëllim mbijetese.

Ajeti i dytë është edhe më i veçantë pasi Zoti justifikon edhe balancimin e fuqive religjioze dhe fakti që përveç xhamive përmenden edhe manastiret, kishat dhe havrat është shenjë e qartë se Zoti njih ekzistencën e të gjitha kulteve fetare dhe urdhëron paprekshmërinë e tyre dhe respekt për ata që falen brenda tyre.

Allahu xh.sh. kërkon nga ne që kur të dialogojmë me ithtarë të librave qiellor (krishterët dhe hebrejtë) referencë të kemi pikërisht këto ajete Kur'anore:

“Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.”¹⁶³

¹⁶¹ Kur'an, Sure Bekare: 251

¹⁶² Kur'an, Sure Haxh: 40

¹⁶³ Kur'an, Sure Ankebut: 46

"O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)"!"¹⁶⁴

Islami nuk thirren vetëm për dialog por tregon edhe se në çfarë forme duhet të zhvillohet ai. Thotë Allahu xh.sh. në Kur'anin Famë-lartë:

"Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë"¹⁶⁵

"Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira."¹⁶⁶

Por si mund ta konsiderojmë dialogun në Islam si diçka univerzale kur deri tani të gjitha versetet Kur'anore u dedikoheshin vetëm pjestarëve të fesë krishtere dhe hebreje? Si qëndron puna në raport me ata që nuk janë pjesë e feve qiellore monotesite?

Kur'ani shkon edhe më tej me këshillat paqësore saqë në emër të drejtësisë kolektive kërkon respekt dhe mirkuptim reciprok me çdo qenie njerëzore pamarëparasysh a beson apo mohon Zotin.

"All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë"¹⁶⁷

¹⁶⁴ Kur'an, Sure Ali Imran: 64

¹⁶⁵ Kur'an, Ankebut: 46

¹⁶⁶ Kur'an, Sure Nahl: 125

¹⁶⁷ Kur'an, Sure Mumtehinat: 8

Këtu Zoti qartazi thëret që të krijohet lidhje drejtësie dhe humaniteti me të gjitha ata që respektojnë lirinë e bashkëjetesës dhe dinjitetit njerzor.

Nëse dialogojmë në mënyrë të mirëfilltë do kuptojmë se me ata që jemi konsideruar armiq, pavarsisht dallimeve tona të theksuara, mbajmë edhe shumë vlera dhe bindje të përbashkëta, përjetojmë të njejtat vështirësi dhe sfida jetësore dhe kemi armiq të përbashkët: nepotizmin, shantazhin, kriminalitetin, padrejtësinë, varfërinë, korrupsionin, diskriminimin racor, diskriminimin gjinor, aparteidin, ngrohjen globale, shkatrimin e natyrës, epidemit e ndryshme, etj; dhe në anën tjetër bashkërisht themi: Zoti, ndërgjegjja, shpirti, paqja, përgjegjësia, etika, solidariteti, humanizmi, etj. prandaj le të flasim për gjërat që na bashkojnë dhe jo të luftojmë për gjërat që na ndajnë.

Në fund, shpresoj që ky punim modest ti inkurajojë njerëzit e feve botërore që ti qasen më seriozisht çështjes së harmonisë ndërfetare, ta nxisin atë dhe ta kenë prioritet të tyre sepse prej tij varet edhe e ardhmja e paqë e popullit të tyre.

PËRFUNDIM

Jnderuar lexues, këto janë vetëm disa përpjekje të vogla për t'ju dhënë një fotografi më të qartë për mundësitë, privilegjet, peripecitë dhe vështirësitë që mund të hasën një thirrës islam në vendet Perëndimore.

Si konkludim mund të themi se xhamitë në Perëndim kanë rolin kryesor në avancimin, zhvillimin dhe edukimin e muslimanëve dhe pregaditjen e tyre fetare dhe arsimore, duke spikatur brezat e rinjë që janë e ardhmja jonë. Xhamitë nuk konsiderohet vetëm si kulte fetar por si qendra kulturore, edukative, shpirtërore e kombëtare dhe model shembullor për këtë kemi edhe xhaminë shqiptare Ebu Hanife në Troisdorf.

Në këtë libër janë shkëputur disa ligjërata që sipas bindjes time janë prioritare, por kjo nuk domethënë që këto janë probleme dhe tematika të vetme që duhet trajtuar, sepse ka edhe shumë problematika të tjera që nuk arrita ti përfshij në këtë libër për shkak të hapësirës së vogël kohore, por kjo le të jetë motivim dhe inspirim për kolegët e mi teologë që edhe ata të tregojnë këndvështrimet e tyre.

Në fund, e falemderoj Zotin e Madhërishëm që më mundësoi të jem në mesin e këtij xhemati të mrekullueshëm dhe bujar, shpreh mirënjohje edhe ndaj Kryesisë së xhamisë “Ebu Hanife” në Troisdorf që ishin të hapur për bashkpunim reciprok dhe në fund uroj që këta rreshta të zënë vend në zemrat e lexuesve kudo qofshin ato sepse thuhet:

“ajo që del prej zemre nuk ka vend tjetër përpos se në zemër”.

Fund!